



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”

“BASHKIA MEMALIAJ”

Tiranë 2023



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9
II. HYRJA	12
1. Objektivat e auditimit.....	12
2. Qëllimi i auditimit.....	12
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	13
5. Përgjegjësitë e audituesve	13
6. Kriteret e vlerësimit	13
7. Standardet e auditimit	14
8. Metodologjia e auditimit	14
9. Dokumentimi i auditimit.....	15
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	16
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	16
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	28
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022.....	61
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	84
2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	118
2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.	121
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit.	122
2.7 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	123
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	Error! Bookmark not defined.

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektivat vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Memaliaj, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 për auditimin financiar dhe nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022 për auditimin e përputhshmërisë. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikatat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Memaliaj si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Nuk ka ngritur një sistem efektiv për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim;
- NJAB në Bashkinë Memaliaj për periudhën objekt auditimi është organizuar dhe funksionon me 1 (një) auditues i cili është njëkohësisht edhe përgjegjës i NJAB –së.
- Niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2022 paraqitet masën 88%;
- Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022, janë në vlerën totale 11,498 mijë lekë për 19 fatura;
- Për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 965,800 lekë;
- Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 0 lekë, po ashtu në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 0 lekë. Në fakt gjendja e kësaj llogarie paraqitet në gjendjen e llogarisë 411 “*Klientë dhe llogari të ngjashme*”, e cila paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhur me to*”;
- Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*”, për 21 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme;
- Nga auditimi i PF konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 119.998 lekë dhe llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë;
- Lejet e ndërtimit të audituara janë miratuar në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin, duke evidentuar mangësi që lidhen me treguesit e distancave ndërmjet ndërtimeve dhe pronave etj;
- Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 234 subjekte të kategorisë “Biznes” dhe “Institucione” në vlerën 7,522,649 lekë dhe 6 institucione në vlerën 660,000 lekë, pra gjithsej **8,182,649 lekë** për **240** subjekte, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj;

- Vlera e detyrimeve që lindin nga kontratat e qirave për asetet, është **5,064,995 lekë**;
- Vlera e detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë është **536,448 lekë**;
- Vlera debitoare në fund të vitit 2022 për taksën e tokës bujqësore është **6,731,799 lekë**;
- Në vitin 2022 në territorin e Bashkisë Memaliaj kanë ushtruar aktivitet të pa regjistruar në QKB 37 subjekte;
- 3 procedura me vlerë të fondit limit **432,842 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT;

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

N r.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësi	Rekomandimi
1	Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2022 paraqitet masën 88%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Memaliaj në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. <i>(faqe 28-61 të RPA)</i>	E mesme	Sektori i Financës të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.
2	Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 19 fatura për vlerën totale 11,498,494 lekë . Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr. 410 datë 27.02.2023, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Memaliaj ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën 10,675,831 lekë , e cila përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale. Sa më sipër vlera e raportuar nga Bashkia Memaliaj me vlerën e evidentuar nga grupi i auditimit, që duhej të raportohet sipas pasqyrave financiare në MFE është në vlerën 11,498,497 lekë , e cila përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale të cilat kanë një diferencë të lehtë prej 822,666 lekë, pa ndryshuar në thelb situatën normale të gjendjes financiare në të cilën ndodhet Bashkia Memaliaj. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas raportit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (SIFQ) vlera e raportuar duhej të ishte 13,410,265 lekë , pra konstatohet se për Bashkinë Memaliaj vlera e detyrimit të mbetur të raportuar për vitin 2022 dhe vlera e raportuar për shpenzimet e planifikuara, nuk përputhet me informacionin e gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Oeverisë (SIFQ). -Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likuidohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky detyrim. <i>(faqe 28-61 të RPA)</i>	E lartë	Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e tyre. Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori i Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemit e nevojshme në llogarinë 486.
3	Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 0 lekë, po ashtu në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 0 lekë. Në fakt gjendja e kësaj llogarie paraqitet në gjendjen e llogarisë 411 "Klientë dhe llogari të ngjashme", e cila paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe	E lartë	Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të

	në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to”, veprim i gabuar kontabël. (faqe 61-85 të RPA)		kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuara.
4	Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 21 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. (faqe 61-85 të RPA)	E lartë	Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.
5	Nga auditimi i PF konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119.998 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë. (faqe 61-85 të RPA)	E lartë	Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.
6	Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat: -Leje ndërtimi me nr. 1, datë 18.10.2022 i jepet zhvilluesit: K.me të dhënat e mëposhtme: M.A.K S., Leja e ndërtimit për objektin: Ndërtimi i murit mbajtës prej guri h-3m, sistemime të ambientit, mbushje nivelime mbjellje me bar hapësirat e gjelbërta si dhe ndërtimi i një muri kufizues në pjesën fundore të karburantit “M. O.”, Memaliaj me nr. pasurie 1/136 s=996m2, adresa e realizimit të punimeve Bashkia Memaliaj. -Leje ndërtimi me nr. 5, datë 08.07.2021 i jepet: A. R., zhvilluesi A. R. aplikues i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: P. D., Leja e ndërtimit për objektin: Banese një familjare me 1 kat mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, adresa e realizimit të punimeve Bashkia Memaliaj. Nuk është marrë mendim pozitiv nga AZHT. (faqe 122-124 të RPA)	E lartë	Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa marrë në konsideratë mendimet pozitive nga institucionet përgjegjëse që lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.
7	Nga kontrolli në sistemin “e-leje” u konstatua se, për lejen e zhvillimit me nr. 8, datë 23.07.2021 miratuar para lejes së ndërtimit nr. 7, datë 06.10.2021 i jepet zhvilluesit M. D., i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: G. M. leja e ndërtimit për objektin: Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore, adresa e realizimit të punimeve Bashkia Memaliaj. (faqe 122-124 të RPA)	E lartë	Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të kërkuar ndryshim të statusit të tokës duke e regjistruar me status trull për të vazhduar me miratim të lejes së ndërtimit.
8	Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” u konstatua se, leje ndërtimi nr. 4, datë 24.06.2021 i jepet zhvilluesit: R. L.dhe H. L., aplikues i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: G. M. Leja e ndërtimit për objektin: Banese adresa e realizimit të punimeve: Batalioni Rinia 02170009; nd.31; h.1; Krahës Zhulaj 6307 Bashkia Memaliaj. (faqe 122-124 të RPA)	E lartë	Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi me objekte të cilat nuk respektojnë distancat e lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit.
9	Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022, u konstatua se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 108 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 4,450,252 lekë dhe 6 “Institucione” në vlerën 528,000	E lartë	Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrimit të

	<p>lekë. Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 234 subjekte të kategorisë “Biznes” dhe “Institucione” në vlerën 7,522,649 lekë dhe 6 institucione në vlerën 660,000 lekë, pra gjithsej 8,182,649 lekë për 240 subjekte, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.</p> <p>-Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Konkretisht në fillim të vitit 2022 janë debitor 114 subjekte për vlerën 4,978,252 lekë, ndërkohë në fund të vitit 2022, janë 240 subjekte në vlerën 8,182,649 lekë. Konkretisht gjatë vitit 2022 janë krijuar 122 subjekte debitor për vlerën 3,169,384 lekë.</p> <p>-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga Sektori i Financës dhe Tatimeve Bashkia Memaliaj, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), për të debitorëve nuk janë marrë masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal. <i>(faqe 28-61 të RPA)</i></p>		<p>taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët. Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerë 8,182,649 lekë.</p>
10	<p>Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Memaliaj me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimeve ligjore për përlogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2022), përlogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2022, janë krijuar 64 subjekte debitorë për vlerën 614,709 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2022 janë 169 subjekte për vlerën 5,064,964 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj. Gjithashtu u konstatua se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatëvonesës për mos pagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbartimit. <i>(faqe 28-61 të RPA)</i></p>	E lartë	<p>Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë 5,064,995 lekë, nga qiratë e tokës Bujqësore.</p> <p>Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.</p>
11	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi të pa licencuara rezulton se përgjatë vitit 2022 në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Memaliaj operojnë dhe ushtrojnë aktivitet 37 subjekte të biznesit të pa regjistruar në QKB, për të cilët nuk janë ndjekur procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim dhe pagesën e detyrimeve për taksë dhe tarifa vendore, e për pasojë nuk kanë qenë objekt i taksave dhe tarifave vendore, duke sjellë një evazion fiskal dhe të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Konkretisht, nëse do të bënim përlogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë), për subjektet e pataksuara, do të kishim 26,200 lekë * 37 subjekte mesatarisht = 969,400 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj. <i>(faqe 28-61 të</i></p>	E lartë	<p>Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitet, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje, të paregjistruar në QKB, dhe të ndjekë procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim.</p> <p>-Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me QKB dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, për përcaktimin e statusit të këtyre bizneseve dhe për ato biznese që kanë aktivitet të hapur të merret informacion zyrtar, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar nivelin e të ardhurave nga subjektet fizik/juridik dhe mbi bazën e të ardhurave të</p>

	RPA).		realizuara në fund të periudhave ushtrimore të bëhet aplikimi i taksave e tarifave vendore. -Nëse do bënim përlogaritjen vetëm të tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit për subjektet e patakuara do të kishim 969,400 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.
1 2	Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është 536,448 lekë për 30 subjekte, nga të cilat 19 subjekte për vlerën 305,88 lekë janë krijuar në vitin 2022. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Memaliaj, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Memaliaj, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mos pagesës së TNI, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. (faqe 28-61 të RPA)	E lartë	Spektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Spektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 536,448 lekë, sipas listës që disponon Spektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj.
1 3	Nga auditimi i veprimtarisë së sektorit të Taksave Vendore Bashkia Memaliaj për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore në fund të vitit 2021 për taksën e tokës bujqësore është 2,761,604 lekë, dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3520 familje debitorë për vlerën 6,731,799 lekë, nga të cilat në vitin 2022 është krijuar 3,970,195 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitore për taksën e tokës bujqësore, çka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e kësaj takse. -Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitore (faqe 28-61 të RPA)	E lartë	Spektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 6,731,799 lekë nga taksa e tokës bujqësore.
1 4	Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit me vlerë të fondit limit 432,842 mijë lekë , është konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP procedura e prokurimit publik me objekt: “Ndërtimi i Ujësjiellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, Bashkia Memaliaj, vitin 2021, me fond limit 410,176 mijë lekë , me fitues BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk , me vlerë të ofertës 410,174 mijë lekë . Në këtë procedurë prokurimi oferta ekonomike e bashkimit të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotëson kriteret e kërkesave kualifikuese të DATË. Janë vendosur kriteret jo të drejta për kualifikim duke sjellë mungesë konkurrence, me pasojë lidhje të kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. Përkatësisht: - Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, në mungesë të oponencës teknike si dhe në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Përkatësisht, Raporti i Vlerësimit në Mjedis është hartuar nga OE “A. G.” Shpk në mungesë të certifikatës së ekspertit dhe licencës për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis	E lartë	AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

	<p>lëshuar nga QKB. Gjithashtu, OE "A. G." Shpk është edhe hartues i projektit të ndërtimit të ujësjellësit.</p> <p>- Kriteret e vendosura në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, "Për rregullat e prokurimit publik" sipas të cilit, kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.</p> <p>- Pranimi i nën kontraktimit të OE "A. G." Shpk, (me 40% të vlerës së kontratës) është në kundërshtim me: Nenin 37, pika 3/a, nenin 42 pika 2, nenin 56, nenin 75 pikën 5 dhe 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.</p> <p>- Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu, nga titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE "K." Shpk & "E. K." Shpk. (faqe 85-119 të RPA)</p>		
1 5	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj", me vlerë të kontratës 410,174,927 lekë pa Tvsh, është kontraktuar BOE "K." Shpk & "E. K." Shpk, rezultuan që punimet janë pezulluar, pasi leja është dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", ligjit nr. 10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë", ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, "Për mbrojtjen e faunës së egër" si dhe të ligjit nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", sa më sipër referuar neneve 27 e 29 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".</p> <p>Nga Mbikëqyrësi i Punimeve OE "Xh. M." Shpk, është vepruar në kundërshtim me: Pikat 4, 5, 6 e 14 të Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Pikat 3, 3.1, 3.3, 3.4, 7 (7.1, 7.2 e 7.3) 9.1, 11 (11.1 e 11.2) të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit". (faqe 119-122 të RPA)</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Memaliaj, nëpërmjet Sektorit të Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të marrë masa që në të ardhmen, të aplikojë dhe të miratojë lejet e ndërtimit, në zbatim të përcaktimeve ligjore për kryerjen e punimeve të ndërtimit.</p> <p>Të kërkohet nga mbikëqyrësit e punimeve të ndërtimit, kontrolli i mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësohen treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente, për t'i shërbyer komunitetit në kohë.</p>

3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Opinionin i auditimit

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Memaliaj për vitin e ushtrimor 01.01.2022 - 31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore 2022 të Bashkisë Memaliaj, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin me rezervë”.

Baza për “Opinionin e modifikuar me rezervë”:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 6.1 milion lekë, si dhe anomalitë e konstatuara gjatë auditimit, si më poshtë:

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022, u evidentuan gabime materiale por jo të përhapura, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 38,220,128 lekë, duke u debituar për vlerën e faturave të pa likuiduara gjendje kjo që i përket llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) në aktiv të bilancit, veprim i gabuar kontabël, pasi kjo llogari funksionon për të ardhurat nga shitja.

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 0 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari duhej të paraqitej me gjendje 38,220,128 lekë, referuar analizës së debitorëve.

Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, llog.431 “Tatime e taksa”, llog.436” Sigurime shëndetësore” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit, për paradhënie të pa derdhura nga personeli i Bashkisë apo tatime e kontribute të pa ndalura nga Bashkia punonjësve, por janë detyrime që ka Bashkia ndaj punonjësve për pagat e dhjetorit të vitit ushtrimor si dhe detyrimet për tatimin e të ardhurave dhe kontributet e sigurimeve të ndalura të pa derdhura. Shuma e llogarive në vlerën prej 8,933,986 lekë në mbyllje të vitit 2022 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,286,263 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson.

Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 21 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur

Në pasqyrat financiare konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “Toka,

Troje, Terrene” në vlerën 119,998 lekë dhe llog. 211 *“Pyje, Plantacione”* në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë.

Gjendja e llogarisë 4341 *“Operacione me shtetin (detyrime)”* paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,628,142 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,286,263 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, *“Operacione me shtetin (detyrime)”* është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët janë në mbyllje të vitit 2021 janë në vlerën 34,655,100 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 38,220,128 lekë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Memaliaj, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Memaliaj, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin *“Baza për Opinionin”*, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga auditimi i 3 procedurave me vlerë të fondit limit **432,842 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP të 3 procedurat **me vlerë kontrate 423,626 mijë lekë** ose 98 % e vlerës së Fondit Limit. Në këto procedura ofertat e bashkimit të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DATË
- U konstatuan detyrimeve për taksat dhe tarifën vendore në vlerën 27,295,747 lekë;
- U konstatua mos arkëtim i detyrimeve për tarifën e autorizimit të ushtrimit të aktivitetit për subjektet që tregtojnë lëndë djegëse në vlerën 2,400,000 lekë;
- U konstatua mos taksim i plotë i kategorisë taksapaguese *“Familje”*, për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, në vlerën 6,129,800 lekë;
- Vlera e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore është 6,731,799 lekë.

Përgjegjësitë e drejtuesve të Bashkisë Memaliaj.

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifën vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Memaliaj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në

raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 428/1 Prot, datë 19.05.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.05.2023 deri në datën 28.06.2023, në subjektin Bashkia Memaliaj u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për auditimin financiar dhe për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 për auditimin e përputhshmërisë. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. G. K. – *Përgjegjës Grupi*
2. J. G. – *Auditues*
3. A. D. – *Auditues*
4. A. G. – *Auditues*

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Memaliaj ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Memaliaj është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Memaliaj dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm;
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre;
3. Vlerësimi i raportimit financiar;
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike;
5. Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimin e territorit;
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës të Territorit të Njësisë Vendore (IMTV);
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Memaliaj, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Memaliaj është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Memaliaj. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;

- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme”;
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Memaliaj grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Memaliaj me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet

² ISSAI 1315

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Të dhëna të përgjithshme: Bashkia Memaliaj kufizohet në veri me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Tepelenë dhe në perëndim me Bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Memaliajt.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10.657 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki ka 21.476 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 372.07 km² me një densitet prej 78.90 banorë/km². Në përbërje të kësaj Bashkie ndodhen 6 Njësi Administrative: Memaliaj, Memaliaj Fshat, Lutfinje, Buz, Krahës dhe Qesarat.

Infrastruktura: Infrastruktura rrugore e Bashkisë Memaliaj ka njohur një përmirësim relativ gjatë viteve të fundit në përfundimin e ndërtimit të akseve rrugore Tepelenë-Memaliaj dhe Fier-Memaliaj. Bashkia Memaliaj është lidhur me linja të transportit publik me kryeqytetin dhe qytete e afërta. Sipërfaqet e gjelbërta në qytet janë 192625 m²; mbulime me ndiçim në zonat urbane dhe rurale vërtet qyteti; shërbim me ujë dhe kanalizime, mbulimi 10%, mbulimi me shërbim pastrimi në masën 30%.

Industria: Në territorin e Bashkisë së Memaliajt gjenden 15 rezervuare në funksion të ujitjes së tokave Bujqësore, gjë që favorizon kultivimin e produkteve bujqësore në këtë zonë. Prej vitesh është evidentuar potenciali energjitik në segmentet e Kalivacit. Bashkia Memaliaj është e pasur me bimësi si në loje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve që shtrihet deri në lartësinë 600-800 m, brezi i dushkut 800-1200 m, pyjet foragjere, halore dhe të përzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi afër 1000m. Bashkia e Memaliajt ka ende burime minerare në formën e rezervave të qymyrgurit me fuqi të lartë kalorifike (por me përqindje të lartë squfuri 3 herë më tepër se normat e BE).

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Titulli i gjetjes 1: *Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.*

Situata: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Memaliaj:

Nuk ka ngritur një sistem efektiv për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.

-Nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim.

-Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.

-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB, nuk kanë Organigramën korrensponduese të strukturës si dhe këto ndryshime nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme.

-Nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës

- GMS nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe ankesave, për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pika 2, Ligji nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 90/2012, datë 27.09.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21, pikat 1-2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2 dhe pika 3.3.

Ndikimi: Ekspozimi i veprimtarisë së njësisë së vetëqeverisjes vendore Memaliaj në një risktë të nivelit mesatar sa i përket funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të sistemit financiar.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për të gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit financiar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

Rekomandim: Nga Bashkia Memaliaj, Sektori i Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, kryhet ky auditim për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë, kontrollet, kanë arritur nëpërmjet planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare, të ofrojnë shërbimet publike dhe të bëjnë adresimin e risqeve me efikasitet dhe efektshmëri, duke dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të realizohen nëpërmjet:

i. Pajtueshmërisë me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat.

ii. Informacioneve operative e financiare të besueshme dhe të plota.

iii. Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, bazuar në të dhënat e paraqitura në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Memaliaj, informacionin e mbledhur nga përgjigjet e pyetësorit të realizuar nga grupi i auditimit, si dhe rezultatet e testeve të kryera, komponentët e sistemit të menaxhimit

financiar dhe kontrollit kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm përgjatë gjithë strukturave të njësive, pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit. Më poshtë, në mënyrë të detajuar argumentohen puna e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit në drejtim të, funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është bazë për menaxhimin e fondeve në njësinë publike, ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

Ky komponent përbëhet nga:

1.1. Integriteti dhe Vlerat Etike

Nëpunësit e Bashkisë Memaliaj duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

-Bashkia Memaliaj disponon Kodin e Etikës të miratuar me Vendimin nr. 39, datë 21.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë, në të cilën përfshihen rregullat e etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

-Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

-Në Bashkinë Memaliaj, ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë saj, regjistrohen në Zyrën e Protokollit të institucionit me një ndalesë dhe më pas bëhen raportimet e nevojshme në sektorët përkatës. Në vazhdim të procesit, bëhet kthimi i përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

-Bashkia Memaliaj nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

1.2. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Në rregulloren e brendshme të institucionit janë të përcaktuara procedurat për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse të cilat, përcaktojnë rolin, fushëveprimin e nëpunësit autorizues dhe të stafit menaxherial. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se:

-Bashkia Memaliaj ka të përcaktuar dhe kryen sipas procedurës së miratuar në rregulloren e brendshme hartimin, miratimin, ndjekjen dhe raportimin e brendshëm sa i përket realizimit të planeve mujore nga sektorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e Njësive Administrative si dhe Drejtorët e njësive të varësisë për informacion të titullarit të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

-Në Bashkinë Memaliaj mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese lidhur me mangësitë e evidentuara

në këtë drejtim. -Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

-Nga Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj Sh.a, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit të administrimit dhe raportimit financiar për efekt argumentim subvencioni sepse bashkia është aksionari kryesor, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.

-Titullari i institucionit merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë audituese që ai kryen.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë nëpërmjet vendim-marrjes.

1.3. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

-Bashkia Memaliaj ka hartuar dhe miratuar deklaratën e misionit dhe dokumentin e PBA-së. Në dokumentet e PBA-ve, nga ana e këtij institucioni është miratuar strategjia me objektivat dhe prioritetet strategjike, në përputhje me ligjin organik të buxhetit si dhe plan veprimi i menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Janë kryer konsultime me palët e treta, grupet e interesit si dhe dëgjesat me publikun në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

-Mënyra e njohjes së punonjësve me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Struktura organizative e Bashkisë Memaliaj është në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e këtij institucioni. Numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 51, datë 16.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 146/1 prot., datë 08.02.2022. Kjo strukturë është miratuar me Urdhrin nr. 32, datë 01.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë. Struktura organizative nuk është e shoqëruar me organigramën, veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 90/2012, datë 27.09.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21, pikat 1-2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit të miratuar me Urdhrin të Ministrit të Financave, nr. 108, datë 17.11.2016. Realizimi i strukturës për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Viti	Muajt	Plani/Numër punonjës	Fakt/Numër punonjës	Diferenca
2022	Janar	205	196	-9
2022	Shkurt	205	196	-9
2022	Mars	205	197	-8
2022	Prill	205	197	-8
2022	Maj	205	198	-7
2022	Qershor	205	200	-5
2022	Korrik	205	200	-5
2022	Gusht	205	200	-5
2022	Shtator	205	200	-5
2022	Tetor	205	201	-4
2022	Nëntor	205	201	-4
2022	Dhjetor	205	203	-2

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

1.4. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Nëpunësit e Bashkisë Memaliaj i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel sektori, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, përcaktohet që:

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.
- Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent.
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

1.5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Titullari i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, dhe luan një rol kyç përsa i takon, integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm dhe sjelljes etike. GMS ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë, të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe menaxhimi efektiv i riskut janë të pranishëm dhe funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

Me Urdhrin nr. 8, datë 27.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2022 i përbërë nga 6 punonjës, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni u konstatua se, ky grup (GMS) nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4, nën pikat 1-5. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

2. Menaxhimi i riskut

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e ngjarjeve të mundshme apo situatave të cilat mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për, zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij, analizimin dhe rifreskimin e kontroleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut të miratuar. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, hapa këto të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e prioriteteve lidhur me shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë e më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

-Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

-Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

3. Aktivitet e kontrollit

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesat.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullari i njësisë publike, miraton gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtaritë kryesore të njësisë dhe siguron që, të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm apo autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë

mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit duhet të ketë në përbërje të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës”.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të sigurojë se në përgatitjen e “Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës” do të përfshihen hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishëm për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Për vitin 2022, Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3, “Aktivitete e kontrollit”.

Titullari i njësisë ka përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, i cili duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit.

-Me Vendimin nr. 41, datë 28.07.2022, të Krytarit të Bshkisë me objekt është miratuar rregullorja për parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë Memaliaj.

-Bashkia Memaliaj nuk ka një procedurë të veçantë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, për të bërë të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. Monitorimi

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, monitorimi synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Nëpërmjet vetëvlerësimit një përdorues i buxhetit përcakton nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në të cilin rregullat dhe procedurat sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Duke plotësuar pyetësoin e vetëvlerësimit çdo nëpunës autorizues për çdo vit përgatit një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimet dhe objektivat, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është rritja e llogaridhënies së menaxhimit dhe inkurajimi i përpjekjeve për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi të nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

-Bashkia Memaliaj me shkresën nr 390 prot., datë 28.02.2022, ka hartuar dhe dërguar në MFE deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe pyetësoin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 18, pika 1.

Me shkresën nr. 510 prot., datë 16.03.2023, është dërguar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin pranë MFE, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

5. Informimi dhe komunikimi

Titullari i njësisë publike miraton dhe vë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, si dhe ndërmjet njërive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave në nivel aktiviteti dhe në nivel objektivash të përgjithshme për mbarë njësinë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Memaliaj dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. Gj. G. me detyrë Kryetar i Bashkisë Memaliaj.

Titulli gjetjes 2: Mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm për vitin 2022.

Situata: Nga auditimi u konstatua se NJAB në Bashkinë Memaliaj për periudhën objekt auditimi është organizuar dhe funksionon me 1 (një) auditues i cili është njëkohësisht edhe përgjegjës i NJAB –së. Në strukturën e miratuar janë përcaktuar 1(një) Përgjegjës i Sektorit të Auditit dhe 1 (një) Specialist, ndërkohë që Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit të NJAB rezultoi se emërimi i Përgjegjës të NJAB - së nuk është në përputhje me kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Për periudhën 2022 realizimi i planit është në masën 100%. NJAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, por nuk ka marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes së auditimeve, auditimin e fushave me risk të lartë, kombinimin e llojit të auditimeve dhe në asnjë program auditimi nuk ka përfshirë si drejtim vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Grupi auditimit evidenton se në këtë NJAB monitorimi vazhdueshëm dhe Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë nuk kryhet në përputhje me kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Audituesi i Brendshëm ka adresuar rekomandime për përmirësim me karakter të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcaktuara, por monitorimi i zbatimit të tyre nuk ka ndikuar në realizimin në kohë të tyre.

Kriteri: Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 3, gërma “a”, neni 11, “Punësimi i audituesit të brendshëm”, pika 2, gërma “ç” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1, gërma “b”, Manualin e Auditimit të Brendshëm të

miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VII, pika 3.1.3, Kapitullin VII, pika 7.1.1

Ndikimi: Veprimtaria e sektorit të auditimit të Brendshëm është në përputhje të pjesshme me kuadrin rregullator ligjor në fuqi duke cënuar sigurinë dhe cilësinë e veprimtarisë audituese të Auditit të Brendshëm.

Shkaku: Organizimi dhe funksionimi i NJAB në kundërshtim me përcaktimet në kuadrin rregullator ligjor në fuqi .

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për sistemimin e organizimit dhe funksionimit të NJAB – së konform kuadrin rregullator ligjor në fuqi, duke bërë shpallje të pozicioneve vakante në mënyrë që të plotësojnë strukturën e Auditit të Brendshëm me 3 (tre) punonjës sipas kriterëve ligjore.

NJAB të kryej planifikimin e auditimeve, duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes së auditimeve, auditimin e fushave me risk të lartë, kombinimin e llojit të auditimeve, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

NJAB të përditësojë Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së veprimtarisë audituese dhe të përcaktojë qartë kush do ta realizojë (në kushtet e mosplotësimin të kësaj NJAB), mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës dhe sigurimin e cilësisë së auditimit .

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. Gj. G. me detyrë Kryetar i Bashkisë Memaliaj.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Njësia e Auditit të Brendshëm është krijuar me VKB nr. 51, datë 16.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 122/1 prot., datë 01.02.2023, e cila përbëhet nga dy pozicione konkretisht, 1 (një) përgjegjës njësie dhe 1 (një) specialist auditit. Kjo strukturë nuk është miratuar në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 3, gërma “a” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1, gërma “b”, ku përcaktohet që: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”.

Deri më datë 31.12.2022, Struktura e NJAB funksionon me 1 (një) punonjës konkretisht z. Ferdinand Kalemë me detyrë Përgjegjës i Njësisë së Auditit të Brendshëm i cili është i certifikuar prej vitit 2012. Të dhënat e detajuara paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
1	F.K.	Përgjegjës Sektori	06.01.2020	Ekonomist	30	3	Ne vitin 2012	Po

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se struktura e NJAB Bashkia Memaliaj nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve pra nga 2 pozicione pune të miratuara sipas VKB

të sipërpërmendur konkretisht pozicioni specialist auditi është vakant gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të kësaj njësie. Në lidhje me këtë situatë nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masa për nisjen e procedurës për plotësimin e vendeve vakante të NJAB edhe pse ky rekomandim është trajtuar në auditimet e mëparshme të zhvilluara nga KLSH dhe nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.

-Nga auditimi i dosjeve të punonjësve të NJAB konstatohet se, z. Ferdinand Kalemi është emëruar në detyrën si përgjegjës i NJAB më datën 06.01.2020, me një eksperiencë pune në fushën e auditimit të brendshëm prej tre vitesh dhe jo pesë vite, e cila parashikohet në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Kreu IV "Organizimi i auditimit të brendshëm", neni 11, "Punësimi i audituesit të brendshëm", pika 2, gërma "ç", ku përcaktohet që: ç. *Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm.*

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Memaliaj e cila është aplikuar për vitin 2022 është miratuar me Vendimin nr. 147, datë 08.11.2018. Karta e Auditimit të Brendshëm ka pësuar disa ndryshime miratuar me Vendimin nr. 38, datë 23.05.2023, e cila është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 873/1 prot., datë 23.05.2023, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për vitet 2022-2024 me shkresën nr. 1440/1 prot., datë 19.10.2021, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Referuar planit strategjik për vitin 2022 synohen të realizohen 8 auditime përputhshmërie.

3. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Audituese i miratuar nga titullari i institucionit për vitin 2022, është dërguar me shkresën nr. 334 prot., datë 14.02.2023, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, bashkëlidhur ndodhen edhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

4. Struktura e Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2022 është hartuar e plotësuar sipas standardeve të vendosura në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuara në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

Të dhënat e detajuara paraqiten në Aneksin nr. 1 bashkëlidhur.

1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Duke u bazuar në Planin Vjetor për vitin 2022, për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB i cili është miratuar me shkresën nr. 1440/1 prot., datë 19.10.2021, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

1. Bashkia Memaliaj, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike, Klubi Sportiv Memaliaj (Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve).
2. Bashkia Mamaliaj, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike, Klubi Sportiv Memaliaj /Auditim i detyrimeve prapambetura.
3. Bashkia Mamaliaj/Auditim i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.
4. Klubi Sportiv Memaliaj/Auditim i menaxhimit të fondeve nga subjekti.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Seksioni VI, Kreu III, Pika 1, programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referimet ligjore të vendosura në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Për vitin 2022 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t'u kryer 8 auditime përputhshmërie dhe janë realizuar 8 auditime, realizim në masën 100%. Nuk ka patur ndryshime në planifikim dhe realizim.

Gjithashtu vlen të theksohet se për vitin 2022 NJAB nuk është audituar fusha e prokurimeve, administrimi i aseteve, Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Memaliaj, të cila janë fusha me risk të lartë, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VII, pika 3.1.3, ku përcaktohet që: *“Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit, ndërsa për sistemet që vlerësohen me një nivel risku më të ulët mund të planifikohen për t'u audituar më rrallë, por jo më shumë se 5 vjet”*.

Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2022 dhe faza e zbatueshmërisë së tyre paraqitet në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

Viti 2022							
Nr.	Subjekti i Audituar	Numri i rekomandimeve	Pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
1	Drejtoria e Financës Bashkia Memaliaj/Auditimi i detyrimeve të prapambetura.	1	1	0	0	0	1
2	Drejtoria e financës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Memaliaj/Auditimi i detyrimeve të prapambetura.	3	3	0	0	3	0
3	Bashkia Memaliaj mbi vlerësimin e sistemit të ardhurave nga taksa-tatimet.	9	9	1	1	0	7
4	Futboll Klub Memaliaj/auditim mbi vlerësimin e veprimtarisë ekonomike.	5	5	0	0	5	0
5	Futboll Klub Memaliaj/Auditimi i detyrimeve të prapambetura.	2	2	0	0	2	0
Totali		20	20	1	1	10	8

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

-Me shkresën nr. 275/1 prot., datë 15.02.2022, është hartuar dhe miratuar Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësisë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 i cili është

dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE me shkresën nr. 379/1 prot., datë 25.02.2022.

-Me shkresën nr. 33/2 prot., datë 11.01.2022, është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut.

-Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë kjo Njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se për vitin 2022 për përgatitjen e PBA 2022-2024 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr. 54, datë 28.12.2021, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1195/1 prot., datë 07.01.2022. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Memaliaj.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. *Zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike;*
- c. *Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore;*
- b. *Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve rurale;*
- c. *Zhvillimi i Turizmit;*
- d. *Zhvillimi cilësor dhe mbështetja Bujqësisë.*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2022 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr. 52, datë 16.12.2021.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron

veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Memaliaj për vitin 2022 është 419,701 mijë lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2022, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionët e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1 PBA për periudhën 2022-2024 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Memaliaj

Nr.	Kodi	Emërtimi	PBA	Buxhetivjetor	Realizimi i	Diferenca
			Plan viti 2022	2022 (Plani i Rishikuar)	periudhës progresiv	
			(1)	(2)	(3)	(3-2)
1	01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	89,298	121,437	89,871	-31,566
2	01170	Gjendja Civile	3,600	3,340	3,219	-121
3	03280	MZSH	13,467	14,346	13,647	-699
4	04240	Ujitja dhe kullimi	2,898	1,393	956	-437
5	04260	Administrimi i Pyjeve	3,321	3,491	1,280	-2,211
6	04520	Mirembajtje rruge e trotuare	9,327	4,730	4,259	-471
7	06330	Menaxhimi i mbetjeve pastrimi		6,200	5,077	-1,123
8	10910	Banasa sociale		3,370	3,082	-288
9	06330	Sherbimet publike	95,866	78,318	64,424	-13,894
10	06370	Furnizim me uje dhe kanalizime	200,000	0	0	0
11	08220	Sherbime kulturore		1,000	539	-461
12	09120	Arsimi parashkollor, baze & QKF	38,600	39,727	36,760	-2,967
13	09230	Arsimi i mesem	8,350	7,762	7,615	-147
14	10430	Mbrojtja sociale	133,969	189,816	188,972	-844
Totali i Shpenzimeve të Njësisë			598,696	474,930	419,701	-55,229

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2022-2024, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 55,229 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik për “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, “Shërbimet Publike”, “Arsimi Parashkollor bazë dhe QKF”, “Administrimi i Pyjeve” dhe “Menaxhimi i Mbetjeve, Pastrimi”.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2022-2024 Bashkia Memaliaj ka planifikuar të ardhurat tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2022
Te ardhura tatimore	13,690
Te ardhura jotatimore	16,310
TOTAL	30,000

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes 3: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024.

Situata: Për hartimin e PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Memaliaj;

-Për PBA 2022-2024 dhe Buxhetin vjetor 2022 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si vijon: “Kryetari i

njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”.

-Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Memaliaj, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, (nuk) administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Memaliaj, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

-Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

- Nuk administrohen tavanet përgatitore, Tavanet përfundimtare janë miratuar me VKB nr. 49, datë 16.12.2021 “Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2022-2024 për Bashkinë Memaliaj”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1852/1 Prot., datë 17.12.2021.

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

-Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor.

Kriteri: Pikën 3 të nenit 13, pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 6 në Kreun I, pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Ndikimi: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Memaliaj.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Memaliaj.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Memaliaj.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Memaliaj dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shitesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Memaliaj ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit Tepelenë, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 3 Planifikimi i buxhetit për vitin 2022, Bashkia Memaliaj

Planifikimi i të ardhurave 2022		Planifikimi i shpenzimeve 2022	
Burimi i të ardhurave	000/ lekë	Emërtimi i zërave	000/lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	30,000	Art. 600 Paga	112,675
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm nga viti 2021	16,000	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	
Total të ardhurat e veta	46,000	Art.602 Shpenzime operative	20,503
Transfertë e pa kushtëzuar	24,800	Art.604 Transferime korrente te brendshme	50,071
Transfertë e kushtëzuar		606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	4,100
Transfertë specifike	107,766	Art.230-231 Investime	
	70,778	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	55,595
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	203,344		6,400
Totali të Ardhurave	249,344	Totali Shpenzimeve	249,344

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezultoni se buxheti i konsoliduar (Bashki+Njësia e Varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale) vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **249,344 mijë lekë**.

Për vitin 2022, kanë ndodhur 5 ndryshime buxhetore me vlerë 225,586 mijë lekë, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4 Ndryshimet buxhetore për vitin 2022

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe rishpërndarja e fondeve									
Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë		Shtesat dhe Pakësimet në total	Rishpërndarjet: Shtesa/Pakësime të Buxhetit				Buxh fillest buxh shtesë
	VKB Nr.54 datë 24.12.2021	VKB Nr.18 dt 07.04.2022	VKB Nr.		Vendim nr.23, dt 19.05.22	VKB Nr. 38. dt 3.08.2022	VKB Nr.52 dt 03.11.2022	Rishpërndarje total	
	1	2	3	4=2+3	5	6	7	8=5+6+7	9=1+4+8
600	112,675		1,523	1,523			1,400	1,400	115,598
601	20,503		450	450					20,953
602	50,071		3,673	3,673	1,160		7,115	8,275	62,019
604	4,100		3,370	3,370					7,470
606			193,266	193,266		200		200	193,466
230-231	55,595	9,839	13,465	23,304			-8,515	-8,515	70,384
(609)	6,400			0	-1,160	-200		-1,360	5,040
Totali	249,344	9,839	215,747	225,586	0	0	0	0	474,930

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr	Kodi	Programi	Plan progresiv 2022	Fakti 2022	%
1	01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	121,437	89,871	74
2	01170	Gjendja Civile	3,340	3,219	96
3	03280	MZSH	14,346	13,647	95
4	04240	Ujitja dhe kullimi	1,393	956	69
5	04260	Administrimi i Pyjeve	3,491	1,280	37
6	04520	Mirembajtje rruge e trotuare	4,730	4,259	90
7	06330	Menaxhimi i mbetjeve pastrimi	6,200	5,077	82
8	10910	Banesa sociale	3,370	3,082	91
9	06330	Sherbimet publike	78,318	64,424	82
10	08220	Sherbime kulturore	1,000	539	54
11	09120	Arsimi parashkollor, baze & QKF	39,727	36,760	93
12	09230	Arsimi i mesem	7,762	7,615	98
13	10430	Mbrojtja sociale	189,816	188,972	100
Totali i Shpenzimeve të Njësies			474,930	419,701	88

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezultoni se:

Për vitin 2022 realizimi i buxhetit është në nivelin 88%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Mbrojtja Sociale”, “Arsimi i Mesëm”, “Gjendja Civile”, “MZSH” dhe “Arsimi Parashkollor;

Programi me realizimin më të ulët është “Administrimi i Pyjeve”.

3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.


Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Memaliaj, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Memaliaj, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferata e deleguar nga pushteti qendror. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2022-2024, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.6 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2022

Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	115,598	110,759	96
601	Sigurime Shoqërore	20,953	18,069	86
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	62,019	51,007	82
604	Transferata Korente të Brendshme	7,470	6,888	92
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	193,466	192,552	100
609	Emergjencat Civile, Fondi Rezervë	5,040	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	2,400	421	18
231	Kapitale të Trupëzuara	67,984	40,003	59
	TOTAL	474,930	419,701	88

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grafiku nr.1 Peshë e secilit artikull ndaj totalit



Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2022 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 88%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferata për Buxhet Familjar dhe Individ”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, Transferata Korente të Brendshme, mallra dhe shpenzime si dhe realizimin më të ulët e kanë Kapitalë të Patrupëzuara. Vihet re se për vitin 2022 art. (230) Kapitalë të Patrupëzuara paraqiten 18 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

➤ Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.

Tabela nr.7 Buxheti sipas burimeve të financimit 2022

Art.	Emertimi	Fakt 2022					Tr.Kushtëz për funksionet e deleguara
		Gjithesëj	Të ardhurat e veta	Tr.Pakushtëzuar	Tr.kushtëz Specificke	Sponsoriz	
600	Paga	110,759	0	56,158	54,601	0	
601	Sigurime Shoqërore	18,068	0	8,538	9,530	0	
602	Shp. Operative	51,006	13,382	31,180	6,444	0	
604	Transf. Korrente të Brendshme	6,888	311	3,495	0	0	3,082
606	Transf. për familje dhe individ	192,552	200	2,380	1,000	0	188,972
230-231	Investime	40,423	9,000	21,584	0	9,839	
	Total	419,696	22,894	123,337	71,576	9,839	192,054

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transfertat e kushtëzuar për investime, në vlerën 419,696 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Memaliaj, ndjekur nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 192,054 mijë lekë, nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 123,337 dhe transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 71,576 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara.

-Buxheti nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara për vitin 2022 është realizuar në vlerën 192,054 mijë lekë, ose 46 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë shpenzimet për Transferta për familje dhe individ dhe transfertat korentë të brendshme.

Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 123,337 mijë lekë, ose 30 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga, shpenzime operative dhe Investime.

Transferta kushtëzuar specifike.

-Buxheti nga transfertat specifike për vitin 2022 është realizuar në vlerën 71,576 mijë lekë, ose 17 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar në vlerën 22,894 mijë lekë, ose 5.5 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për shpenzime operative dhe investime.

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Me miratimin e buxhetit për vitin 2022 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2022 është planifikuar në masën 4,600 mijë lekë. Sipas të dhënave nga Bashkia Memaliaj nga fondi rezerve/dhe kontigjencës janë shpenzuar 1,360 mijë lekë, për furnizimin e mjeteve të Batalionit të Xhenios me karburant - lubrifikant, trajtim financiar për personelin e angazhuar për ndërtimin e urës si dhe për ndihmë financiare. Në fund të vitit 2022, nga fondi rezervë/dhe i kontigjencës ka mbetur pa u shpenzuar në vlerën 3,240 mijë lekë nga ky fond.

-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.

Nga Bashkia Memaliaj është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 1,800 mijë lekë. Sipas të dhënave nga Bashkia Memaliaj nuk është përdorur asnjë vlerë.

➤ Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Memaliaj.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Memaliaj përgjatë periudhës 2022 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ **Realizimi i Investimeve.**

Titulli Gjetjes 4: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 88 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Memaliaj në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Kriteri: Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Ndikimi: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 “*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*” të ligjit 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “*Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*”, si dhe nenin 44⁴, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konstatohet se për vitin 2022 nuk administrohen raportet 4 dhe 8 mujore për monitorimin e zbatimit të buxhetit si dhe nuk janë realizuar dhe përcjellë në Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Memaliaj, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2022 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2022, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale.

⁴ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 ka ardhur duke u rritur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2022.

Tabela nr.8 Detyrimet e prapambetura për periudhën 2022

Detyrime e NJQV 2022	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total detyrime	Shlyerja gjate 2022	Mbetja në fund të vitit 2022
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrime për vendime gjyqësore	182,235	0	182,235		182,235
Detyrime për sherbime	14,333,568	202,251	14,535,819	4,983,079	9,552,740
Detyrime për mirembajtje					
Detyrime për investime	271,500		271,500	178,800	92,700
Detyrime për mallra	1,557,976	620,415	2,178,391	1,557,976	620,415
Detyrime te tjera	1,050,407		1,050,407		1,050,407
Total Detyrime që kanë si burim të ardhurat e veta	17,395,686	822,666	18,218,352	6,719,855	11,498,497
b					
Detyrime për Investime nga Ministria e Linjës (Min. Infrastrukturës)		14,135,322			
Total i Detyrimeve që kanë si burim financimi Min. Linjës					
Total i Detyrimeve nga të ardhurat e veta + granti		14,135,322			11,498,497
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2022					38,371,312

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Memaliaj ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

Titulli i Gjetjes 5: Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

Situata: Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr.410 prot., datë 27.02.2023, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Memaliaj ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën **10,675,831 lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale, pasqyruar në tabelën më poshtë.

Për efekt krahasimi dhe mosrakovimit të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 për sa raportuar nga Bashkia, sa paraqitur në pasqyrat financiare dhe SIFQ tabela si më poshtë:

Tabela nr.9 Situata Financiare për vitin 2022

Nr.	Emërtimi	Stoku raportuar nga Bashkia	Totali i shpenzimeve miratuar nga Bashkia	Stoku sipas Pasqyrave Financiare	Totali i shpenzimeve miratuar nga Bashkia	Stoku sipas Raportit MFE (SIFQ)	Totali i shpenzimeve sipas Raportit MFE (SIFQ)
I	Borxhe (a+b)						
a	Hua afatgjatë						
a,1	Principali						
a,2	Interesi						
b	Hua afatshkurtër						
b,1	Hua						
b,2	Overdrafte						
b,3	Kredi të furnitorëve						
II	Detyrime (a+b+c)	10,675,831		11,498,497		13,410,265	
a	Shpenzime korrente	10,400,896		11,223,562		12,149,230	
a,1	Mallra dhe shërbime	9,350,489		10,173,155		10,512,796	
a,2	Paga dhe sigurime						

a.3	Të tjera	1,050,407		1,050,407		1,636,434	
b	Shpenzime kapitale	92,700		92,700		1,078,800	
b.1	Insitucione buxhetore						
b.2	Subjekte private						
c	Vendime gjyqësore	182,235		182,235		182,235	
c.1	Marrëdhënie pune						
c.2	Mallra dhe shërbime						
c.3	Investime						
c.4	Të tjera						
III	Totali (I+II)	10,675,831		11,498,497		13,410,265	
	Diferenca			822,666		2,734,434	
	Shpenzimet		249,344,000		249,344,000		278,403,936
	Stoku %	4.28%		4.61%		4.81%	

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër vlera e raportuar nga Bashkia Memaliaj me vlerën e evidentuar nga grupi i auditimit, që duhej të raportohet sipas pasqyrave financiare në MFE është në vlerën **11,498,497 lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale të cilat kanë një diferencë të lehtë prej 822,666 lekë, pa ndryshuar në thelb situatën normale të gjëndjes financiare në të cilën ndodhet Bashkia Memaliaj. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas raportit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (SIFQ) vlera e raportuar duhej të ishte **13,410,265 lekë**, pra konstatohet se për Bashkinë Memaliaj vlera e detyrimit të mbetur të raportuar për vitin 2022 dhe vlera e raportuar për shpenzimet e planifikuara, nuk përputhet me informacionin e gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ).

Kriteri: Udhëzimi nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Kreu XI pika 1, neni nr. 56 I Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Ndikimi: Mospasqyrimi i saktë i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe mos ekzekutimi i plotë i fondeve buxhetore, me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori i Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 486.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e tyre.

Titulli i gjetjes 6: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 182,235 lekë ose rreth 2% mbi totalin e detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2022 nuk ka kryer likujtime të vlerës së detyrimit të mbartur nga vitet e mëparshme. Në fund të vitit 2022 Bashkia Memaliaj ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 38,371,312 lekë, të cilat mund t'i përdorte për likuidimin e plotë të vendimeve gjyqësore

si dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Memaliaj.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Memaliaj ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 167, datë 17.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Gjirokastrë (dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës), ndaj Bashkisë Memaliaj është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “M. R.”, në vlerën 965,800 lekë të cilat përbëjnë shpenzime pa economicitet, efikasitet dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Këto detyrime janë krijuar për Bashkinë Memaliaj gjatë vitit 2022 dhe janë likuiduar përgjatë vitit 2022.

-Gjithashtu konstatohet se për likuidimin e subjektit të mësipërm është nxjerrë urdhëri përkatës nga titullari i institucionit, por në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Memaliaj.

Përgjatë vitit 2022 ndaj Bashkisë Memaliaj është krijuar edhe një detyrim nga vendimet gjyqësore, mbi likuidimin e vendimeve të PAK në vlerën 43,725,318 lekë, e cila është likuiduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kriteri: Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Ndikimi: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

-Shpronësimet për interes publik.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës rezultoi se përgjatë vitit 2022 nuk ka pasur detyrime për shpronësime të krijuara në vitin 2022 apo nga vite të mëparshme dhe të palikuiduara.

➤ Faturat e palikuiduara Brenda afatit 30 ditor.

Titulli gjetjes 7: Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Memaliaj, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2022, ky afat nuk është respektuar në 19 raste për vlerën 11,498,494 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike nr.12, në Kapitullin “Aneksë”.

Tabela nr.10 Përmbledhëse e faturave për vitin 2022

Artikulli	Sasia	Viti2022/lekë
230-231	6	92,700
602	13	11,405,794

Totali	19	11,498,494
---------------	-----------	-------------------

Burimi: Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2022 janë 19 fatura të pa likuiduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 11,498,494⁵ lekë.

-Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet radha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likuidohet më parë, ilustruar me disa raste.

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

- OE "K." Shpk, faturë e datës 15.09.2022 në vlerën 457,000 lekë, likujduar më datë 12.12.2022, ndërkohë që deri më datë 12.12.2022 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se fatura e subjektit të mësipërm, si p.sh., subjekti "I.S.S" Shpk, me faturë të datës 03.10.2022 në vlerë 1,069,215 lekë, likujduar më datë 16.11.2022, subjekti "SH.Z.A K." Shpk me faturë të datës 04.10.2022 në vlerë 382,741 lekë, likujduar më datë 11.11.2022 si dhe subjekti "B. A." Shpk me faturë të datës 23.09.2022 në vlerë 465,000 lekë, likujduar më datë 27.10.2022;

- OE "F. M." Shpk, faturë e datës 09.11.2022 në vlerën 177,600 lekë, likujduar më datë 19.12.2022, ndërkohë që deri më datë 19.12.2022 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë sesa fatura e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti "O. H." Shpk me faturë të datës 22.09.2022 në vlerë 116,400 lekë, likujduar më datë 25.10.2022;

- K.shpk, faturë e datës 31.05.2022 në vlerën 117,500 lekë, likujduar më datë 19.09.2022, ndërkohë që deri më datë 19.09.2022 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë sesa fatura e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti "SH.Z.A K." Shpk me faturë të datës 01.06.2022 në vlerë 591,310 lekë, likujduar më datë 08.09.2022;

- OE "O. C." Shpk me faturë të datës 29.06.2022 në vlerë 323,205 lekë, likujduar më 21.07.2022 ndërkohë janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se fatura e subjektit të mësipërm, si psh., subjekti "F. M." Shpk me faturë të datës 06.08.2022, likujduar më datë 08.06.2022, etj.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Kriteri: Pikat 8, 106 dhe 107 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Ndikimi: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

⁵ Analitikisht pasqyruar në Aneksë.

5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Sektori i Financës për vitin 2022, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Memaliaj ka marrë 1 financim projekti nga AKUM.

Tabela nr.11 Fonde të deleguara për vitin 2022 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2021, kanë vazhduar në vitin 2022 dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2022, ose janë në proces gjatë vitit 2022

Nr	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Operat. Fitues	Datë Lidhjes Kontratës	Ofert. Fituese	Situacionuar deri 31.12.2022	Likuiduar 31.12.2022
1	Ndërtimi i ujesjellesit rajonal per fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Ane vjose, Toç, Lulezim, Zhulaj, Krahes Qyteti Memaliaj.	AKUM	K. & A. G shpk	09.06.2021	410,176,390	0	410,176,390
	Totali				410,176,390	0	410,176,390

Burimi: Sektori i Financës Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për vitin 2021, Bashkia Memaliaj ka lidhur kontratë për investim në punë publike me objekt: “Ndërtim i Ujesjellesit rajonal për fshatrat V. I. Q. AV. T. L. Zh. K. dhe Q. M.”; me burim financimi nga AKUM.

Vlera e investimit është 410,176,390 lekë, deri në 31.12.2022, për këtë objekt nuk është likuiduar asnjë pagesë për kryerje punimesh. Sipas kontratës ky investim ka nisur në vitin 2021 dhe përfundon në vitin 2024.

-Kontrata e mësipërme është regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Tepelenë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresë përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:

- Buxheti i Bashkisë Memaliaj dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për vitin 2022;
- Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB;
- Për hartimin e PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Memaliaj, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Nuk administrohen Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024 si dhe Tavanet Përfundimtare janë miratuar jashtë afateve;
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;
- Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Përgjegjësit e Sektorëve të Bashkisë Memaliaj, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Në PBA, si dhe buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor;
- Për vitin 2022 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 88%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferta për buxhet familjar dhe individ”, duke vijuar me shpenzime për Paga dhe Sigurime Shoqërore, Transferta Korrente të Brendshme, Mallra dhe Shpenzime si dhe

realizimin më të ulët e kanë Kapitale të Patrupëzuara. Vihet re se për vitin 2022 art. (230) Kapitale të Patrupëzuara paraqiten 18%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe ligjore, rezulton se përgjatë vitit 2022 është 1 vendim gjyqësor ndaj Bashkisë Memaliaj në vlerën 965,800 lekë, nga shqyrtimi i ditarit të bankës për vitin 2022 është kryer likuidimi ndaj subjektit, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 182,235 lekë ose rreth 2% mbi totalin e detyrimeve të raportuara.

- Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Tepelenë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2022, ky afat nuk është respektuar në 19 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 11,498,494 lekë, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj dhe z. P. H., ish Përgjegjës i Sektorit të Financës.

6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Struktura e Sektorit të Tatimeve, Bashkia Memaliaj.

Për vitin 2022 me Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 51, datë 16.12.2021, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.1175/1, datë 29.12.2021. Me urdhrin nr.32, datë 01.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative sipas sektorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga sektorët, ku bën pjesë dhe sektori i tatimeve. Kjo strukturë ka funksionuar për vitin 2022 me 7 punonjës, specialistë tatimesh dhe që kanë varësi funksionale nga Përgjegjësi i Sektorit të Tatimeve e cila për periudhën objekt auditimi ka qënë vakant. Këta specialistë mbulojnë qytetin e Memaliaj dhe 5 NJA si: Fshat Memaliaj, Krahës, Qesarat, Buz dhe Luftinjë.

Struktura e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Memaliaj, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Date fillimi	Ndryshimi gjatë 2022 nëse ka pasur
1	E. L.	Specialist Tatimesh për qytetin Memaliaj	20.08.2018	
2	A. G.	Specialist Tatimesh qytet Memaliaj	23.10.2020	
3	Sh. L.	Specialist Tatimesh Nj.Ad Memaliaj Fshat	20.08.2018	
4	K. V.	Specialist Tatimesh Nj.Ad Qesarat	13.04.2017	Larguar 30.11.2022
5	M. Ç.	Punonjese Tatimesh Nj.Ad Buz	03.09.2007	
6	M. L.	Punonjes Tatimesh Nj.Ad Krahës	21.02.2022	
7	P. M.	Punonjës Tatimesh Nj.Adm Luftinjë	01.10.2013	
8	J. Z.	Punonjëse Tatimesh Nj.Adm. Qesarat	02.02.2023	

Burimi: Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, për vitin 2022 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Memaliaj nga taksat dhe tarifave.

Taksat dhe Tarifave e aplikuar dhe arkëtuara nga Bashkia Memaliaj.

Përgjatë vitit 2022, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:

- Paketa fiskale për vitin 2022 është miratuar me VKB nr.1888/1, datë 17.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me vendim nr. 52 me nr. 1175/1 prot., datë 29.12.2021.

- Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Memaliaj, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur rreth 30 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2022 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Memaliaj dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

1.Biznes;

2.Ambulant;

3.Familjar;

4.Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përjashtuar institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2022
1	Biznesi i Madh	12
2	Biznesi i Vogël	154
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	7
4	Institucione	6
5	Familje	3902

Burimi: Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në lekë, për vitin 2022, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMERTIMI	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
	Te ardhura nga taksat vendore	13,690,000	9,934,278	73%
1	Taksë biznesi		81,410	
2	Taksë pasuri e paluajtshme (Ndërtesa)	3,000,000	1,444,325	48%
3	Taksë mbi tokën bujqësore	5,600,000	3,303,203	59%
4	Taksë trualli	480,000	71,215	15%
5	Taksë tregu	480,000	249,290	52%
6	Taksë e efekt. në infrast. Nga ndërtimet e reja	840,000	667,472	79%
7	Taksë regjistrimi automjeti	2,450,000	3,965,167	162%
8	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	180,000	30,816	17%
9	Taksë tabelle	240,000	121,380	51%
10	Taksa të kalimit të pronësisë	420,000	0	0
B	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	16,310,000	11,255,716	69%
1	Tarifë pastrimi	2,600,000	1,711,854	66%
2	Tarifë gjelbërimi	500,000	239,935	48%
3	Tarifë ndriçimi	500,000	264,635	53%
4	Tarifë leje transporti	213,000	281,220	132%
5	Tarifë parkimi	100,000	156,460	156%
6	Tarifë qira toka bujqësore	1,596,000	272,365	17%
7	Tarifë për objektet me qira	500,000	149,400	30%
8	Tarifë qira trualli për antenat	810,000	2,199,363	272%
9	Tarifë zënie hapësirë publike	138,000	72,080	52%
10	Të tjera tarifa	550,000	3,589,699	653%
11	Të tjera të të ardhura	176,000	70,000	40%
12	Tarifë për dru zjarri	1,530,000	329,700	22%
13	Tarifë për guroret	120,000	0	0
14	Tarifa për kullotat	1,657,000	0	0
15	Tarife për shtypshkrimet	320,000	41,387	13%
16	Tarifë shërbim varrimi	0	220,000	0
17	Detyrime të prapambetura	5,000,000	0	0
18	Kamate vonesa	0	213,568	0
19	Tarifë kuota ushqimore kopështi	0	420,140	0

20	Tarifë autorizimi Karburante	0	1,000,000	0
21	Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	0	13,000	0
22	Tarifë shkollimi	0	10,910	0
	TOTALI I TË ARDHURAVE A+B	30,000,000	21,189,994	71%

Burimi: Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme konstatojmë se realizimi i të ardhurave paraqitet në nivele të ulëta.

Për vitin 2022 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **30,000,000** lekë dhe janë realizuar në vlerën **21,189,994**lekë, ose 71% / rreth 8,810,006 lekë më pak nga plani. Në këto mos realizime të vitit 2022 të analizuar në nivel taksash dhe tarifash kanë ndikuar mos realizimi i:

- 1- Taksës së ndërtesës realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 48%
 - 2- Taksës bujqësore realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 59%.
 - 3- Taksës trualli realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 15%.
 - 4- Taksë tregu realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 52%.
 - 5- Tatim i thjeshtuar mbi fitimin realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 17%
 - 6- Taksës tabele-reklame realizimi i secilës është në vlera të minimale, ku për vitin 2022 është në masën 51%.
 - 7- Tarifë e zënies së hapësirave publikere realizimi i secilës për 2022 është në masën 52%.
 - 8- Tarifë vjetore pastrimi realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 66%.
 - 9- Tarifë vjetore gjelbërimi realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 48%
 - 10- Tarifë vjetore ndricimi realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 53% .
 - 11- Tarifë vjetore qira toka bujqësore realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 17% .
- Referuar krijimit dhe realizimit të të ardhurave konkludohet se programimi i të ardhurave nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pra planifikimi i të ardhurave nuk është bërë mbi baza reale dhe i studiuar apo i argumentuar në lidhje me shfrytëzimin e të gjitha burimeve të të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimit të këtyre detyrimeve. Gjithashtu në realizimin në nivele të ulta të të ardhurave ka ndikuar dhe puna e pamjaftueshme e Bashkisë Memaliaj për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe detyrimeve debitore.
- 12- Tarifë qira toka bujqësore realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 17% .
 - 13- Taksë trualli realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 15%
 - 14- Tarifë për dru zjarri realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 22% .

Me tejkallim paraqiten zërat, si:

- 1- Taksë rregjistrimi automjeti në masën 162%, kjo pasi nga Sektori i Taksave Bashkia Memaliaj është planifikuar 2,450,000 lekë, ndërsa arkëtimet janë në shumën 3,965,167 lekë, pra Sektori i Taksave Bashkia Memaliaj nuk ka bërë planifikim të saktë, **duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 e cila është në shumën 4,067,468 lekë;**

- 2- Tarifë qira truall për antenat, paraqitet me realizim në masën 272%, ku nga vlera e planifikuar prej 810,000 lekë është arkëtuar vlera 2,199,363 lekë. Nga Sektori i taksave Bashkia Memaliaj nuk është bërë planifikimi i saktë, nisur kjo dhe nga fakti i vitit të kaluar ku megjithëse fakti është në vlerën 1,682,230 lekë planifikimi është bërë sa një vit më parë;
- 3- Tarifë leje transporti nga 213,000 lekë është arkëtuar vlera 281,220 lekë ose 132 %.

Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Memaliaj sipas kategorive të tyre.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

Përmbledhëse makro për debitorët				
Në fund të vitit 2021 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
	8391	18,034,983	18,034,983	
Biznesi	108	4,450,252	4,450,252	
Institucione	6	528,000	528,000	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	2772	2,761,604	2,761,604	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	11	230,562	230,562	
Taksa e tokës bujqësore	2645	2,761,604	2,761,604	
Taksë Ndërtesë + Trual	2731	581,007	581,007	
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit				
Qira toke bujqësore	107	4,450,286	4,450,286	
Objekte me Qira	3	26,400	26,400	
Pyje kullota	6	245,268	245,268	
Tarifa e Licencimit për karburantet	2	2,000,000	2,000,000	
Krijuar brenda vitit 2022	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
Biznesi	122	3,037,384	3,037,384	
Institucione	6	132,000	132,000	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	1729	1,653,566	1,653,566	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	19	305,886	305,886	
Taksa e tokës bujqësore	2477	3,970,195	3,970,195	
Qira toke bujqësore	64	614,709	614,709	
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit				
Tarifa e licencimit për karburantet	2	400,000	400,000	
Në fund të vitit 2022 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
Biznesi	122	7,487,636	7,487,636	
Institucione	6	660,000	660,000	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	1729	4,415,170	4,415,170	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	30	536,448	536,448	
Taksa e tokës bujqësore	3520	6,731,799	6,731,799	
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit				
Qira toke bujqësore	169	5,064,694	5,064,694	
Tarifa e licencimit për karburantet	2	2,400,000	2,400,000	
Total	5578	27,295,747	27,295,747	

Burimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Vlera e detyrimeve në fund të vitit 2022 është 27,295,747 lekë për taksat dhe tarifatat vendore, qiratë, gjobat, etj. Në krahasim me fundin e vitit 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitore me 9,260,764 lekë.

-Në mënyrë të përmbledhur vlera e detyrimit tatimor të vlerësuar, për taksa dhe tarifa vendore (gjelbërim, pastrim, ndriçim, ndërtesë, truall, toka bujqësore, ndikim në infrastrukturë, reklamë, tabelë, zënie të hapësirës publike, licencim i karburanteve), progresivisht deri më datë 31.12.2022 është në vlerën 27,295,747 lekë, ndërsa detyrimi tatimor i krijuar brenda vitit 2022 është në vlerën 10,113,740 lekë.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

III.1. Kategoria “Biznes” dhe “Institucione”.

Titulli Gjetjes 8: *Debitorët “Biznes”, “Institucione” dhe “Qiramarrës” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.*

Situata: Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Taksave Vendore, rezulton se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 108 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 4,450,252 lekë dhe 6 institucione në vlerën 528,000 lekë.

-Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 234 subjekte të kategorisë “Biznes” dhe “Institucione” në vlerën 7,522,649 lekë dhe 6 institucione në vlerën 660,000 lekë, pra gjithësej **8,182,649 lekë** për **240** subjekte, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

-Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Konkretisht në fillim të vitit 2022 janë debitor 114 subjekte për vlerën 4,978,252 lekë, ndërkohë në fund të vitit 2022, janë 240 subjekte në vlerën 8,182,649 lekë. **Konkretisht gjatë vitit 2022 janë krijuar 122 subjekte debitor për vlerën 3,169,384 lekë.**

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga Sektori i Financës dhe Tatimeve Bashkia Memaliaj, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), për të debitorëve nuk janë marrë masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

Përsa me sipër mbajnë përgjegjësi, z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, z E. L. Specialist, z.A. G.Specialist, z. Sh. L. specialist tatimesh (NJA Fshat Memaliaj), znj. K. V., ishspecialiste tatimesh (NJA Qesarat), z. M. L. specialist tatimesh (NJA Krahës), z.P. M., specialist tatimesh (NJA Lutfinjë), znj. M. Ç., specialist tatimesh (NJA Buz).

“Subjektet qiramarrës”.

Qira për tokën bujqësore.

Bashkia Memaliaj administron 254 kontrata qiraje për tokën bujqësore në NJA Memaliaj Fshat, Luftinjë, Krahës, Buz dhe Qesarat të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2022 dhe me afat kryesisht 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas përcaktimit në VKM-në 373 datë 20.06.2018 “Për tokën bujqësore”, konkretisht 6,000 lekë/Ha/vit.

Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Memaliaj nga qiraja e tokës bujqësore janë gjithësej 2,078,389 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, u konstatua se në fund të vitit 2021 janë debitor 105 subjekte në vlerën 4,450,286 lekë. Në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 konstatohet se janë debitor 169 subjekte për vlerën 5,064,964 lekë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar 64 subjekte për vlerën debitore 614,709 lekë⁶⁶. Gjithashtu konstatohet se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023.

⁶⁶ Lista e subjekteve debitore në fund të vitit 2022, bashkëlidhur.

Për arkëtimin e vlerës debitoare të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit “zgjidhja e kontratës” në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbartimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. E. M., Përgjegjës i sektorit të Bujqësisë pranë Bashkisë Memaliaj, znj. V. Gl., NJA Memaliaj Fshat, z. Sh. H., NJA Qesarat, z. A. H., NJA Lutfinjë, z. F. I., NJA Buz dhe z. L. H., NJA Krahës.

Kriteri: Lidhja 2, tabela 2 në VKM nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar;

Paketa fiskale e vitit 2022, pika 4, pika 17, shkronja “b”;

Neni 3 dhe neni 4 në Ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar;

Pika 2 në nenin 89 në Kreu XI të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1 dhe 2 në nenin 4 dhe neni 22/5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Ndikimi: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj në vlerën 5,064,995 lekë, nga të cilat 614,709 lekë janë krijuar brenda vitit 2022.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerë **8,182,649 lekë**.

Rekomandimi: Sektori i Tatimeve në bashkëpunim me Sektorin e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare **5,064,995 lekë**.

Rekomandimi: Sektori Ligjortë marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Kontratat e qirave për antenat

Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Memaliaj dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri më datë 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligj nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

-Ligj nr.57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;

-VKM nr.54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;

-Kontratat e lidhura me subjektet juridike/fizike për përdorim të fondit pyjor/kullosor/tokës bujqësore, banesave sociale, dyqaneve.

-Në përfundim të auditimit u konstatua se janë gjithësej 2 subjekte debitor në vlerën 800,000 lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Memaliaj, për marrjen me qira të objekteve të ndryshme, pasqyruar si më poshtë:

Subjekte Qiramarrës Debitor	Principal	Kamatvonesë	Gjithësej
2	800,000	-	800,000

Burimi: Bashkia Memaliaj

Titulli i Gjetjes 9: *Keq administrim dhe mos arkëtim i kontratave të qirave për antenat.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Memaliaj/ish Komunat me palët e treta, rezulton se janë lidhur 3 kontrata qiraje për antenat në fondin pyjor/kullor në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 1,100,000 lekë të cilat janë likuiduar për vitin 2022 vlera 300,000 lekë, **duke mbetur për likuidim vlera 800,000 lekë, të cilat kanë krijuar të ardhura të mungura për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.**

Referuar kushteve të kontratës nenit 4, pika 4.2, pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet brënda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës për llogari të institucionit.

Gjithashtu nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të nenit 10, pika 10.1, nga Bashkia zgjidhet kontrata për mospërmbushje të kushteve.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Sektori i Bujqësisë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Memaliaj, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj).

-Gjithashtu është konstatuar se kontrata e qirasë me nr. 12/3 prot., datë 14.01.2015 e lidhur midis ish Komunës Buz përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës Buz, z. B. S.dhe subjektit V. A.me Administrator D. Z. M. rezulton se, afati i kontratës së sipërcituar ka mbaruar më datë 11.11.2021, pra kontrata nuk është rinovuar si dhe nuk është likuiduar detyrimi vjetor.

Kriteri: Mos zbatimi i nenit 4 të kontratës.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave që menaxhojnë kontratat e qirave.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori Ligjor në bashkëpunim me sektorin e Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masat e nevojshme dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 800,000 lekë, nga kontratat e qirave për antenat. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Memaliaj të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj gjithashtu dhe për kontratat që u ka mbaruar afati, Sektori Ligjor të marrë masat e nevojshme për rinovimin e kontratave të qirasë.

➤ *Të dhënat mbi regjistrimin e subjekteve tatimpaguese dhe situatën e statusit të subjekteve aktiv dhe të mbyllur.*

Sipas të dhënave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore gjendja e subjekteve të biznesit privat që ushtrojnë aktivitet në territorin në juridiksionin e Bashkisë Memaliaj paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktivitetin	Gjendja në fund të vitit 2022
1	Biznesi Vogël	2022	167	2	10	159
2	Biznesi Madh	2022	12	0	0	12
	Gjithsej	2022	179	2	10	171

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për periudhën objekt auditimi evidentohen 2 regjistrime të reja në biznesin e vogël dhe janë mbyllur 10 subjekte të biznesit të vogël, duke arritur në 171 biznese për Bashkinë Memaliaj.

-Nga të dhënat e Sektorit të Tatimeve dhe në bazë të korrespondencës rezultoi se ekzistojnë subjekte të pa licencuar (QKB), të cilat janë evidentuar nga verifikimet në terren.

Titulli Gjetjes 10: *Mbi 37 subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi të pa licencuara në vitin 2022 dhe evazioni fiskal i shkaktuar.*

Situata: Për vitin 2022 në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Memaliaj operojnë dhe ushtrojnë aktivitet 37 subjekte të biznesit të pa regjistruar në QKB, për të cilët nuk janë ndjekur

procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim dhe pagesën e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore, e për pasojë nuk kanë qenë objekt i taksave dhe tarifave vendore, duke sjellë një evazion fiskal dhe të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit (duke aplikuar tarifat më të ulëta në vlerë), për subjektet e pataksuara, do të kishim 26,200 lekë * 37 subjekte mesatarisht 969,400 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

Lista e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin biznesi të peregjistruar në QKB paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emer	Mbiemer	Lloji i Aktivitetit	Nr.	Emer	Mbiemer	Lloji i Aktivitetit
1	D.	S.	Shitje Me Pakicë	20	L.	M.	Rrobaqepsi
2	M.	J.	Shitje Me Pakicë	21	M.	B.	Shitje Me Pakicë
3	V.	L.	Sherbime	22	A.	Ç.	Shitje Me Pakicë
4	B. V.		Bujtinë	23	V.	H.	Shitje Me Pakicë
5	L.	Sh.	Shitje Me Pakicë	24	S.	D.	Kafene
6	F	Gj.	Kepucari	25	L.	A.	Bar-Restorant
7	Q.	Xh.	Kepucari	26	B.	Xh.	Shitje Me Pakicë
8	K.	K.	Rrobaqepsi	27	Sh.	S.	Dyqan Mishi
9	M.	Sh.	Shitje Me Pakicë	28	A.	Xh.	Kafene
10	N.	H.	Shitje Me Pakicë	29	R.	Ç.	Mulli Bloje
11	E.	C.	Parukieri	30	G.	V.	Shitje Me Pakicë
12	E.	E.	Bar Kafe	31	B.	H.	Punim Guri
13	Z.	S.	Bar Kafe	32	Sh.	A.	Baxho
14	B.	M.	Shitje Me Pakicë	33	E.	Z.	Shitje Me Pakicë
15	Y.	M.	Abulant	34	S.	M.	Bar-Kafe
16	A.	S.	Shitje Me Pakicë	35	N.	Ç.	Bar-Kafe
17	N.	H.	Kasap	36	B.	M.	Shitje Me Pakicë
18	V.	B.	Shitje Me Pakicë	37	L.	M.	Bar-Kafe
19	F.	B.	Bar Kafe				

Sa më sipër mbanë përgjegjësi: z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, z. E. L. dhe, z. A. G., Specialist tatimesh.

Kriteri: Neni 16, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime.

Ndikimi: Mos bashkëpunim me institucionet e tjera, të Qarkut Tepelenë, mos ndjekje të procedurave tatimore, dhe mungesë të të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos njohje e plotë e legjislacionit të taksave dhe mos veprim i Sektorit të Financës dhe i Taksave Vendore në menaxhimin e subjekteve.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitet, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje, të peregjistruar në QKB, dhe të ndjekë procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim. Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me QKB dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, për përcaktimin e statusit të këtyre bizneseve dhe për ato biznese që kanë aktivitet të hapur të merret informacion zyrtar, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar nivelin e të ardhurave nga subjektet fizik/juridik dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara në fund të periudhave ushtrimore të bëhet aplikimi i taksave e tarifave vendore.

➤ *Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifat vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrënguese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.*

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, për ndjekjen dhe procedurat e arkëtimit të borxhit në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime, nga ku rezultoi se:

Për vitin 2022 nuk janë ndjekur procedura të masave shtrënguese për uljen e borxhit tatimor përveç njoftimeve për likuidimin e detyrimeve tatimore. Të gjitha praktikat e paraqitura mungojnë procedurat e ndjekura për mbledhjen e detyrimeve të papaguara, por janë mjaftuar vetëm me njoftimet e subjekteve apo individëve, ku edhe ato janë të pjesshme.

- Për 7 subjekte, të identifikuar si debitorë në vlerën 2,625,214 lekë nuk është ndjekur procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të detyrimeve Tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër të parashikuar për arkëtimin e detyrimit.

Subjekti	Lloji i Aktivitetit	Nipti	Detyrim 31.12.2021	Detyrimi i Krijuar 2022	Arketime	Vlera Debitorë në Fund 2022
L. Shpk	Karburant	K.....P	992,047	992,047	0	1,984,094
F.Z.	Furre Buke	L.....S	28,550	28,550	0	57,100
A. S.	Auto Serani	L.....V	20,465	20,465	0	40,930
A.K. Sh.Pk	Sh.Kabllor	L.....J	160,600	160,600	0	321,200
A. 2018	F.Ndertimi	L.....M	61,100	61,100	0	122,200
R. Shpk	Karburant	L.....B	43,460	43,460	0	51,920
Zh. V.	Bar Restorant	L.....F	23,885	23,885	0	47,770
Shuma			1,330,107	1,330,107	0	2,625,214

Burimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nuk ka asnjë urdhër ekzekutiv të mbledhjes me forcë të detyrimeve bashkëpunim me institucionet e tjera për të minimizuar subjektet dhe familjet që nuk likuidojnë detyrimet.

-Nga dosjet e zgjedhura për auditim, nuk gjen zbatim ndryshimi ligjore i nenit 89 i ligjit të procedurave tatimore, ku thuhet se; “Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume **jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar**, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit”.

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitorë strukturat e Sektorit të Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, nenet 86-92 Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94.

Gjithashtu nga Sektori i Tatim Taksave për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181 “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”,

Përsa me sipër mbajnë përgjegjësi, z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, z. E. L. dhe z. A. G. Specialist tatimesh, z. Sh. L. specialist tatimesh (NJA Fshat Memaliaj), znj. K. V. specialist tatimesh (NJA Qesarat), znj. L. H. specialist tatimesh (NJA Krahës), z. P. M. specialist tatimesh (NJA Lutfinjë), znj. M. Ç. specialist tatimesh (NJA Buz).

Titulli Gjetjes 11: *Krijimi e debitorëve, procedurat e ndjekura për arkëtimin e borxhit tatimor dhe të ardhurat e munguara nga ndodhja e evazionit fiskal.*

Situata: Nga përpunimi i të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj,

konstatohet se nuk ka rregjiter të plotë për bizneset dhe familjarët me të gjitha të dhënat dhe detyrimet e për rrjedhojë nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta për debitorët që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave, si dhe nuk ka të dhëna për debitorët e krijuar para vitit 2018. Gjithashtu debitorët janë mbajtur jo në mënyrë progresive, por të shkëputur nga viti në vit, duke sjellë një mosevidentim të saktë të debitorëve nga viti 2018 deri në fund të vitit 2021, ku sipas të dhënave vlera e akumuluar e debitorëve për periudhën 2018-2021 është 31,410,740 lekë, ndersa në pasqyrat financiare të vitit 2021 gjendja e debitorëve nga taksat e tarifave vendore si pjesë e gjendjes së llogarisë 468 “debitorë të ndryshëm është në vlerën 12,200,301 lekë. Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitorë strukturat e Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Memaliaj, nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, Kreut XI - “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

Ndikimi: Pamjaftueshmëria e punës së Sektorit të Financës dhe Taksave Vendore në mbajtjen e plotë të regjistrit të tatimpaguesve dhe mungesa e kontrollit të territorit nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore në evidentimin e subjekteve aktiv dhe të ardhurave që ato realizojnë.

Shkaku: Mos njohje e plotë e legjislacionit të taksave dhe mos veprim i Sektori i Shërbimeve ndaj Taksapaguesve në menaxhimin e subjekteve.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Financës dhe i Taksave Vendore, Bashkia Memaliaj të marrë masa për hartimin e një regjistri të plotë e të saktë për të gjithë Bashkinë, në mënyrë që të evidentohen të gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitetet, me të gjitha të dhënat për bazën e tatueshme, dhe të aplikojnë për secilin në mënyrë të saktë taksat dhe tarifave vendore që kanë detyrim ligjor, sipas paketës fiskale të miratuar. Të kryhet faturimi dhe njoftim vlerësimi i të gjithë bizneseve që kanë detyrimeve si dhe të kryhet evidentimi dhe kontabilizimi i pagesave të kryera dhe nxjerrja e saktë e debitorëve në fund të çdo viti ushtrimor

- Sektorit Financës dhe i Taksave Vendore, bazuar në nenin 70/3, nenin 90, neni 91 dhe nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët, si dhe ndërmarrë të gjitha masat shtrënguese në rast mos pagesash, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **27,295,747 lekë**.

Agjentët tatimorë

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga AKSH derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Memaliaj brenda datës 5 të çdo muaji. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Memaliaj janë paraqitur në Tabelë.

Tabela nr. 6: Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Memaliaj (lekë)

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2022
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	31
D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	3,965
Z.V.R.P.P (AKSH)	Taksa e kalimit të pronësisë	
DPT & DPD	Renta Minerare	
Ujësjellës-Kanalizime	Taksë ndërtese/ Tarifë shërbimi	578,000
TOTALI		581,996

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë realizimi.

Bashkia Memaliaj nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.

Titulli i Gjetjes 12: *Keqmenaxhimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale.*

Situata: Në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Gjirokastër dhe Drejtoria e Vendore e ASHK Tepelenë, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2022, i paraqitur nga Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj. Nga DVASHK Gjirokastër dhe DVASHK Tepelenë, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).

Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës nuk është zbatuar pika 5 në paketën fiskale të Bashkisë Memaliaj për vitin 2022, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2022, nuk janë marrë masa për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër situata ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI, konstatohet edhe sa i përket arkëtimin të TNI për debitorët e rezultuar deri në datë 31.12.2021, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës dhe Sektorit të Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, të ndjekin procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitore progresive dhe e ndarë sipas viteve.

TNI për legalizimin e objekteve Informale - Viti 2022

Debitor TNI	Subjekte	Vlera
Gjithësej progresive	30	536,448
Nga të cilat në 2022	19	305,886
Nga të cilat progresive deri në 2021	11	230,562

Burimi: Sektori i Urbanistikës, Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Memaliaj konstatohet se:

-Vlera debitore progresive është 536,448 lekë për 30 subjekte (nga të cilat 19 subjekte për vlerën 305,886 lekë krijuar në vitin 2022).

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, znj. V. K., Përgjegjëse e Sektorit të Urbanistikës, z. E. L., specialist i Tatimeve, z. A. G., specialist i Tatimeve.

Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, Paketa Fiskale 2022, Pika

5.

Ndikimi: Të ardhura të munguara në vlerën 536,448 lekë.

Shkaku: Mungesa e marrjes së masave shtrënguesenë mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 536,448 lekë, sipas listës që disponon Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Tepelenë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit pranë Bashkisë, për objektet që përfitojnë nga legalizimi.

Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Memaliaj.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Memaliaj mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, në zbatim të legjislacionit në fuqi:

-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

-Ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017;

- VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

- VKB për miratimin e paketës fiskale;

- Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Titulli i Gjetjes 13: Mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i Liçencave/Autorizimeve të subjekteve që tregtojnë karburante.

Situata: Në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Memaliaj dhe në Njësitë Administrative, Sektori Ligjor dhe Sektori i Tatimeve në Bashkinë Memaliaj, struktura e cila lëshon autorizimet për tregtimin e karburantit me pakicë të njëjësive të shitjes së lëndëve djegëse, vendosi në dispozicion të grupit të auditimit, dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike dhe që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2022 në Bashkinë Memaliaj

Nr.	Subjekti	Adresa ku ushtron aktivitet sipas QKB	Afati i Autorizimit		Detyrimi 31.12.2022	Detyrimi i krijuar 2022	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi				
1	G. O.shpk	Rr.Nacionale Tepelenë Memaliaj, pranë Urës	04.05.2020	04.05.2025			0	0
2	K. shpk	Rr.Nacionale, ish fabrika e fosforit Memaliaj	15.04.2022	15.04.2027		1,000,000	1,000,000	0
3	R. shpk	Rr.Nacionale Tepelenë Levan Qesarat	-	-	1,000,000	200,000	0	1,200,000
4	L. shpk	Rr.Nacionale Tepelenë Levan Krahës	-	-	1,000,000	200,000	0	1,200,000
SHUMA					2,000,000	1,400,000	1,000,000	2,400,000

Burimi: Sektori Ligjor, Sektori i Tatimeve, Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të paraqitura në Bashkinë Memaliaj, për vitin 2022 ushtrojnë këtë aktivitet 4 subjekte. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2022, janë debitorë 2 subjekte për vlerën 2,400,000 lekë gjithësej dhe detyrim i krijuar për vitin 2022 janë debitorë 2 subjekte për vlerën 400,000 lekë. Konkretisht subjektet janë:

1. OE “R.” Shpk, me adresë Njësia Administrative Qesarat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë.

2. OE “L.” Shpk, me adresë Njësia Administrative Krahës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithësej 200,000 lekë.

- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Sektori i Taksave Vendore, pranë Bashkisë Memaliaj, përgjatë vitit 2022 nuk i është drejtuar me shkresë subjekteve për pajisjen me licencën për ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu përgjatë vitit 2022 nuk ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet Sektorit Taksave Vendore dhe Policisë Bashkiake, për penalizimin e subjekteve që nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në tregëtimin e karburanteve.

- Për subjektet e mësipërme nuk administrohen masa shtrënguese (bllokim të llogarive bankare).

- Pra sa më sipër konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017.

- Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2022) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 2 subjekte për 2 stacione shitje të karburantit nuk kanë aplikuar për licencim/nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Memaliaj në vlerën 400,000 lekë.

Sa më sipër mban përgjegjësi z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, z. E. L. dhe, z. A. G., Specialist të Tatimeve, z. L. H., Administrator i Njesisë Krahës, z. Sh. H., Administrator i Njesisë Qesarat, z. M. L., specialist tatimesh për Njësinë Administrative Krahës dhe znj. K. V., specialiste tatimesh në Njësinë Administrative Qesarat.

Kriteri: Pika 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

Ndikimi: Veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë me vlerë 2,400,000 lekë.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave në zbatimin e kuadrit ligjorë.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Sektori e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Ligjor dhe me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregëtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre.

Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

Rekomandimi: Sektori e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Ligjor Bashkia Memaliaj, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrimit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 2,400,000 lekë.

Për realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Memaliaj.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Memaliaj mbi arkëtimin e tarifës së ndotjes së mjedisit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private në Bashkinë Memaliaj, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Paketa fiskale e vitit 2022, Tarifat Vendore, gërma “dh”;
- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2022 - 31.12.2022;
- Leje ndërtimi, njoftim i fillimit dhe përfundimit të punimeve;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa, sipas regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1.Përshkrimi i situatës.

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u auditua dokumentacioni për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Memaliaj) ku rezultoi se përgjatë vitit 2022 (përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2021, por kanë përfunduar në vitin 2022) kanë kryer punime ndërtimi gjithësej 5 subjekte, të cilët nuk janë pajisur me NIPT sekondar e për rrjedhojë nuk janë taksuar për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, pasqyruar si më poshtë vijon:

Tarifa e pastrimit, ndricimit dhe gjelbërimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private⁷, për 2022

VITI 2022								
N r	Objekti i Prokurimit/Leja e Ndërtimit	Vendndodhja	Vlera e tenderit/Sip e punimeve	OE/Subjekti ndërtues	NIPT	Kohëzgjatja e punimeve	Tarifa e past,ndric, gjelb	Detyrimi
		Bashkia			(Lekë)	Filluar		
1	Ndërtimi i U rajonal për fshatrat V. L. Q. AV. T. L. Zh. K e Q. M.	Memaliaj	410,176,390	BOE “K”, “E. C.” & “A. G”	L9; K6; L9;	09.06.2021	90,000	90,000
2	Rikonstruksioni segmentit Rrugor “B.-V. M.-A. e M.-L.-Q. e K.” faza e III	Memaliaj	11,918,400	“S. 7” shpk	K.....Ë	25.05.2022	30,000	30,000
3	Permirsimi Rr të NjA, rere bituminoze.	Memaliaj	4,879,000	“A.” shpk	J.....O	12.09.2022	30,000	30,000
4	Kalim me Tuba betoni prroi Xh.	Memaliaj	1,959,151	“V. K.” shpk	J.....Q	08.11.2022	20,000	20,000
5	Izolim Tarracave	Memaliaj		E.-0 shpk	L.....M	23.12.2022	30,000	30,000
Total								180,000

Burimi: Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, Sektori i Taksave Vendore dhe Sektori Ligjor, Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes 14: Keqmenaxhimi i tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Memaliaj.

Situata: Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Memaliaj të cilat kanë kryer punime ndërtimi.

- Sa më sipër, konstatohet se në paketën fiskale për vitin 2022, janë përjashtuar nga pagesa e tarifës shërbimeve publike (gjelbërim, pastrim, ndriçim) subjektet të cilat kryejnë punime

⁷ Subjektet që kanë kryer punime ndërtimi për llogari të investitorit privat.

ndërtimi në Bashkinë Memaliaj dhe NJA, financuar nga fondet publike, megjithëse ato kanë përfituar prej shërbimeve publike të ofruara (pastrim, gjelbërim, ndricim) nga Bashkia Memaliaj. Ky përjashtim që i është bërë këtyre subjekteve, bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën “b” të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 35, shkronjën “f” të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Arkëtimi i tarifës së shërbimit dhe pastrimit.

- Në auditimin e kryer për ndjekjen e procedurave në krijimin e të ardhurave nga tarifat vendore për pastrimin dhe shërbimin ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi, u konstatua se nga Sektori i Tatimeve, Bashkia Memaliaj, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit dhe shërbimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë. Nga përlogaritjet e kryera rezultoi se për vitin 2022 në 5 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit në vlerën 180,000 lekë gjithësej, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

- Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mosraportimit pranë Sektorit të Financës dhe Tatimeve Bashkia Memaliaj, të lejeve të ndërtimit të dhëna për subjektet e mësipërme, por edhe nga puna e pamjaftueshme e sektorit të financës dhe tatimeve Bashkia Memaliaj në verifikimin në terren të subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Memaliaj.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. Gj. G., Kryeati në detyrë i Bashkisë Memaliaj, znj. V. K., Përgjegjëse Sektori e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, znj. Xh. K., përgjegjëse e sektorit Ligjor, z. E. L. dhe z. A. G., specialist i Taksave Vendore.

Kriteri: Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Tarifat Vendore, gërma “dh” në Paketën Fiskale të Bashkisë Memaliaj.

Ndikimi: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj në vlerën 180,000 lekë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Bashkisë Memaliaj (shkëmbimi informacionit ndërmjet Sektorit të Urbanistikës dhe Sektorit të Tatimeve), si dhe puna e pamjaftueshme e inspektimit në terren nga inspektorët e Sektorit të Tatimeve.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Sektorin e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt (Nius) sekondarë dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa maturuar në vlerën **180,000 lekë**.

III.2. Familjet.

Titulli i Gjetjes 15: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”.

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Memaliaj dhe NJA, për vitin 2022 janë taksuar 3902 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

NJA	Familje të taksuara	Familje sipas Gj.Civile
Bashkia Memaliaj	1068	2489
Memaliaj Fshat	746	887
Krahës –Qesarat	988	2039
Luftinjë-Buz	1100	1531
Total	3902	6946

Burimi: Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Me qëllim vlerësimin nëse nga Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga Sektori i Financës dhe Tatimeve Bashkia Memaliaj me informacionin e administruar nga Gjëndja Civile.

- Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Memaliaj dhe NJA janë 6946 familje, pra ndërkohë në vitin 2022 janë taksuar 3902 familje.

- Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Memaliaj nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit për qytetin Memaliaj, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 3,400 lekë * 1421 familje taksuar më pak = **4,831,400 lekë** planifikuar më pak si dhe për Njësitë Administrative për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 800 lekë * 1623 familje taksuar më pak = **1,298,400 lekë**.

- Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Financës dhe Taksave Vendore Bashkia Memaliaj nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018⁸, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Memaliaj duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Memaliaj dhe NJA.

- Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. E. Ll., specialist Sektori të Tatimeve, z. A. G., specialist i Sektorit të Tatimeve, z. Sh. L., K. V.j, M. C., P. M. dhe M. L., specialist tatimesh pranë NJA-ve.

- Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Memaliaj është përcaktuar në paketën fiskale se do ta realizojnë nëpërmjet Agjentit Tatimor siç është Ujësjellësi-kanalizime Sha Memaliaj. Për vitin 2022 Bashkia Memaliaj nuk ka lidhur akt-marrëveshje me Shoqërinë UK sha Memaliaj në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksës së ndërtesës dhe tarifave të pastrim-gjelbërim-ndriçimit për abonentët familjarë, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.9632 datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar neni 35 pika 2 e cila përcakton: “*Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcakton nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga një agjent. Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të”*”.

Në bazë të VKB nr. 52, datë 17.12.2021, në paketën fiskale “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Memaliaj” pika “Agjenti Tatimor”, në të cilën përcaktohet se: “për vjeljen e: 1) Tarifa e pastrimit për cdo familje brenda qytetit Memaliaj; 2) Tarifa e gjelbërimit për cdo familje brenda qytetit Memaliaj; 3) tarifa e Ndrimit për cdo

⁸ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

familje brenda qytetit Memaliaj; 4) Taksë e truallit për ndërtesat për cdo familje brenda qytetit Memaliaj; Agjent tatimor për mbledhjen e këtyre taksave tarifave do të jetë Sha “Ujësjiellës kanalizime” e cila do ta shtojë në faturën e konsumit të ujit për cdo familje. Sha Ujësjiellës kanalizime si agjent tatimor do të përfitojë 4% të shumës së mbledhur dhe do të derdhë për llogari të bashkisë Memaliaj 96% të shumës së mbledhur jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës”

- Në Njësiti Administrative, për banesat të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjiellësit, taksa e banesës, ndriçimit, gjelbërimit nuk faturohet dhe nuk është mbledhur nga Shoqëria “Ujësjiellës -Kanalizime” Sha Memaliaj dhe as nga Bashkia Memaliaj.

- Nga Administratorët e Njësive Administrative dhe punonjësit e taksave nëpër NJA nuk është kryer asnjë përpjekje dhe punë për evidentimin e familjeve që janë abonentë me Ujësjiellësin dhe ato që nuk kanë kontrata me Ujësjiellësin, si dhe sa familje nga ato të rregjistruara në Gjendjen Civile jetojnë në fshatra, duke krijuar një database për tatimpaguesit me të dhënat e duhura për ngarkesën dhe faturimin me taksa dhe tarifa, detyrim ligjor për tu paguar nga taksapaguesit për njësinë vendore në këmbim të shërbimeve që marrin nga shërbimet e Bashkisë.

- Në lidhje me Taksën e Banesës për familjarët, u konstatua se Bashkia Memaliaj nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave. Gjithashtu nuk plotësohet njoftim detyrimi për familje, për taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Agjenti Tatimor në Paketën Fiskale të Bashkisë Memaliaj.

Ndikimi: Mos evidentimi i saktë i numrit të familjeve për efekt taksimi të tyre ndikon negativisht në fondet që mund të arkëtojë Bashkia Memaliaj nga kategoria “Familjar”.

Shkaku: Mungesa e përditësimit të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjar, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, rezultojnë 6,129,800 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

Titulli i Gjetjes 16: Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Memaliaj.

Situata: Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit dhe taksën e ndërtesës.

Numër familje debitore sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa

Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	Në fund të vitit 2021 (progresive)		Krijuar brenda vitit 2022		Në fund të vitit 2022 (progresive)	
	Nr	Vlerë				
	2848	2,761,604	2477	3,919,371	2505	6,680,975

Burimi: Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 2505 familje debitorë për vlerën 6,680,975 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 janë 2477 familje debitorë për vlerën 3,919,371 lekë.

- Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitorë e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifave vendore, në krahasim me fundin e vitit 2021 është rritur me 1,157,767 lekë, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

- Sa i përket familjeve debitorë, rezulton se nga Sektori i Tatimeve dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitorë.

➤ Gjithashtu ndaj Bashkisë Memaliaj rezulton të jetë debitor UK Sh.A për vitin 2022 në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”. Detyrimi që ka UK. ShA Memaliaj në fund të vitit 2022 (në rolin e agjentit tatimor) ndaj Bashkisë Memaliaj është në vlerën prej **1,125,309 lekë**. Nga sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Memaliaj për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor UK Sh.A Memaliaj, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”.

- Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. Gj. G.me detyrë Kryetari i Bashkisë Memaliaj, z. E. L. dhe z. A. G., specialist i Tatimeve, z. M. L., znj. K. V.j, z. P. M., znj. M. C. dhe z. Sh. L. specialist tatimesh pranë NJA-ve.

Kriteri: Pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Ndikimi: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj në vlerën 6,680,975 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA-ve, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Memaliaj, për arkëtimin e tyre.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare prej 6,680,975 lekë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga agjenti tatimor UK SH.A Memaliaj prej 1,125,309 lekë.

Titulli i Gjetjes 17: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksës së tokës bujqësore.

Situata: Sipas të dhënave të Sektorit të Financës dhe Tatimeve dhe nga NJA rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 4501 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 4539 ha, të cilat të ndara sipas kategorisë së tokës dhe Njësive Administrative paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Nr. fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqja e tokës së ndarë (ha)	Sipërfaqja e tokës së dhënë me qira	Nr. i familjeve të trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
1	Komuna Krahës	10	1102	-	988
2	Nj. Adm Luftinjë	15	1037	-	1201
3	Komuna Buz	13	1043	41	825
4	Komuna Qesarat	7	681	108	741
5	Komuna Fshat Mem.	1	676	10.6	746

	Shuma	41	4539	159.6	4501
--	--------------	-----------	-------------	--------------	-------------

Planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme të sipërfaqes së tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere, informacion i cili i dërgohet nga NJA Sektorit të Taksave Vendore në fazën e përgatitjes së buxhetit. Këto të dhëna nuk janë të sakta, edhe për faktin se ka mosrakordim të dhënash në mes të dhënave të NJA dhe të dhënave që disponon Sektori i Tatimeve. Planifikimi i të ardhurave sipas Bashkisë Memaliaj për vitin 2022 i taksës së tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Memaliaj

Nr	Kategorit e tokes	Sip/Ha Bashkia Memaliaj	Sip/Ha NJ.A. Krahes	Sip/Ha NJ.A. Qesarat	Sip/Ha NJ.A. Mem.Fshat	Sip/Ha NJ.A. Luftinje	Sip/Ha NJ.A. Buz	Vlera/Ha	Plani/Leke
1	Kategoria II	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Kategoria III	480	25	135	243	55	22	1,400	672,000
3	Kategoria IV	555	42	148	184	156	25	1,350	749,250
4	Kategoria V	723	174	182	135	184	48	1,250	903,750
5	Kategoria VI	621	190	110	84	150	87	1,200	745,200
6	Kategoria VII	1114	340	56	16	282	420	1,100	1,225,400
7	Kategoria VIII	1046	331	50	14	210	441	1,100	1,150,600
	Totali	4539	1102	681	676	1037	1043		5,446,200

Për marrjen e të dhënave të sakta mbi sipërfaqen e tokës së shpërndarë në disponim të fermerëve dhe të asaj në pronësi të Bashkisë u kërkua korrespondenca zyrtare e Bashkisë Memaliaj me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, cila nuk ekzistonte. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës rezulton se: Nga NJA disponohen regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere. Duhet theksuar se nuk kishte një përditësim të këtyre regjistrave në 10 vitet e fundit, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme.

- Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Ndikimi: Mos evidentimi i saktë i sipërfaqes së tokës bujqësore, çon në mos planifikimin e saktë të kësaj, duke rritur shpresat për më tepër të ardhura dhe për rrjedhojë ndikon negativisht në planifikimin e shpenzimeve të Bashkisë Memaliaj.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorit Bujqësisë të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të patakuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

Titulli i Gjetjes 18: Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksën e tokës bujqësore.

Situata: Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për taksën e tokës bujqësore.

Taksa e tokës bujqësore	Në fund të vitit 2021 (progresive)		Krijuar brenda vitit 2022		Në fund të vitit 2022 (progresive)	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
	2772	2,761,604	1729	3,970,195	3520	6,731,799

Burimi: Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive vlera debitorësh është 2,761,604 lekë dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3520 familje debitorësh për vlerën 6,731,799 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 është krijuar 3,970,195 lekë debi. Pra në

krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitoare për taksën e tokës bujqësore, ç'ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e kësaj takse.

- Sa i përket familjeve debitoare, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitoare.

Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, z. L. H., Administrator i NJA Krahës, znj. V. Xh., Administratore e NJA Memaliaj Fshat, z. Sh. H., Administrator i NJA Qesarat, z. F. I., Administrator i NJA Buz, z. A. H., Administrator i NJA Luftinjë, zj.K. V.j, z. P. M., z. M. Ç., z. Sh. L. dhe z.M. L., specialist tatimesh pranë NJA-ve.

Kriteri: Pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Ndikimi: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj në vlerën 6,731,799 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare prej 6,731,799 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Përdorimi i të ardhurave.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar përkatësisht në vlerën 197,520 mijë lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime.

Përdorimi i të ardhurave – viti 2022 (000 lekë)

Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Nga të ardhurat e veta
1	Paga 600	
2	Sigurime shoqërore 601	
3	Shp. Operat 602	13,382
4	Transferta Korrente te brendshme 604	311
5	Transferta per familje dhe individe 606	200
6	Investime 230-231	9,000
	Totali	22,894

Burimi: Sektori i Financës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

- Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen mbajnë përgjegjësi:

1. z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj,
2. z. E. L., Specialist i Sektorit të Taksave Vendore Bashkia Memaliaj,
3. z. A. G., Specialist i Sektorit të Taksave Vendore Bashkia Memaliaj,
4. znj. V. K., Përgjegjëse e Sektorit Zhvillimit Urban dhe Kadastrës,
5. znj. Xh. K., Përgjegjëse e Sektorit Ligjor,
6. znj. V. Xh., z. L. Halili, z. Sh. H., z. F. I., z. A. H., Administratorë të NJA-ve Memaliaj,
7. z. Sh. L.i, znj. K. V.j, znj. M. Ç., z. P. M., z. M. L., Specialist Tatimesh në Njësitë Administrative.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022.

Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Në procesin e auditimit mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura për gjatë periudhës raportuese ushtrimore (01.01.2022 deri 31.12.2022) në Bashkinë Memaliaj u konstatua se: Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Memaliaj periudha 2022 (*Formati nr.1*) është depozituar në Degën e Thesarit Tepelenë me shkresë nr.413 prot, datë 28.02.2023 e konfirmuar nga dega e thesarit duke respektuar afatin ligjor i përcaktuar deri në datën 31 mars të vitit pasardhës, veprim në përputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhornimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe partitarët për llogaritë kreditore e debitore etj.

Konkluzion: Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes,

paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **pika 2.2** “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik”, ku ndër të tjera theksohet se: “.... - *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet. - Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme*” Kreu III, **pika 3.2** “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme” në të cilën përcaktohet: *Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njërive të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur rradhën kronologjike si më poshtë vijon: Nën*

Titulli i Gjetjes 18: *Mbi procedurat e mbajtjes së kontabilitetit dhe librat kontabël të mature për evidentimin e veprimeve kontabël.*

Situata: Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës nuk ka mbi mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënparagrafët 43,44,45.

Ndikimi: Pasaktësi në nxjerrjen e gjendjeve dhe pozicionimi i llogarive të bilancit.

Shkaku: Nga Sektori i Financës nuk është kryer procedurë e plotë në mbajtjen e kontabilitetit dhe të gjithë librat kontabël që të evidentojnë në cdo fazë këtë procedurë.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë llogjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Në fund të kryejë saktë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu, Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementët që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (Cash FLOË)”.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2022, të pozicionit financiar për Njësia Publike Bashkia Memaliaj;

Formati nr.1, paraqitet si më poshtë:

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2022, të pozicionit financiar Bashkia Memaliaj; Formatin nr.1, paraqitet në të dhënat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=898,892,985 lekë.

Aktivet	981,098,969 lekë
Pasivet	82,205,984 lekë
Aktivet neto	898,892,985 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **150,214,486 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në shumën 46,503,100 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 29,637,190 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 48,440,377 lekë.

Llogaritë e Klasës 4”Të tjera aktive afat shkurtra” në shumën 25,633,819 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	38,371,312	42,409,460	-4,038,148
50	Letra me vlerë	972,000	1,449,510	-477,510
532	Vlera të tjera	7,159,788	7,382,788	-223,000
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		46,503,100	51,241,758	-4,738,658

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 46,503,100 lekë, përbëhet nga: fondi i trashëguar nga transfertat e pakushtëzuar, sektoriale dhe të ardhurat e veta, gjendja e llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në shumën 38,371,312 lekë, gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në shumën 7,159,788 lekë dhe letra me vlerë në shumën 972,000 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2021-2022
31	Materiale	0	0	0
32	Inventar i imet	29,637,190	7,825,924	-21,811,266
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
Totali		29,637,190	7,825,924	-21,811,266

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Memaliaj në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 29,637,190 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 29,637,190 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -21,811,266 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën -21,811,266 lekë. - Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët” paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 7,825,924 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 29,637,190 lekë me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej 21,811,266 lekë, e cila përfaqëson pakësim të inventarit të magazinës për vitin 2022.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2021 në vlerën 45,277,065 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 48,440,377 lekë, ku kemi shtesa, duke e krahasuar me vitin paraardhës si rezultat i rritjes së debitorëve dhe kreditorëve.

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021
	Llogari të arkëtueshme		
411	Klientë e llogari te ngjashme	38,220,128	34,655,100
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	6,355,499	5,687,897
431	Tatime e taksa	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0	0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	2,173,028	1,978,015
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0
44	Institucione te tjera publike	0	0
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	0	0
4342	Te tjera operacione me shtetin(te drejta))	1,286,263	2,628,142
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0	0
Totali		48,440,377	45,277,065

	Të tjera aktive afatshkurtra	0	
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	25,633,819	17,395,686
	Totali	0	

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, duke u debituar për vlerën e faturave të palikujduara në 31.12.2022 në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llog. të lidhura me to”, në (pasiv të bilancit) veprim ky i gabuar, pasi për vlerën e furnitorëve (në aktiv të bilancit) debitohet llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) në aktiv të bilancit. Llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitoare të llogarisë 468 “Debitore të ndryshëm” në fund vitin 2022 sipas analizës së partitarit të kësaj llogarie në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15 nën-pika “b” në të cilën ndër të tjera përcaktohet: “b) Në fund të vitit ushtrimor, sipas situacionit të rakorduar me sistemin e thesarit, për përdorimin e fondeve buxhetore korrente dhe kapitale, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria 476, "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur" (për totalin e fondeve buxhetore të përdorura);
- Kreditohet llogaria 720, "Grant korrent i brendshëm" (për fondet buxhetore të përdorura për shpenzimet korrente të shfrytëzimit);
- Kreditohet llogaria 105, "Teprica e granteve kapitale të brendshme" (për fondet buxhetore të përdorura për shpenzime kapitale);
- Kreditohet llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)" (për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues).

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”

Pika 4.2 “Të ardhurat në NJQP dhe operacionet që lidhen me to” nën-pika: *Për funksionimin e llogarive të të ardhurave, veprimet kontabël në mënyrë më të përgjithshme paraqiten:Debitohet llogaria 411 në kredi të klasës 7, kur konstatohet shitja e një malli apo shërbimi, me arkëtim të mëvonshëm;*

Pika 3.3 Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën-pika: “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet |: “Llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm”.

Titulli Gjetjes 19: *Mbi gjendjen dhe kontabilizimet e pasakta në llog. 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”.*

Situata: *Gjendja e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” paraqitet në mbyllje të 2020 në vlerën 39,386,128 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, duke u debituar për vlerën e faturave të palikujduara në 31.12.2021 në kredi të llog. 401-408*

“Furnitorë e llog. të lidhura me to”, në (pasiv të bilancit) veprim ky i gabuar, pasi për vlerën e furnitorëve (në aktiv të bilancit) debitohet llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) në aktiv të bilancit. Llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitore të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund vitin 2021 sipas analizës së partitarit të kësaj llogarie në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pikat 3.3 dhe 4.2

Ndikimi: Pozicionimi në llog. e gabuar i gjendjes së debitorëve në llogarinë klientë ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me detyrimet e debitorëve që kanë ndaj Bashkisë, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 38,220,128 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2022, me artikujt kontabël në debi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to” në kredi të llog.411 “Klientë të ndryshëm” si dhe në debi të llog.468 “Debitorë të ndryshëm” në kredi të llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** paraqitet për vitin 2021 në vlerën 0 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Konkluzion: *Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,* e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 0 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari paraqitet me gjendje referuar analizës së debitorëve të paraqitur në CD bashkëlidhur.

Në fakt gjendja e kësaj llogarije paraqitet në gjendjen e llogarisë “411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”, e cila paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to”, veprim i gabuar kontabël.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Titulli Gjetjes 20: Mbi kontabilizimet e gabuara në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Situata: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 0 lekë, poashtu në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari paraqitet me gjendje referuar analizës së debitorëve të paraqitur në CD. Në fakt gjendja e kësaj llogarije paraqitet në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”, e cila paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën

38,220,128 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to”, veprim i gabuar kontabël.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

Ndikimi: Pozicionimi dhe veprimet e gabuara kontabël në llogaritë e arkëtueshme në aktiv të bilancit.

Shkaku: Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Konkluzion: Në aktiv të Bilancit në klasën 3 të llogarive të arkëtueshme janë paraqitur me gjendje debitore:

- në mbyllje të vitit 2022 në aktiv llog. 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba” në vlerën 6,355,499 lekë në kundërparti të llog. 42 “Detyrime ndaj personelit” në pasiv, llog.431 “Tatime e taksa” në vlerën 405,459 lekë në aktiv në kundërparti të llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa” në pasiv dhe llog.436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 2,173,028 lekë në aktiv në kundërparti të llog. 435 “Detyrime për sig. shoqërore” në pasiv.

Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, llog.431 “Tatime e taksa”, llog.436 “Sigurime shëndetësore” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit, për paradhënie të pa derdhura nga personeli i Bashkisë apo tatime e kontribute të pa ndalura nga Bashkia punonjësve, por janë detyrime që ka Bashkia ndaj punonjësve për pagat e dhjetorit të vitit ushtrimor si dhe detyrimet për tatimin e të ardhurave dhe kontributet e sigurimeve të ndalura të pa derdhura. Shuma e llogarive në vlerën prej 8,933,986 lekë në mbyllje të vitit 2022 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,286,263 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson. Gjendja e llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të pasqyronte detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërparti në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.llog	Emertimi i llogarise	Viti ushtrimor 2022	Viti paraardhës 2021
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	38.220,128	34,655,100
42	Detyrime ndaj personelit	6,355,499	5,687,897
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	4,05,459	357,911
435	Sigurime Shoqerore	2,173,028	1,948,015
		47,154,114	42,648,923

Pra gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të ishte paraqitur në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 42,648,923 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 47,154,114 lekë, gjithmonë nëse vlerat e llogarive të detyrimeve në pasiv të bilancit janë të sakta dhe reale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, **pika 32** në të

cilën përcaktohet se: *Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjste të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”*

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3** “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) *Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).*

b) *Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; - Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

c) *Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”.*

d) *Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër: - Debitohet llogaria 476, “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”; - Kreditohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”.*

Titulli Gjetjes 21: KLSH nga auditimi i PF konstaton se janë kryer kontabilizime të gabuara, duke deformuar informacionin kontabël dhe pozicionimin e llogarive të arkëtueshme në aktiv të bilancit dhe të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit.

Situata: Në aktiv të Bilancit në klasën 3 të llogarive të arkëtueshme janë paraqitur me gjendje debitore:

- Në mbyllje të vitit 2022 në aktiv llog. 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba” në vlerën 6,355,499 lekë në kundërparti të llog.42 “Detyrime ndaj personelit” në pasiv, llog.431 “Tatime e taksa” në vlerën 405,459 lekë në aktiv në kundërparti të llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa” në pasiv dhe llog.436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 2,173,028 lekë në aktiv në kundërparti të llog. 435 “Detyrime për sig. shoqërore” në pasiv.

Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, llog.431 “Tatime e taksa”, llog.436 “Sigurime shëndetësore” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit, për paradhënie të pa derdhura nga personeli i Bashkisë apo tatime e kontribute të pa ndalura nga Bashkia punonjësve, por janë detyrime që ka Bashkia ndaj punonjësve për pagat e dhjetorit të vitit ushtrimor si dhe detyrimet për tatimin e të ardhurave dhe kontributet e sigurimeve të ndalura të pa derdhura. Shuma e llogarive në vlerën prej 8,933,986 lekë në mbyllje të vitit 2022 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,286,263 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të pasqyronte detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërparti në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka

institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15/b ,59/a, Kreu III. pika 32, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8.

Ndikimi: Pozicionimi dhe veprimet e gabuara kontabël në llogaritë e arkëtueshme në aktiv të bilancit dhe të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit kanë sjellë një ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e njësisve shpenzuese në marrëdhënie me shtetin, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë earkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund vitit 2022 dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 0 lekë, në Formatin e Performancës së PF. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 17,395,686 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 25,633,819 lekë. Kjo llogari rakordon me gjendjen e llogarisë kundërpartit 467 “Kreditorë të tjerë” në pasiv të bilancit. Nga auditimi rezultoi se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në rregull, kjo në zbatim të Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- *Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”* në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 3,489,773 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 3,911,473 lekë. Po kështu dhe sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 3,489,773 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 3,911,473 lekë.

Nr.	PERSHKRIMI	Vlera	Shtesa	Paksime	Shuma
		31.12.2021	2022	2022	31.12.2022
1	Studim Gjeologjik per Varrezat Qytet Memalia	96,000	0	0	96,000
2	Projekt Rrruga Kallemb	390,000	0	0	390,000
3	Projekt Ujesjellsi Ceril	398,000	0	0	398,000
4	Projekt P F Memaliaj	424,000	0	0	424,000
5	Projekt qafa Mirin Ceril	390,000	0	0	390,000
6	Studime dhe kerkime	374,000	0	0	374,000
7	Studime dhe kerkime	619,600	0	0	619,600

8	Mbikqyrje punimesh Ura Martalloz	23,761	0	0	23,761
11	Mbikqyrje punimesh rruge	43,200	0	0	43,200
12	Mbikqyrje punimesh shkollat	10,560	0	0	10,560
13	Oponenc Teknike Axhensia e Luftinjes	125,452	0	0	125,452
14	Studim Projektim Kopshti Femijve	69,600	0	0	69,600
15	Studim Projektim Rruga Leshnje	60,000	0	0	60,000
16	Studim Projektim Fshat Memaliaj rruga	59,000	0	0	59,000
17	Studim Projektim Vorreza Qytet Memaliaj	49,000	0	0	49,000
18	Studim Projektim per rikon. e rrugeve	250,000	0	0	250,000
19	Studim Projektim per rikon. e rrugeve	57,600	0	0	57,600
20	Studim Projektim per rikon. e rrugeve	50,000	0	0	50,000
21	Studim Projekti Rehabilitim I Mbetjeve		421,700	0	421,700
	S H U M A	3,489,773	421,700	0	3,911,473

Konkluzion: Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 21 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizim. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36 i cili përcakton se: “Për aktivet afatgjata jo materialë, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%”.

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik **“Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”** (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm: a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;
- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera qëi shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**), paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”.

Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b.d** të cilat përcaktojnë: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe
- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe
- Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupit 23).

Titulli Gjetjes 22: Mbi kontabilizimet e aktiveve jo materiale në llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” në aktiv të bilancit dhe mos llogaritja e amortizimit për to.

Situata: Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 21 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 16/b.d, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 2 Klasa 2.

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizimit të aktiveve. Gjithashtu nuk janë kryer veprimet e llogaritjes së amortizimit për aktivet afatgjata jo materiale dhe të kryerjes së veprimeve kontabël përkatëse.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitet 2021-2022.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 858,840,728 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020, 826,973,010 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,421,532,982 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,438,859,768 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja ellog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** (me vlerë neto) paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 119,998 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në vlerë të njëjtë si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 119.998 lekë. Kjo gjendje nuk është e analizuar, pasi kjo vlerë nuk është e shpjeguar dhe e analizuar me emërtese se çfarë përfaqëson. Kjo vlerë është trashëguar nga ish-Komunat.

- **Gjendja ellog. 211 “Pyje, Plantacione”** (me vlerë neto) paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 277,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 277,000 lekë. Kjo gjendje nuk është e analizuar, pasi kjo vlerë nuk është e shpjeguar dhe e analizuar me emërtese se çfarë përfaqëson. Kjo vlerë është trashëguar nga ish-Komunat.

Titulli gjetjes 23: Mbi kontabilizimet në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119.998 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” .

Situata: Nga auditimi i PF konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119.998 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë.

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Ndikimi: Mungesa e analizës për vlerën 568,572 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 354,706,177 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 336,970,869 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 487,893,848 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 487,893,848 lekë. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në CD bashkëlidhur.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 464,534,207 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 443,266,649 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 853,789,360 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 855,748,512 lekë. Diferenca në rritje prej 1,959,152 lekë përfaqëson shtesën me pagesë në vlerën 1,959,152 lekë që i përket blerjes së aktivitetit: “Ndërtimi i këmbëzave ura Xhaxhaj” Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogarie nga viti 2020, në vitin 2021 paraqiten në CD bashkëlidhur.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në shumën 5,525,777 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 6,531,436 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në vlerë 12,725,874 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 14,836,688 lekë, për të cilat ka inventar fizik.

Analiza e gjendjes kontabël së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llog. 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"

Nr.	Pershkrimi	Vlera 01.01.2022	Shtesa 2022	Trans 218 2022	Shuma 31.12.2022	Amortizimi 2021	Teperica Ne Fund 2021	Amortizimi i Vitet 2022	Teperica Ne Fund 2022
1	Instalime ndricim publik rrjet elektrik	4,519,553	0	0	4,519,553	2,557,091	1,962,462	392,492	1,569,969
2	Instalime Makineri Vegla Pune	83,828	0	0	83,828	47,429	36,399	7,280	29,120
3	Instalime Makineri Vegla Pune	1,263,085	0	0	1,263,085	714,633	548,452	109,690	438,761
4	Instalime Makineri Vegla Pune	4,161,470	0	0	4,161,470	2,354,494	1,806,976	361,395	1,445,581
5	Instalime Makineri Vegla Pune	1,833,938	0	0	1,833,938	1,037,613	796,325	159,265	637,060
6	Pajisje Topografike	864,000	0	0	864,000	488,837	375,163	75,033	300,130
7	Kompjuter +projektor keshilli		864,000		864,000	0	0	0	864,000
8	Vend. kamera+instalime.		1,246,814		1,246,814	0	0	0	1,246,814
Shuma: Bashkia Memaliaj		12,725,874	2,110,814	0	14,836,688	7,200,097	5,525,777	1,105,155	6,531,436

- **Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti"** në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 2,427,133 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,903,247 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/A "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,774,350 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 21,735,890 lekë. Diferenca prej +11,961,540 lekë ka ardhur si rezultat i blerjeve me pagesë për dy copë mini eskavatorë.

Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti" me datë 31.12.2022

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Vlera	Shtesa	Shuma	Amortizimi	Teperica Ne Fund
			31.12.2021	2022	31.12.2022	31.12.2022	2022
1	Mjete Transporti	1	200,000	0	200,000	9,933	39,731
2	Mjete Transporti	1	180,000	0	180,000	8,939	35,758
3	Mjete Transporti	1	955,000	0	955,000	47,428	189,714
4	Mjete Transporti	1	1,182,750	0	1,182,750	58,739	234,957
5	Mjete Transporti	1	795,000	0	795,000	39,482	157,929
Shuma: A. Memaliaj			3,312,750	0	3,312,750	164,522	658,089
				Ne gjendje pune	NE/LEKE	0	
Nr.	Pershkrimi	Sasia	Vlera	Shtesa	Shuma	Amortizimi	Teperica Ne Fund
			31.12.2022	2022	31.12.2022	31.12.2022	2022
6	Mjeti Xhip ËBC1641221A183422	1	2,373,600	0	2,373,600	117,881	471,523
7	Mjete Kamjon veshkarkues	1	0	0	0	0	0
8	Mjete Eskavator Tip 3 CX	1	0	0	0	0	0
9	Mjete zjarrfikes	1	3,588,000	0	3,588,000	178,192	712,768
10	Autmjet chevrolet klas Captiva e kuqe	1	500,000	0	500,000	24,832	99,327
11	Minieskavator zin gome 5 ton	1	0	7,726,711	7,726,711	0	7,726,711
12	Minieskavator zin gome 1.9ton	1	0	4,234,829	4,234,829	0	4,234,829
Shuma: B. Memaliaj			6,461,600	11,961,540	18,423,140	320,904	13,245,158
Shuma: B. Memaliaj+2			9,774,350	11,961,540	21,735,890	485,427	13,903,246

- **Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik"** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 30,760,663 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 25,903,811 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël 56,952,552 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 58,247,832 lekë. Në këto gjendje përfshihet *shtesa me pagesë* në vlerën prej 1,295,280 lekë, që i përket blerjeve të kryera gjatë vitit ushtrimor 2022.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqiten në Formatin nr.7/A, dhe 7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" dhe vlerë neto të PF si më poshtë:

Emërtimi	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
c	1	2	3	4	5	8	9	10
I. AAGJ/JO MATERIALE	3,489,773	0	3,489,773	421,700	0	3,911,473	0	3,911,473
Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0			0	0	0
Studime dhe kerkime	3,489,773		3,489,773	421,700		3,911,473	0	3,911,473
Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0			0	0	0
II. AAGJ/ MATERIALE	1,421,532,982	563,182,027	858,350,955	17,326,786	48,704,731	1,438,859,768	611,886,758	826,973,010
Toka,troje, Terene	119,998		119,998		0	119,998	0	119,998
Pyje,Kullota Plantacione	277,000		277,000		0	277,000	0	277,000
Ndertime e Konstruksione	487,893,848	133,187,671	354,706,177		17,735,308	487,893,848	150,922,979	336,970,869
Rruge,rrjete,vepra ujore	853,789,360	389,255,153	464,534,207	1,959,152	23,226,710	855,748,512	412,481,863	443,266,649
Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	12,725,874	7,200,097	5,525,777	2,110,814	1,105,155	14,836,688	8,305,252	6,531,436
Mjete transporti	9,774,350	7,347,217	2,427,133	11,961,540	485,426	21,735,890	7,832,643	13,903,247
Rezerva shtetore			0		0	0	0	0
Kafshe pune e prodhimi			0		0	0	0	0
Inventar ekonomik	56,952,552	26,191,889	30,760,663	1,295,280	6,152,132	58,247,832	32,344,021	25,903,811
Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			0			0	0	0
Caktime			0			0	0	0
T otali (I + II)	1,425,022,755	563,182,027	861,840,728	17,748,486	48,704,731	1,442,771,241	611,886,758	830,884,483

Nga Dega e Thesarit Tepelenë nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një databasë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Memaliaj, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre.

Konkluzion: Për vitin 2021 dhe 2022 nga auditimi i procedurës së evidentimit dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore, por njësisia nuk dispononte një *regjistër analitik aktivesh sipas formatit*, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Memaliaj

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Memaliaj dhe Njësite Administrative.

Për vitin 2022 Titullari ka nxjerrë urdhrin me nr. 111, datw 28.10.2022 “Per inventarizimin e aktiveve të Bashkisë Memaliaj për vitin 2022” si dhe urdhrat për kryerjen e inventarizimit për Njësitë Administrative si dhe drejtoritë e zyrtarë përkatëse. Këto komisione janë të përbërë nga 5 anëtarë, të cilët kanë kryer inventarizimin e Aparatit të Bashkisë, Qendrës, Kulturorë, 4 shkolla të mesme, 5 shkolla 9-vjecare. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive

si për Bashkinë Memaliaj dhe për Njësitë Administrative. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material (Drejtuesit e institucioneve, magazinieri dhe punonjësit) brenda muajit dhjetor 2022. Për inventarin ekonomik dhe të imët të marrë në përdorim janë hapur kartelat personale për punonjësit përgjegjës material. Gjithashtu është bërë inventari i magazinës. Sipas fletëve të inventarit rezulton se nuk janë konstatuar diferenca ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabël për çdo artikull. Në asnjë rast të inventarëve të institucioneve apo të Aparatit nga komisioni i inventarizimit nuk janë mbajtur procesverbale apo raporte përmbledhëse për zhvillimin e procedurës dhe rezultatin e inventarizimit. Kështu nuk është evidentuar data e mbarimit të inventarizimit, por nga verifikimi i fletëve të inventarit rezulton se vlerat e aktiveve për llog.218 “Inventar ekonomik”, llog.31 “materiale”, llog.2015 “mjete transporti” shumat rakordojnë me vlerat e pasqyruara në bilancin e vitit 2022 në llogaritë përkatëse.

Pra mos dokumentimi i procedurës nëpërmjet procesverbaleve përkatëse dhe i rezultatit të inventarizimit në përmjet hartimit të raportit të inventarizimit nga Komisioni Inventarizimit është në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 85 ku citohet se: *Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për :*

a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njesise publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procedurën përkatëse, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..

b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

Testi substancial i amortizimit

Qëllimi: Ripërformimi i amortizimit duke u bazuar në udhëzimin nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të ripërformuar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet.

Nga verifikimi i përllogaritjeve të amortizimit të AAGJ, rezulton se amortizimi është llogaritur për grup aktivesh në total dhe jo aktiv për aktiv, duke mos përllogaritur saktësisht amortizimin, pasi aktive të ndryshme kanë vlerë të ndryshme amortizimi të akumuluar sepse kanë kohë (vite) të ndryshme përdorimi. Në mungesë të regjistratit të aktiveve me të dhënat si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur për çdo aktiv u bë e pamundur sondazhi i përllogaritjes së amortizimit për aktive të veçanta në llogari të ndryshme si dhe përllogaritja e saktë e amortizimit të aktiveve për të bërë diferencën.

Referuar Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit. Nga testimet e kryera mbi përqindjet e aplikuara të normës së amortizimit mbi totalin e vlerave të mbetura sipas llogarive të klasës 21, rezulton se janë respektuar normat ligjore të amortizimit të përcaktuara në UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36.

-Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 dhe 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Në lekë

65	B	PASIVET (DETYRIMET)	82,205,984	71,505,049
66		I.Pasivet Afat shkurtra	82,205,984	71,505,049
67		1. Llogari te Pagushme	82,205,984	71,505,049
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	38,220,128	34,655,100
69	42	Detyrime ndaj personelit	6,355,499	5,687,897
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	405,459	357,911
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	2,173,028	1,948,015
76	436	Sigurime Shendetsores		
77	437,438,	Organizma te tjere shtetore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	972,000	1,449,510
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	7,159,788	7,382,788
82	467	Kreditore te ndryshem	25,633,819	17,395,686
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	1,286,263	2,628,142
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provizjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	898,892,985	912,076,112
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR:	898,892,985	912,076,112
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	860,521,673	869,666,652
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	38,371,312	42,409,460
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	981,098,969	983,581,161

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore është në total 82,205,984 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet e pasaktë si në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, vlera këto që i përkasin debitorëve në aktiv të bilancit, duke u pozicionuar gabim në pasiv. Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në fakt si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 0, duke mos u evidentuar faturat e palikujduara që u përkasin dhjetorit të vitit ushtrimor.

- Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në vlerën 6,355,499 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2021 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit pasardhës 2022.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në vlerën kontabël 405,459 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit pasardhës 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në vlerën 2,173,028 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 464 “Detyrimet për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,449,510 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 972,000 lekë, të cilat rakordojnë me gjendjen e llogarisë kundërpartit në aktiv të bilancit 532 “Vlera të tjera”.

Konkluzion: **Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,628,142 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,286,263 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët janë në mbyllje të vitit 2021 janë në vlerën 34,655,100 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 janë në vlerën 38,220,128 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 3.3.

Titulli gjetjes 24: Mbi kontabilizimet në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”

Situata: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,628,142 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët janë në mbyllje të vitit 2020 janë në vlerën 39,386,128 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 janë në vlerën 34,655,100 lekë.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3⁹

Ndikimi: Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i detyrimeve ndaj shtetit.

Shkaku: Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave ka bërë kontabilizim të gabuar të detyrimeve ndaj shtetit.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, të cilat nuk janë paraqitur në llogaritë e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

⁹Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 7,382,788 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 7,159,788 lekë. Për këtë gjendje ka analizë dhe raportim në degën e Thesarit Tepelene, duke bërë akt-rakordim analitik, sipas investimeve të kryera.

- Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emri i furnitorit	Përshkrim i veprimt	Debiti	Fatura Krediti	Shuma	Shtesat	Shuma	Urdher Shpenzim	Debiti	Tep. kreditore
a	b	c	d	Nr. / Date	Shuma	Viti 2022	Viti 2022	Nr. date	Debiti	Diferenca
			Artik.							
1	Posta	Sherbim Postare	602		180,819	116,250	297,069		122,530	174,539
2	Ujesjelles Sha	Uje	602		0	904,920	904,920		777,816	127,104
3	OsheeTePrapambe t	Energji	602		11,680,573	876,062	12,556,635		4,185,552	8,371,083
4	Oshee	Energji	602		432,498	2,212,181	2,644,679		2,544,003	100,676
5	A.	Sherbim Interneti	602		0	117,000	117,000		108,000	9,000
6	P. B.	Bonus Karburanti	602		180,000		180,000		0	180,000
7	C.G.Sh.P.K	Studim Projektim	230		5,340		5,340			5,340
8	"G." Shpk	Vendim Gjyqesor	602		150,407		150,407			150,407
9	Sh.K. Shp.K	Sherbimi Pastrimit T	602		2,557,206		2,557,206		1,321,092	1,236,114
10	Sh.K. Shp.K	Sherbimi Pastrimit	602		352,876	5,091,345	5,444,221		5,044,593	399,628
11	P.C.	Studim Projektim	230		27,360		27,360			27,360
12	P.C.	Studim Projektim	230		14,400		14,400			14,400
13	P.C.	Studim Projektim	230		27,600		27,600			27,600
14	M. Studio	Studim Projektim	230		12,000		12,000			12,000
15	Kendet Sportive	Kolaudim	230		6,000		6,000			6,000
16	B. Shpk	V Gjyqesore	602	672dt10.11.16	31,828		31,828			31,828
17	S.Rr.	Blerje Soba Druri	231	f 388dat 30.12.21	178,800	0	178,800		178800	0
18	K. Shpk	Blerje Nafte	602	24.06.20 21	1,557,976	0	1,557,976		1557976	0
19	M.R.	V Gjyqesore	602		0	965,800	965,800	40dt/7.02.22	965,800	0
20	A. – K.	Blerje Kondicioner	231	76dt08.2.22	0	780,480	780,480	48dt14.02.22	780,480	0
21	H. 2012	Blerje Flamuj	602	85/22dt 15.09.22	0	204,000	204,000	366dt25.10.22	204,000	0
22	P. A.	Blerje Ushqimi	602	115/22dt 12.07.22	0	421,953	421,953	444dt12.12.22	421,953	0
23	O. H.	Blerje Materiale	602	85/22dt2 2.09.22	0	116,400	116,400	367dt25.10.22	116,400	0
24	S. M.	Blerje Kompjuterat	231	44/22dt1 3.07.22	0	216,000	216,000	361dt25.10.22	216,000	0
25	A. E<Z	BlerjeMaterialeSport	602	7/22dt26.04.22	0	117,600	117,600	177dt20.05.22	117,600	0
26	F.M.	Fur, Ven, Kamera	231	148/22dt 9.11.22	0	177,600	177,600	452dt19.12.22	177600	0
27	F. M.	Blerje Kompjuterat	231	56/22 dt 09.05.22		648,000	648,000	194dt08.06.22	648,000	0
28	H. 2012	Blerje Detergjent	602	43/22dt2 7.4.22	0	246,000	246,000	178dt20.05.22	246000	0
29	I.O.	Blerje Kancelari	602	5539dt27 .04.22	0	716,346	716,346	182dt27.05.22	716346	0
30	K. Shpk	Nafte	602	596/22 dt 31.10.22		463,600	463,600	0	0	463,600
31	K. Shpk	Nafte	602	724/22dt 31.12.22		156,815	156,815	0	0	156,815
32	B. A.	Sherbime Makine	602	103/22 dt 23.09.22		465000	465,000	369dt25.10.22	465000	0
33	O. C.	Blerje Derrasa/Vida	602	10DT29.06.2022		323,205	323,205	253 dt 21.07.22	323,205	0
34	B. A.	Sherbime Makine	602	58/22 dt 12.07.22		214,200	214,200	325 dt 25.09.22	214200	0

35	P. Sh.P.K	BlerjeOpingash Labe	602	427dt13.12.22		46,600	46,600	453 dt 19.12.22	46,600	0
36	I.	Vendosje Kamera	231	69 dt 03.10.2022		1,069,215	1,069,215	391dt16.11.2022	1,069,215	
37	S. Xh.	BlerjeDyerTeBlindu	602	607dt18.11.2022		155,988	155,988	451dt14.12.22	155,988	0
38	V. K.	Ndert. Ures Xhaxhaj	231	144/d 30.11.2022		1,959,151	1,959,151	468dt22.12.2022	1959151	0
39	T.	Blerje Ekskavator	215	10002004dt30.11.22		11,961,540	11,961,540	479dt 22.12.2022	11,961,540	0
40	E. 2000	Izolim Tarrace	231	163/22dt 28.12.22		3,082,200	3,082,200	488dt29.12.22	3,082,200	0
41	M. D	Blerje Sobash	218	63/22dt 22.12.22		336,000	336,000	489dt29.12.22	336,000	0
42	C. Sh.	Blerje Grilash	602	22/22 dt 27.12.22		85,000	85,000	491dt29.12.22	85000	0
43	A.G.	NdertimiUjesjellsit	231	07dt31.10.2022		14,135,322	14,135,322	0	0	14,135,322
44	Akep	Mirmbajtje Sistemi	602	1753/2dt 20.12.2022		5,000	5,000	0	0	5,000
SHUMA						17,395,686	48,386,773	65,782,459	40,148,640	25,633,819

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 17,395,686 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 25,633,819 lekë me një diferencë në rritje prej 8,238,133 lekë, e cila detyrime për pagesat pjesore të kryera në vitin 2022 nga Bashkia Memaliaj për këto detyrime.

Në analizë: Formati nr. 2 “Pasqyra e përfomancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin ushtrimor 2022 dhe vitin paraardhës, sipas zërave më poshtë:

Nr. Llogarije	Përshkrimi i Operacioneve	Viti Ushtrimor 2022	Viti I Meparshem 2021
b	c	1	2
A	TE ARDHURAT	348,015,313	338,511,645
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	8,077,768	7,192,007
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	112,226	178,940
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	112,226	178,940
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
702	2.Tatimi mbi Pasurine	3,374,418	2,845,488
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	3,374,418	2,845,488
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	4,591,124	4,167,579
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	4,591,124	4,167,579
705	5.Takse e rruges		
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
709	7.Gjoba e Kamat vonesa		
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	5,627,360	2,855,345
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	2,621,128	2,101,890
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	2,621,128	2,101,890
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	3,006,232	743,455
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		573,248
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	3,006,232	64,460
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		85,110
7114	Te ardhura nga biletat		

7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		20,637
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		10,000
72	V.GRANTE KORENTE	334,310,185	328,464,293
720	1.Grant korent I Brendshem	334,310,185	328,464,293
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	316,915,874	310,084,464
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	7,554,866	7,280,264
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshe nga buxheti		10,621,965
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	9,839,445	477,600
7209	Te tjera grante korente te brendshme		
721	2.Grant korent I Huaj	0	0
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
B	SHPENZIMET	309,644,001	296,102,185
600	1.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	87,218,472	87,912,101
6001	Paga, personel I perhershem	87,218,472	87,912,101
6002	Paga personel I Perkohshem		
6003	Shperblime		
6009	Shpenzime te tjera per personelin		
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	14,159,774	13,834,385
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	14,159,774	13,834,385
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	31,617,061	30,882,370
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,438,734	1,248,198
6021	Materiale dhe sherbime speciale	553,553	1,107,480
6022	Sherbime nga te trete	14,435,841	15,514,757
6023	Shpenzime transporti	5,780,970	4,380,961
6024	Shpenzime udhetimi	1,045,800	1,094,000
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	323,205	756,000
6026	Shpenzime per qeramarrje		
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	1,268,300	1,208,750
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
6029	Shpenzime te tjera operative	6,770,658	5,572,224
603	IV.SUBVECIONE	0	0
6030	Subvecone per diference cmimi		
6031	Subvecone per te nxitur punesimin		
6032	Subvecone per te mbuluar humbjet		
6033	Subvecone per sipermarrjet individuale		
6039	Subvecone te tjera		
	V.TRANSFERIME KORENTE	198,459,960	165,250,887
604	1.Transferime korente te brendshme	6,888,395	8,921,110
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	6,888,395	8,921,110
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
605	2.Transferime korente me jashte	0	0
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	191,571,565	156,329,777
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	191,571,565	156,329,777
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	0	0
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	0	0
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		

662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-21,811,266	-1,777,558
	IX.SHPENZIME TE TJERA	0	
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUHES (Rezultati i Veprimtarise se vitit/Ushtimor)	38,371,312	42,409,460

Analiza e llogarive të të ardhurave në bilancin 2022 në total 348,015,313 lekë si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Tepelenë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 8,077,768 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 112,226 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 3,374,418 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 4,591,124 lekë e cila përfshin taksën e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësirës publike, qiratë për truallin.etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 5,627,360 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 2,621,128 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 3,006,232 lekë, e cila përfshin tarifën e parkimit, kamatëvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë **7200 “Të ardhurat nga Buxheti per NJQP (Qendrore)”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 316,915,874 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit, dhe përfaqëson grantin e akorduar nga pushteti qendror për Bashkinë Memaliaj.

- Gjendja e llogarisë **7204 “Të ardhura nga Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën **7,554,866** lekë, i cila përfaqëson të ardhurat nga taksat dhe tarifën vendore për vitin 2022 si dhe kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 1,286,263 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk psqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 47,154,114 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e

klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3** “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën-pika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; - Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”.

Pra gjendja e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, duhet të përfshijë vlerën e detyrimeve të dhjetorit të palikujduar për shpenzime personeli për paga (600), për kontribute sig. shoqërore e shëndetësore e tatimore, vlerën e faturave të palikujduara për llog.602 “mallra e shërbime”.

Titulli gjetjes 25: Mbi kontabilizimet në llogarinë e fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Situata: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 1,286,263 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk psqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 47,154,114 lekë.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3.

Ndikimi: Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i detyrimeve ndaj shtetit.

Shkaku: Sektori i Financës dhe Taksave Vendore ka bërë kontabilizim të gabuar të detyrimeve ndaj shtetit.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Analiza e shpenzimeve të bilancit në vitin 2022 në vlerën 309,644,001 lekë:

- Gjendja e llogarisë 600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli” për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 87,218,472 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 601 “Kontribute për sigurime” për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 14,159,774 lekë, e cila nuk rakordon me akt-rakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 31,617,061 lekë, e cila nuk rakordon me akt-rakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korrente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 6,888,395 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 191,571,565 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Per vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 348,015,313 lekë dhe totali shpenzimeve është 309,644,00 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 38,371,312 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është e barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën -21,811,266 lekë.

Nga testi kontrollit për vitin 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkën nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitet e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit. Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat “a”, “b” dhe “c” të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën dhe administrimi i karburantit.

Veprimet nëpërmjet magazinës

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. Gj. G., Kryetar i Bashkisë Memaliaj, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. P. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare.

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e konstatuara më sipër, mbi vlerësimin e raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022 për paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi trajtuar më hollësisht në akt-konstatim ngarkohen me përgjegjësi:

z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, z. P. H., ish Përgjegjës i Sektorit të Financës të Bashkisë Memaliaj.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Drejtoria e Shërbimit Memaliaj është krijuar me VKB nr. 72 datë 02.12.2019 “Për miratimin e aktit të themelimit të ndërmarrjes së shërbimeve të shkollave, rrugëve rurale, gjelbërimit, ndriçimit dhe varreza publike”. Si dhe në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj nr. 116, datë 13.11.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike në bashkinë Memaliaj”.

Realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB nr. 61, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021” me VKB nr. 54, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2022”

Për vitin 2021: Drejtoria e Shërbimit, Bashkia Memaliaj ka zhvilluar gjithsej:

-“Kërkesë për propozim”, 2 procedura, me fondin limit në total prej 8,520,000 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 8,087,604 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 432,396 lekë pa Tvsh.

-“Tender i Hapur”, 1 procedura, me fondin limit në total prej 19,166,000 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 9,990,400 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 9,175,600 lekë pa tvsh ose në masën 47.88 % të fondit limit.

-“Tender i Hapur i thjeshtuar”, 6 procedura, me fondin limit në total prej 17,906,000 lekë pa tvsh, kontrata të lidhura në total prej 13,645,350 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 4,260,650 lekë pa Tvsh.

-“Blerje me vlerë të vogël”, 12 procedura, me fondin limit në total prej 3,666,000 lekë pa tvsh, kontrata të lidhura në total prej 1,893,498 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 1,772,502 lekë pa tvsh;

Për aktivitetin e vitit 2021, nga vlera e kontratave prej 27,418,133 lekë me Tvsh është likuiduar gjatë vitit ushtrimorë vlera prej 27,418,133 mijë lekë ose 100 % e vlerë së kontratave, duke mos lënë detyrime për vitin 2022.

1	Objekt i prokuruar	Operatori fitues	Kontrata nr. datë	Vlera Fituese pa Tvsh
	Viti 2021			
1	Blerje makine foristrada me karroceri	T. A.	Nr. 85/14 date 03/12/2021	1,295,000
2	Blerje Makine Veteshkarkuese, për nevojat e Drejtorise se Sherbimit Memaliaj	S. & C. C.	2/9/2022	3,462,000
3	Blerje Materiale ndërtimi	V. K.	1/11/2022	3,775,560
4	Blerje paisje dhe vegla pune	B. C.		348,000
5	Blerje peme dekorative	Gj.	12/20/2021	949,500
6	Furnizim me karburant Gazoil (10 ppm ULSD), per nevojat e Drejtoris se Sherbimit per vitin 2021	"G -C. G.	2/26/2021	10
7	Mirembajtje e rrugeve te njesive administrative	Sh. 7	3/30/2021	1,888,875
8	Ndertim grope skeptike	K-A.		186,550
9	Permiresim i rrugeve	A.	11/11/2021	2,294,250
10	Rikonstruksioni segmentit Rrugor "Bylysh-Vagalat-Maricaj-Arrez e Madhe-Lamaj-Qafa e Kicokut"	C. R. 8	19/05/2021	9,990,400
11	Rrethimi i shkollave	V. K.	12/17/2021	1,869,040

Për vitin 2022: Drejtoria e Shërbimeve ka zhvilluar gjithsej 16 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 40,899,000 lekë pa Tvsh, vlerë të kontratës 28,725,043 lekë pa Tvsh, diferencë midis tyre prej 12,173,957 lekë me Tvsh.

-“E hapur e thjeshtuar”, 2 procedura, me fondin limit në total prej 14,600,000 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 12,034,149 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 2,565,851 lekë pa Tvsh.

- “Tender i Hapur”, 1 procedura, me fondin limit në total prej 20,833,000 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej 11,918,400 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 8,914,600 lekë pa Tvsh ose në masën 42.8% të fondit limit.

-“Blerje me vlerë të vogël”, 13 procedura, me fondin limit në total prej 5,466,000 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 4,772,494 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 693,566 lekë pa Tvsh;

Për aktivitetin e vitit 2022, nga vlera e kontratave prej 34,470,052 lekë me Tvsh është likuiduar gjatë vitit ushtrimor vlera prej 31,735,618 mijë lekë ose 92 % e vlerës së kontratave, duke lënë pa likuiduar vlerën 2,734,434 lekë ose 8 %, vlerë e cila është likuiduar në periudhat e mëvonshme dhe deri me 28.02.2023. Nga grupi i auditimit u audituan procedurat e prokurimit si vijon:

1- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, Bashkia Memaliaj, viti 2021.

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, AnëVjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, viti 2021.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 04, datë. 12.01.2021	3. Hartuesit e DT nr. 31/1, datë 08.02.2021 1. D. B. - Përgjegjës (Jurist) 2. Sh. D. (Anëtar) 3. L. H. (Anëtar)	4.KVO Urdhër nr. 31, date 08.02.2021 E. H. (Kryetar) F. H. (Anëtar) B. Y. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës “E Hapur”		
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 410,176,390 REF-86357-02-09-2021	6. Oferta fituese (pa Tvsh): BOE “K.” & “E. K.” me ofertë ekonomike 410,174,927	7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh) 1,463 lekë ose 0.0004 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë, 12.03.2021	9. Burim i Financimit Buxhet i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1. b) Skualifikuar 0 c) Kualifikuar 1.
11. Ankimime nga nuk ka	12. PërgjigjeAnkesësnga AK nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP; nuk ka

Bashkia Memaliaj ka planifikuar këtë projekt për financim nga buxheti shtetit për likuidim në vitet 2021÷2024. Për vitin 2021 në vlerën **97,476,069** lekë me Tvsh, për vitin 2022 në vlerën

20,000,000 lekë me Tvsh për vitin 2023 në vlerën **20,000,000** lekë me Tvsh, ndërsa vlera e mbetur do të likuidohet në vitin 2024; referuar shkresës nr. 3167 dhe nr. 3167/1, datë 14.12.2020 të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) dhe shkresës nr. 414 datë 27.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike.

Kërkesa e për detyrën e projektimit

Me nr. 658/1 prot., datë 21.09.2020, (nr. 43/1 prot., dhuruesi) është formuluar nënshkruar “Kontratë dhurimi”, ndërmjet OE “A. G. ” Shpk, përfaqësuar nga administratori z. A. Sh. dhe Kryetarit të Bashkisë Memaliaj z. Gj. G. ku OE shpreh dëshirën të kryejë një studim-projektim (me kostot e saj), sipas kushteve teknike të projektimit si dhe kërkesave specifike të përcaktuara nga bashkia dhe ta dhurojë.

Në dosje e prokurimit gjendet procesverbali nr. 1635 prot., datë 29.09.2022, mbi arkivimin fizik të dokumentave teknike të tenderit, dorëzuar nga znj. V. K. (Përgjegjëse e Sektorit të Urbanistikës), marrë në dorëzim nga znj. M. M. (Specialiste Arkive & Protokolli).

Titullari i AK i është drejtuar AKUM me kërkesën 1067 prot., datë 11.12.2020, për financimin e plotë të projektit: “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, si dhe bashkimin në këtë financim të fondit të parashikuar dhe alokuar për furnizimin pjesërisht me ujë të fshatit Iliras.

Me shkresën nr. 3167 prot., datë 14.12.2020 është dërguar miratimi i objektit për programin e furnizimit me ujë dhe kanalizime “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, sipas Vendimit të Këshillit Teknik të AKUM nr. 57, datë 26.11.2020, me vlerë të plotë 487,380,344 lekë me Tvsh.

Me urdhërin nr. 125, datë 15.12.2020 “Për ngritjen e grupit të punës të marrjes në dorëzim të plotësimin të projektit” i përbërë nga: E. H. (Kryetare –Nënkryetare, Përgjegjëse Investimesh); V. K.; B. H. ; K. R. e P. H..

Bashkangjitur procesverbali me nr. 1975/2 prot., datë 15.12.2020, i marrjes në dorëzim të projektpreventivit.

Hartimi i projektit dhe preventivat:

Detyra e projektimit, miratura nga Titullari i AK me nr. 65 prot., datë 21.05.2020, është realizuar nga znj. V. K., z. K. R. e z. P. H. H.

Titulli i gjetjes 26: Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, në mungesë të oponencës teknike si dhe në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Situata: Kërkesa për kryerjen e oponencës teknike me nr. 1988 prot., datë 15.12.2020 të Bashkisë Memaliaj dhe me nr. 2892 prot., datë 15.12.2020 të Institutit të Ndërtimit.

Marrëveshja midis Bashkisë Memaliaj me nr. 2899/1 prot., datë 16.12.2020 dhe Institutit të Ndërtimit ku tarifa e shërbimit për kryerjen e oponencës teknike është 282,338 (*dyqind e tetëdhjetë e dymijë e treqind e tridhjetë e tetë*)lekë me Tvsh.

Procesverbali i marrjes në dorëzim të dokumenteve për kryerjen e oponencës teknike nënshkruar nga përfaqësuesi i Bashkisë Memaliaj dhe specialistja e zyrës së pritjes se IN më datë 16.12.2020

Grupit të oponencës i janë vënë në dispozicion materialet e poshtëshënuara:

- Relacioni teknik
- Raporti hidrogeologjik
- VNM
- Vizatimet teknike

- Specifikimet teknike
- Preventivi i punimeve
- Grafiku i punimeve
- CD e projektit

Dërgimi i oponentëve teknike me nr. 2892/2 prot., datë 24.12.2020 nga grupi i oponentëve i përbërë nga: z. A. J. (Ing. Hidroteknik) znj. M. Sh. (Shefe e Sektorit të Oponencave), znj. V. P. (Ing. Konstruktor –Drejtor Drejtorie), znj. B. Gj. (Ing.Mjedisi) janë konstatuar që:

- Mungojnë analizat e çmimeve;
- Mungon raporti gjeologjiko – inxhinierik;
- Mungon raporti i llogaritjeve konstruktive për depot dhe stacionet e pompave;
- Mungon një plan organizimi duke përfshirë vendndodhja e karriera të materialeve;
- Mungon plani i sigurimit dhe koordinimit në punë;
- Mungojnë specifikimet teknike për puset, elektropompat, transformatorët, panelet e TU, hidrantet, tubat e çelikut, shirit sinjalizimi, matësat e mëdhenj të tipit “Eoltman”, paneli diellor, sistemi “Scada”, etj
- Tek preventive mungon zëri “FV të sistemeve të klorinimit”.

Vlefshmëria ligjore e materialit të dorëzuar është në përgjegjësi të dorëzuesit.

Njëkohësisht oponenti ka konstatuar që nuk janë dhënë specifikimet teknike të:

- Pusët e grumbullimit;
- Matësat e ujit elektromanjetike;
- Sistemet e klorinimit;
- Valvolat e ujit/saracineskat dhe rakorderitë përkatëse tek depot e ujit;
- Hidrantet;
- Gjeneratorë dhe transformatorë dhe panelet e TU;
- Elektropompat;
- Sistemi i furnizimit me panel diellor;
- Sistemi i kontrollit dhe monitorimit “SCADA”;
- Sistemi i tokëzimit dhe i rrufepritësit;

Sa më sipër, oponenti shprehet që: *“specifikimet teknike duhet të plotësohen me specifikimet teknike të dhëna më sipër në mënyrë që këto specifikime të shërbejnë si një bazë për zbatimin e punimeve me cilësi dhe për kontrollin e cilësisë së këtyre materialeve që janë mjaft të rëndësishme për funksionimin e sistemit në të ardhmen”.*

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisi hartuar nga OE “A. G.” Shpk, nuk është në përputhje me ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, pasi raporti duhet të hartohet dhe të firmoset nga persona të certifikuar dhe të licensuar nga Ministria e Mjedisit. OE “A. G.” Shpk, i mungon certifikata e ekspertit dhe licenca për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL)

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur hartimi i Raportit të VNM, përmban VKM dhe ligje të cilat janë shfuqizuar.

Raporti duhet të plotësohet me konstatimet e bëra në këtë oponentë përpara se ai të marrë miratimin nga Ministria e Mjedisit.

Në pikën 8, “Përfundime dhe rekomandime” të Oponentëve Teknike “Mbi projektin e zbatimit të objektit”, Grupi i oponentëve është shprehur:

“Nga studimi dhe analiza e dokumentacionit teknik të vënë në dispozicion oponenti ka arritur në përfundimet dhe rekomandimet si më poshtë:

- **Zgjidhja teknike** e dhënë nga konsulenti për skemat hidraulike të ujësjellësit rajonal të 8 fshatrave dhe qytetin e Memaliaj në bashkinë Memaliaj si dhe prioritetet e përcaktuara në përgjithësi janë të pranueshme dhe të përshtatshme për furnizimin me ujë në sasinë dhe cilësinë e duhur të këtyre fshatrave sipas standarteve teknike të kërkuara dhe kërkesave të detyrës së projektimit.

- **Specifikimet teknike** në përgjithësi japin kërkesat e duhura përzgjedhjen e materialeve kryesore të parashikuara në projekt por ato duhet të plotësohen me specifikimet teknike të materialeve dhe pajisjeve të sugjeruara më sipër për të dhënë mundësinë e zbatimit të punimeve në sasinë dhe cilësinë e duhur në përputhje me kërkesat e standarteve teknike.
- **Vizatimet teknike** japin një pamje grafike relativisht të detajuara në lidhje me punimet që do të kryhen si dhe në objektet kryesore të rrjeteve ku do të punohet. Ato janë përgatitur në përputhje dhe të lidhura ngushtë me kushtet teknike të zbatimit dhe standartet teknike të dhëna në projekt.
- **Preventivi dhe vlerësimi i kostos së punimeve të ndërtimit** në përgjithësi janë bazuar në manualet zyrtare si dhe në çmimet e tregut aktual në zonën e ndërtimit. Grupi i projektit duhet të japë edhe analizat e çmimeve njësi për zërat që nuk janë në manual zyrtarë. Gjithashtu, grupi i projektit duhet të përfshijë FV të sistemeve të klorinimit si dhe FV të matësive të ujit në hyrje të çdo fshati
- **Kërkesat e sigurimit teknik**, të vlerësimit të ndikimit në mjedis, plani i monitorimit të mjedisit si dhe kushtet teknike të zbatimit të punimeve duhet të merren në konsideratë me prioritet gjatë zbatimit të projektit nga zbatuesi i punimeve dhe mbikqyrësi i punimeve. Oponenca rekomandon që investitori duhet të kërkojë nga zbatuesi i punimeve hartimin e planit të sigurisë dhe koordinimit në punë (PSK) në përputhje me VKM nr. 312, datë 05.05.2010. Zbatuesi i punimeve duhet të japë përpara fillimit të punimeve vendndodhjen e karrieraeve të marrjes së materialeve të ndërtimit të shoqëruar edhe me lejet përkatëse për shfrytëzimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.
- **Përsa më sipër**, oponenca ka arritur në konkluzionin se zgjidhjet teknike të dhëna nga konsulenti për ndërtimin e Ujësjellësit rajonal për 8 fshatrat si dhe qytetin e Memaliajt në përgjithësi janë zgjidhje të pranueshme dhe të zbatueshme në përputhje me kërkesat teknike dhe standartet përkatëse për furnizimin me ujë të zonave urbane dhe rurale si dhe me kërkesat e detyrës së projektimit.
- **Oponenca rekomandon** që zbatimi i këtij projekti duhet të kryhet pas plotësimit të projektit të zbatimit sipas sugjerimeve të mësipërme ku të përfshihet plotësimi i specifikimeve teknike të materialeve dhe pajisjeve të rekomanduara më sipër, informacioni në lidhje me karrierat e marrjes së materialeve inerte si dhe venddepozitimet për mbetjet e ngurta, Analizat e çmimeve për zërat njësi që nuk janë manualet zyrtare, si dhe një plan i organizimit të tyre sipas rekomandimeve të dhëna më sipër.

Në zbatim të ligjit ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” neni 3, ky projekt kërkon “Vlerësim paraprak të ndikimit në mjedis” sipas shtojcës II pika 10/ gërma “i” “Veprat për transferimin e burimeve ujore midis baseneve lumore, që nuk janë përfshirë në shtojcën I”

Burimi i ujit të Gallaticës ka një prurje minimale 45 l/sek, dhe një prurje mesatare prej 120 l/sek. (sipas oponencës fillestare afërsisht 1.4 milion m³/vit deri më 3.8 milion m³/vit.), ka një prurje më të vogël se 20 milion m³ në vit, që detyronte studim të thelluar

Përpilimi i këtij raporti VNM është bërë në përputhje me ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, në nenin 8 të këtij ligji përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas shtojcës II i nënshtrohen procedurës paraprake të VNM. Për përgatitjen e këtij raporti Ekspeti i Mjedisit është bazuar në VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” i ndryshuar. Më poshtë po përmendim legjislacioni kryesor shqiptar për hartimin dhe klasifikimin e raportit të VNM-së:

Raporti VNM i paraqitur nga OE, (i pa plotësuar sipas rekomandimeve të oponencës) nuk është në përputhje me: ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në

mjedis” dhe VKM 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Referuar VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

3. Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike. Oponenca teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Realizimi i procedurës së prokurimit me vlerësimin e ndikimit në mjedis të realizuar në kundërshtim me ligjin dhe oponencë teknike të pa plotësuar sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi: Realizimi i projektit të ndërtimit, nuk miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike. Oponenca teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit.

Rekomandimi: AK në hartimin/miratimin e dokumentacionit teknik të projektit, duhet të formulojë detyrimisht Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Oponencën Teknike; përpar se të fillojë procedurën e prokurimit.

Konkluzion: Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, në mungesë të oponencës teknike si dhe në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Përkatesisht Raporti i Vlerësimit në Mjedis është hartuar nga OE “A. G.” Shpk në mungesë të certifikatës së ekspertit dhe licencës për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB (ose ish QKL). Gjithashtu, OE “A. G.” Shpk është edhe hartues i projektit të ndërtimit të ujësjellësit.

Nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Memaliaj, nuk duhej të zhvillohej procedura e prokurimit publik, referuar neneve 6, 9 e 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ligji nr. 10431 datë 10.03.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, **ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009** “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 686. datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe Urdhrin e Ministrit nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në kryerjen e oponencës teknike të projektit të zbatimit, ngarkohet me përgjegjësi z. Gj. G., Kryetari i Bashkisë.

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

1.1. Me urdhërin nr. 4, e nr. 49 prot., datë 12.01.2021, është ngritur Njësina e Prokurimit e përbërë nga z. A. V., z. E. L. dhe znj. V. K..

Me shkresën nr. 52, datë 12.01.2021, “Refuzim marrje urdhëri”, Znj. V. K., ka refuzuar të marrë pjesë në NJHDT, për arsye që lidhen me njohuritë për të hartuar specifikimet teknike dhe për arsye shëndetësore.

1.2. Me urdhërin nr. 6, e nr. 49/1 prot., datë 13.01.2021, z. K. R. ka zvendësuar znj. V. K. në Njësinë e Prokurimit (përlllogaritjen e fondit limit; hartimin e kriterëve të veçanta dhe të përgjithshme të kualifikimit në DT dhe përcaktimin e çdo informacioni tjetër specific të nevojshëm për objektin e prokurimit).

Me shkresën nr. 71, datë 14.01.2021, “Refuzim marrje urdhëri”, Z. K. R. (inxhinier ndërti), ka refuzuar të marrë pjesë në NJP, për arsye që lidhen me mungesën e eksperiencës dhe përvoja.

1.3. Me urdhërin nr. 8, e nr. 49/2 prot., datë 15.01.2021, z. A. T. ka zvendësuar z. K. R., në Njësinë e Prokurimit.

Me nr. 49/3 prot., datë 18.01.2021 është lidhur kontratë porosie e titullarit të AK me Inxhinierin Hidroteknik, z. L. H. si ekspert për marrjen pjesë në NJP (vlera e kontratë 35,000 lekë).

1.4. Me urdhërin nr. 15, e nr. 49/4 prot., datë 19.01.2021, z. L. H. ka zvendësuar z. A. T. , në Njësinë e Prokurimit.

Me shkresën nr. 105, datë 19.01.2021, “Refuzim urdhëri”, Z. E. L., ka refuzuar të marrë pjesë në NJP, për arsye se nuk ka eksperiencë për prokurimin që zhvillohet në bashki.

1.5. Me urdhërin nr. 16, e nr. 49/5 prot., datë 19.01.2021, z. A. Xh. , ka zvendësuar z. E. L., në Njësinë e Prokurimit.

Me shkresën nr. 120, datë 21.01.2021, “Kërkesë”, Z. A. Xh. , ka refuzuar të marrë pjesë në NJP, për arsye se është shumë i ngarkuar me punë si në zbatimin e buxhetit, në procedurat e prokurimit që duhet të ndjek në SPE në Drejtorinë e Shërbimit (Kryetar KVO dhe në procedurat “Blerje të vogla”)

1.6. Me urdhërin nr. 17, e nr. 49/6 prot., datë 21.01.2021, znj. E. S. , ka zvendësuar z. A. Xh. , në Njësinë e Prokurimit.

Me shkresën nr. 128, datë 21.01.2021, “Kërkesë”, znj. E. S. , ka refuzuar të marrë pjesë në NJP, për arsye se është shumë i ngarkuar me punë si specialist e buxhetit e nuk ka eksperiencë në realizimin e prokurimeve publike.

1.7. Me urdhërin nr. 20, e nr. 49/7 prot., datë 22.01.2021, znj. J. C. , ka zvendësuar znj. E. S. , në Njësinë e Prokurimit.

Me shkresën nr. 144, datë 22.01.2021, “Refuzim Urdhëri”, znj. J. C. , ka refuzuar të marrë pjesë në NJP, për arsye se nuk ka kapacitetet e nevojshme për të mbuluar këtë funksion.

1.8. Me urdhërin nr. 21, e nr. 49/8 prot., datë 22.01.2021, znj. E. J. , ka zvendësuar znj. J. C. , në Njësinë e Prokurimit.

Me shkresën nr. 145, datë 22.01.2021, “Refuzim Urdhëri”, znj. E. J. , ka refuzuar të marrë pjesë në NJP, për arsye se nuk ka eksperiencë dhe ka ngarkesë pune në pozicionin e punës: Magaziniere/Arshiviste & Protokolluese në Ndërmarrjen e Shërbimit.

1.9. Me urdhërin nr. 22, e nr. 49/9 prot., datë 22.01.2021, z. A. G., ka zvendësuar znj. E. J. , në Njësinë e Prokurimit.

Me shkresën nr. 150, datë 22.01.2021, “Refuzim Urdhëri”, z. A. G., ka refuzuar të marrë pjesë në NJP, për arsye se nuk ka eksperiencë teknike dhe profesionale në këtë fushë dhe për arsye shëndetësore shpreh pamundësinë e kryerjes së kësaj detyre.

1.10. Me urdhërin nr. 23, e nr. 49/10 prot., datë 26.01.2021, z. P. H., ka zvendësuar z. A. G., në Njësinë e Prokurimit.

Me shkresën nr. 158, datë 27.01.2021, “Refuzim Urdhëri”, z. P. H. (Përgjegjës i Zyrës së Financave dhe Tatimeve), jep dorëheqjen si anëtar i NJP.

1.11. Me urdhërin nr. 24, e nr. 49/11 prot., datë 28.01.2021, z. Sh. D. a, ka zvendësuar z. P. H., në Njësinë e Prokurimit.

Në dosje gjendet Vendimi nr. 6 e nr. 121/2 prot., datë 04.02.2021 “Për lirimin nga detyra të z. A. V. ” me motivacion dorëheqje me dëshirë, formuluar nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, miratuar nga Titullari.

Me nr. 215 prot., datë 05.02.2021, është lidhur Kontrata e Punës Individuale me Kohë të Pjesshme, midis Bashkisë Memaliaj, përfaqësuar nga Titullari i AK z. Gj. G. në cilësinë e punëdhënësit dhe z. D. D. - Jurist (me pagë 35,000 lekë në përfundimin e procedurës).

1.12. Me urdhërin nr. 29, e nr. 49/12 prot., datë 05.02.2021, z. D. B. , ka zvendësuar z. A. V. , Përgjegjës në Njësinë e Prokurimit.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DATË

Titulli i gjetjes 27: Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit për ndërtimin e ujësjellësit, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.

Situata: Kriterë që nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 46 Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cënuar kështu edhe përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

1. Në pikën 2 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar. Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 B
- **NP-4 A**
- NP-7 F
- **NP-9 A**
- NP-11 B
- **NP-12 A**
- **NS-4 A**
- NS-8 A
- NS-13 A
- **NS-14 A**
- **NS-18 A**
- NP-4 A **Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.**
- NP-9 A **Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.**
- NP-12 A - **Punime të inxhinierisë së mjedisit.**
- NS-4 A - **Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.**
- NS-8 A - **Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.**
- NS-18 A - **Punime topogjeodezike**

Kërkesa për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahen përcaktimeve të pikës 1, të nenit 46, të LPP dhe pikës 5, të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Në lidhje me këtë kriter, referuar punimeve të përfshira në projekt preventiv, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive e kërkuara referuar VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2. Në pikën 3 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt me eksperiencë minimumi 10 (dhjetë) vjeçare të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Librezë pune (përkatëse).*
- *CV (përkatëse).*
- *Kontratë pune e vlefshme (përkatëse).*

· *Diplomë (përkatëse).*”

Kërkesa e sipërcituar nuk është në përputhje me pikën 1 (gërmat “a” e “b” KREU IV të VKM nr .42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

3. Në pikën 4 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “*Një punësim mesatar i të paktën 82 personave, për periudhën Janar 2020 ÷ Dhjetor 2020 të vërtetuar me:*

4.1 Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2020 ÷ Dhjetor 2020.

4.2 List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2020 ÷ Dhjetor 2020 sipas formatit E-Sig 025, të konfirmuara nga administrata Tatimore.

4.3 Formularët e deklaramentit të pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat shoqëruar me mandat-pagesat e bankës.”

Kërkesat për fuqinë punëtore (82) i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

4. Në pikën 5 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “*Shoqëria të ketë drejtues teknik minimumi:*

- **1 (një) inxhinier Mekanik.**
- **1 (një) inxhinier Mjedisi.**
- **1 (një) inxhinier Gjeolog.**
- **1 (një) inxhinier elektronik ose telekomuN. cioni.**

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatoët ekonomikë duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës dhe CV përkatëse, librezat e punës si dhe të rezultojnë në listpagesa për periudhën Janar 2020- Dhjetor 2020. ”

Referuar punimet konkrete të parashikuara në preventiv, nuk është parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do të ishte e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar nga AK dhe do të ishte e nevojshme ekspertiza plotësuese e **inxhinierëve: Mjedisi, gjeolog elektronik ose telekomunikacioni.**

AK nuk ka parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do nevojitej ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi rregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kriterëve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar

përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

5. Në pikën 5.4 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B. Në zbatim të: ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta, ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”
Kreu II Neni 9 “Detyrime të krijuesit të mbetjeve”
Neni 12 “Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit”
Neni 24/1
Neni 25 “Lejet mjedisore”

Në zbatim të pikës “a” nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 “Për vlerësimin në mjedis”, me qëllim sigurimin e nje niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Këto ekspertiza janë ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit , relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis.

Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraparakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, diskriminues, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme.

6. Në pikën 5.5 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij punonjës me profesionet si më poshtë:

- a. jo më pak se 2 (dy) teknik ndërtimi
- b. jo më pak se 2 (dy) punonjës elektrikist
- c. jo më pak se 2 (dy) punonjës hidraulik
- d. jo më pak se 1 (një) punonjës saldator
- e. jo më pak se 1 (një) punonjës mekanik
- f. jo më pak se 2 (dy) punonjës bojaxhi
- g. jo më pak se 2 (dy) punonjës hidroizolues
- h. jo më pak se 2 (dy) karpentier
- i. jo më pak se 5 (pesë) punonjës shofera
- j. jo më pak se 1 (një) inxhinier hidroteknik
- k. jo më pak se 1 (një) inxhinier ndërtimi profili transport
- l. jo më pak se 2 (dy) inxhinier ndërtimi”

Për punonjësit e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë: kontratën individuale të punës, kartelat personale të sigurimit teknik të lëshuara nga një organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikues) në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në të gjithë listëpagesat e shoqërisë.

Për punonjësit teknik ndërtimi, inxhinier hidroteknik duhet të paraqitet edhe dokumenti që vërteton kualifikimin (dëftesë dhe/ose diplomë).”

Kërkesat për 23 (njëzetë e tre punonjës të pajisur me kontratën individuale të punës, kartelat personale të sigurimit teknik, nuk është pjesë e kritereve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

7. Në pikën 5.6 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “Për gjithë drejtuesit e makinerive të rënda, sipas Urdhrit nr. 44, datë 04.02.2004 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” Dëshmi të aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme lëshuar nga Ministria linjës, minimumi 2 automakinista, 3 eskavatorist, të shoqëruar me kontratat e punës dhe të figurojnë në list-pagesa.”

Kriteri që 2 (automakinista) manovrator, e 3 (tre) eskavatorist, të shoqëruar me kontratat e punës dhe figurojnë në listëpagesa, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë operatori ekonomik për ekzekutimin e kontratës, kërkojnë të jenë në pronësi ose me qera. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listëpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit.

8. Në pikën 5.7 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatat të vlefshme si më poshtë:

- ISO 9001. (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)
- ISO 14001. (Sistemi i menaxhimit mjedisor)
- OHSAS 18001. (Sistemi i menaxhimit dhe sigurisë në punë)
- ISO 39001. (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor)
- ISO 3834-2. (Sistemi i menaxhimit të cilësisë së saldimit)
- ISO 8000. (Certifikata e përgjegjshmërisë sociale)

Në kërkesën e sipërcituar nuk është vendosur opsioni “ekuivalente”, gjë që penalizon OE konkurent të mundshëm që mund të jenë të Çertifikuar sipas standarteve, nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë janë të disponojë .

“Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim. Standartit EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura. Standartet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi. Nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldim, në mënyrë që të kërkohej që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kjo certifikatë nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet ta heqin këtë kërkesë.

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mëspërme nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: ...*Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

9. Në pikën 5.9 të Kapaciteti teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(një) mjek ndërmarrjeje, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Mjeku të vërtetohet me paraqitjen e Licencës së vlefshme, Kontratës së punës, librezës së punës dhe diplomës profesionale. ”

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit

mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

Në vendosjen e këtij kriteri nuk është mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 09.02.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, sidhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Vendosja e këtij kriteri, penalizon/kufizon pjesëmarrjen e OE/BOE, që nuk janë të detyruar për marrjen në punë të mjekut të ndërmarrjes referuar VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar (pika 12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.).

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. K., z. A. K., z. F. K. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Ndikimi: Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: AK Bashkia Memaliaj, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që. në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

Konkluzion: Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. AK në hartimin e DT, ka vendosur kriterë që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk janë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar. Këto janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe **ngarkohet me përgjegjësi, NJHDT e përbërë nga z. D. B. , Sh. D. e L. H. .**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat

e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT: OE “A. G.”, z. D. B., z. Sh. D. e z. L. H., si dhe titullari i AK, z. Gj. G., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga z. D. B., Z. Sh. D. e z. L. H. anëtar të Njësisë së Prokurimit, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 428 prot., datë 11.09.2023 (Protokolluar në KLSH me nr. 428 prot., datë 15.09.2023), në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: ““Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, Bashkia Memaliaj, viti 2021.

Pretendimi i subjektit: 1. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 2): “Nga ana jonë sqarohet se: Ky përcaktim i KLSH është i pasaktë pasi: bazuar në dokumentacionin e dosjes Planifikimin për këtë projekte ka bërë Agjencia Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (në vijim AKUM).

Bashkia Memaliaj si Autoritet Kontraktor ka zbatuar shkresën e çeljes së fondit dhe planifikimit nga institucioni i AKUM. Bashkia ka njoftuar në Dokumentet e Tenderit (në vijim DT) planifikimin e pagesave, pra nuk ka qenë autoritetit që planifikoi pagesat. Bashkia Memaliaj si Autoritet Kontraktor (në vijim AK) ka kërkuar që fondi të vihej i plotë në dispozicion, por për shkak të pa mundësisë së buxhetit të shtetit për të qenë i plotë, është ndarë në vite.”

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Po ju ricitojmë: “Planifikimi i projektit është realizuar nga Bashkia Memaliaj, financimi nga AKUM. Fakt që vërtetohet me “Detyrën e Projektimit” nr. 659, datë 21.05. 2020. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 2. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 2): “Nga ana jonë sqarohet se: KLSH ka identifikuar gabim emrin e dhuruesit duke e quajtur “A. G.” Shpk, ndërkohë që emri i saktë i dhuruesit është “A. G.” Shpk. Gjithashtu sqarohet se dhuruesi ka shprehur dëshirën për të kryer shërbimin me kostot e tij pasi me parë Bashkia Memaliaj ka shprehur nevojën e madhe që kishte zona për ujë, shpopullimit të saj si dhe mungesës së fondeve dhe mungesës së kapaciteteve profesionale (kualifikimeve të specialisteve/ të punësuarve të saj dhe për hartimin e studim-projektimit, duke i paraqitur detyrën e projektimit. Më pas dhuruesi ka shprehur dëshirën për kryer këtë studim projektim me kostot e tij.

Gjithashtu angazhimi i dhuruesit vjen dhe si pasojë se: Pronari dhe Administratori bashkë me familjarët e tyre, janë pjesë e zonës që do të furnizohej me ujë dhe që kanë vite që përballen me mungesën e ujit.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Mungesa e “r” te OE “A. G.” Shpk, është lapsus dhe redaktimi juaj pranohet dhe reflektohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Kuptohet dhe pranohet hollësia për mungesën e shkronjës “r”, si dhe kuptohet që “nevojën e madhe” e ka shprehur Bashkia Memaliaj jo AKUM, por konstatimi juaj hedh poshtë pasaktësisë e konstatuar nga ju në pikën 1.

Paragrafi i fundit shpreh qartë, informacionin që ju keni njohuri për pronarin/administratorin familjarët, informacion që i mungon grupit të auditimit. E sipas jush është përgjegjësi e grupit të auditimit që nuk di ato që ju paramendon. Pretendimet tuaja merren në konsideratë pjesërisht nga grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: 3. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 3): “Nga ana jonë sqarohet se: Raporti i Vlerësimit në Mjedis (në vijim VNM) është hartuar nga Subjekti “G. S.” përfaqësuar nga profesionisti z. L.Sh. i licencuar me numër licence 262. Licencimi i z. L. Sh. gjendet thjeshtë në R. istrat e QKB (bashkëlidhur licencat e tij). Fakti që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (në vijim MTM) përfaqësuar nga institucioni përgjegjës Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim AKM), e ka pranuar dhe miratuar këtë VNM me vendim komisioni nr. 23, protokoll nr. ANI20320210002, datë 20.05.2021 (bashkëlidhur këtij observacioni), duket qartë se Audituesit nuk kanë administruar me përgjegjësi dokumentacionin e plotë të dosjes objektit nga Instituti i ndërtimit, nuk ishte miratuar VNM-ja, prandaj Instituti i Ndërtimit, me të drejtë në Oponencën Teknike ka pasur detyrim për ta dhënë këtë rekomandim. Data e dokumentit të Oponencës Teknike është më para datës së miratimit të VNM-së nga AKM. Meqenëse Audituesit nuk e kanë administruar me përgjegjësi dosjen e plotë të objektit, rrjedhimisht vijojnë pretendimet e tyre me pasaktësi dhe gabime.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Nga grupi i auditimit është cituar Oponenca Teknike e IN me nr. 2892/2 prot., datë 24.12.2020, (për VNM e hartuar nga OE “A. G.” Shpk) dhe VNM e paraqitur në SPE. Ju si NJP bazuar në këtë VNM e këtë Oponencë Teknike keni zhvilluar procedurën e prokurimit, (trajtuar hollësisht në akt konstatimin nr.8, dhe Projekt Raportin e Auditimit).

VNM e hartuar nga OE “G. S.” Shpk, dhe miratimi nga MTM është e vërtetë, por është 2 (dy) muaj e 8 (tetë) ditë pasi është zhvilluar procedura e prokurimit. Oponenca Teknike (rishikimi) me nr. 1955/2 prot., datë 26.11.2021 është 8 (tetë) muaj e 14 (katërmëdhjetë) ditë pasi është zhvilluar procedura e prokurimit. Nuk është problem i grupit të auditimit që ju i referoheni VNM dhe Oponencës Teknike që janë hartuar pasi është zhvilluar prokurimi i sipërcituar. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 4. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 4 dhe 5): “Nga ana jonë sqarohet se: Siç u sqarua më sipër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (dhe jo “Ministria e Mjedisit” siç shprehen Audituesit), si institucion drejtpërdrejt kompetent, e ka miratuar VNM-në e paraqitur, pasi ka vlerësuar të plotësuarat të gjitha kushtet ligjore për miratimin e saj”.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Ne nuk kemi aftësinë paranormale që keni Ju si NJP që dini çdo të ndodhte me miratimin e VNM nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (dhe jo “Ministria e Mjedisit” siç shprehen Audituesit). Grupi i auditimit i është referuar Oponencës Teknike me nr. 2892/2 prot., datë 24.12.2020 në faqen 12, të cilin e ka perfrazuar në materialin e auditimit, (paragrafi i fundit para pikës 5, Specifikimet teknike dhe përshkrimi i punimeve). Fakti që ju nuk pranoni ekzistencën e oponecës teknike të sipërcituar, nuk është problem i grupit të auditimit (ju nuk keni lexuar materialin e auditimit, në të cilin është referuar grupi i auditimit). Ne i kemi referuar oponecës teknike që është pjesë e DATË Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: 5. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 5): Nga ana jonë Sqarohet se: Siç u sqarua më sipër, autoriteti përgjegjës për vlerësimin e VNM është vetëm MTM përfaqësuar nga AKM dhe asnjë institucion tjetër. Në kohën kur i është bërë Oponenca Teknike objektit nga Instituti i ndërtimit, nuk ishte miratuar VNM-ja, prandaj Instituti i Ndërtimit, me të drejtë në Oponencën Teknike ka pasur detyrim për ta dhënë këtë rekomandim. Data e dokumentit të Oponencës Teknike është më para datës së miratimit të VNM-së nga AKM. Meqenëse Audituesit nuk e kanë administruar me përgjegjësi dosjen e plotë të objektit, rrjedhimisht vijojnë pretendimet e tyre me pasaktësi dhe gabime.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: NJP ka zhvilluar procedurën e prokurimit para hartimit të VNM, para datës së miratimit të VNM-së nga AKM, para Oponencës Teknike, ndërsa sipas jush “*audituesit nuk kanë administruar me përgjegjësi dosjen e plotë të objektit, rrjedhimisht vijojnë pretendimet e tyre me pasaktësi dhe gabime*”.

Grupi i auditimit i referohet dokumentacionit të AK që ndodhen në dosjen e prokurimit, pasi nuk ka aftësitë tuaja të parashikojë çdo dokumentacion të prodhuar/formular pas realizimit të procedurës. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: 6. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 5, 6 dhe 7): “*Nga ana jonë konstatohet se: Audituesit nuk kanë dhënë asnjë vlerësim lidhur me këto dorëheqje të njëpasnjëshme të cilat janë të konsiderueshme në numër, ku secili punonjës i administratës në zbatim të ligjit dhe Urdhrit të Kryetarit, kanë pasur detyrimin e tërë për të bërë detyrën, por nuk kanë pranuar!*”

Për këtë situatë, nga AK nuk është marrë asnjë masë administrative për asnjërin. Këtë fenomen, Audituesit kanë pasur detyrimin ta vlerësonin dhe të shpreheshin nëse heqja dorë ishte ligjore dhe jo ta anashkallonin.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Nga ana juaj kërkohet të paraqisni dokumente ligjore apo prova të reja për çështjet e trajtuara në projekt raportin e auditit dhe jo të jepni opinione apo të vlerësoni “problematika” që konstatojnë në materialet e auditimit. Janë struktura të tjera që kanë për detyrë të shprehen në lidhje me cilësinë e materialit të auditimit. Meqënëse ju dini gjithçka, mund t’i kishit propozuar titullarit të AK masa administrative para se të ushtronit detyrën e anëtarëve të NjP. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 7. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 7) “*Nga ana jonë sqarohet se: Procedura e prokurimit për këtë objekt është zhvilluar në muajin mars 2021, periudhë në të cilën ende nuk kishte hyrë në fuqi ligji i ri për prokurimet publike, ndaj të gjitha arsyetimet e mëposhtme do të jenë në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe është plotësisht në mbështetje të tyre.*”

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Nga grupi i auditimit nuk kuptohet se për kë pasaktësi shprehet Njësia e Prokurimit. Grupi i auditimit në të gjithë materialin e auditimit i është referuar Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si rrjedhojë nuk kuptohet ku qëndron “konstatimi” i NjP. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 8. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 7 dhe 8): “*Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit ka bërë të gjitha argumentimet e saj me shkrim lidhur kriteret/kërkesat e vendosura ne DT, të cilat janë të arkivuara në institucionin e Bashkisë Memaliaj dhe që nuk janë përmendur nga Audituesit.*”

Në vijim të tyre (të cilat janë baza e vendosjes së kriterëve) në mënyrë të përmbledhur sqarojmë se objekti ne referencë të projekt-preventivit dhe dokumenteve të dosjes së tij, parashikon vepra arti si: Rrugët e shërbimit për tek burim/kaptazh - Pusin e grumbullimi dhe depot e ujit, Kaptazhin i cili është në mesin e shtratit të lumit të prerjes tërthore, Godina e Stacionit të Pompimi, Depot e uji përfshirë rethime me strukturë metalike etj.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH: Ju nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion konkret, bazë ligjore apo teknike në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit. Pretendimet

tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk kanë asnjë mbështetje tekniko-ligjore, nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 9. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 7 dhe 8): “Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit ka bërë të gjitha argumentimet e saj me shkrim lidhur kriteret/kërkesat e vendosura siç e shpjegoam më lart gjithsesi në mënyrë të përmbledhur, VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi në Kreun IV pika la) të tij përcakton kriterin minimal të eksperiencës që duhet për të përfitur statusin e Drejtuesit Teknik. Pra është një përcaktim ligjor detyrues për t'u përmbushur për të përfitur statusin si drejtues teknik, po kjo s'do të thotë se një inxhinier i cili sapo ka përfitur statusin si Drejtues Teknik i një shoqërie, është i barabartë me një profesionist i cili ka 10 vjet që e ka këtë status dhe ka ushtruar profesionin e tij me këtë status.

Ndaj Njësia e Prokurimit duke vlerësuar kompleksitetin, rëndësinë dhe madhësinë e objektit, gjykoj se eksperiencia e Drejtuesit Teknik të shoqërisë të ishte minimumi 10 vjet, në mënyrë që, punimet të ndiqen nga një Drejtues Teknik, i cili në sajë të eksperiencës, do të garantonte zbatimin e objektit në të gjithë kompleksitetin e tij duke mos sjellë asnjë pengesë për këtë aspekt.

Ju informojmë gjithashtu se kapja e ujit të këtij burimi në mesin e shtratit të lumit, është e para në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Nuk ka asnjë burim në Shqipëri që të jetë në mesin e lumit dhe realizuar shfrytëzimi i tij. Ky burim i cili pasqyrohet edhe në hartën zyrtare të IGJEUM, nuk është shfrytëzuar për shkak të kompleksitetin dhe vështirësive që paraqiste. Prandaj është përgjegjësi tepër e lartë për realizimin me sukses të projektit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit, duke iu referuar të gjithë formimit profesional të saj, si dhe në referencë të prokurimeve që ka zhvilluar dhe vijon të zhvilloj Fondi Shqiptar i Zhvillimit (në vijim FSHZH), ka marrë praktikat më të mira për realizimin me sukses të procedurës e cila më pas ka rezultuar e suksesshme dhe pa ankesa apo vonesa.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Grupi i auditimit nuk i referohet “vlerësimit dhe gjykimit tuaj” por VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 10. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 7 dhe 8): “Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit i bërë të gjitha argumentimet e saj me shkrim lidhur kriteret/kërkesat e vendosura siç e shpjegoam më lart, gjithsesi në mënyrë të përmbledhur sqarohet se:

Pretendimi, i Audituesve është i paqartë në arsyetim, pasi përfundimi i pretendimit nuk është në linjë logjike më interpretimin e gabuar që janë përpjekur ti bëjë dispozitave të pëmendura. Megjithatë ju sqarojmë se; Kriteri për numrin mesatar të punonjësve është vendosur për të provuar kapacitetin e operatorëve që të mund të realizojë punimet sipas afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve.

Ky kriter nuk ka për qëllim të provojë qëndrueshmërinë financiare të operatorit, pasi për këtë aspekt është kërkesa 2. 1 “Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar”.

Njësia e prokurimit ka pasur pikërisht qëllimin e provimit të kapacitetit të fuqisë punëtore dhe e ka përcaktuar këtë numër në bazë të kalkulimeve të nevojshme në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës”.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Pikërisht këto kalkulime ju kanë munguar, argumentimi i numrit të punonjësve, makinerive/pajisjeve, orët e punës dhe grafiku i punimeve. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 11. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 10): *“Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit ka bërë të gjitha argumentimet e saj me shkrim lidhur kriteret/kërkesat e vendosura në DT, të cilat janë të arkivuara në institucionin e Bashkisë Memaliaj dhe që nuk janë përmendur nga Audituesit.*

Në vijim të tyre (të cilat janë baza e vendosjes së kriterëve), në mënyrë të përmbledhur sqarojmë se objekti në referencë të projekt-preventivit dhe dokumenteve të dosjes së tij, parashikon punime si: Ngritje mekanike me stacion pompimi ku në referencë të formimit profesional dhe licencimit, inxhinieri mekaik është i vetmi kompetent lidhur me montimin dhe harmonizimin e tyre me pjesën tjetër elektrontle Punimet masive të gërmimit si për Veprën e Marrjes ashtu dhe për Linjën Kryesore të Dërgimit dhe Linjat e Shpërndarjes, Inxhinieri i Mjedisit gjatë zbatimit jo vetëm që është i domosdoshme në këtë projekt, por është detyrim ligjor për shkak se projekti kalon në Zona të Mbrojtura Monumente Natyre (ogilat e Vasjarit). Gjithashtu për zbatimin e rekomandime të Vendimit të AKM-së të cituar më lart (bashkëlidhur).

Gjithashtu, një ndër pjesët kryesore integrale të projekt-preventivit është sistemi elektronik i transmetimit e të dhënave “SCADA”, sistem ky që për t’u realizuar me sukses nevojiten profesioniste të fushës pra në telekomun. cionit për të cilat ofertuesi duhej ta dispononte detyrimisht në mënyrë që projekti të realizohej me sukses dhe sipas parashikimeve.

Pretendimi i Audituesve për kufizime të operatoreve të tjerë është gjithashtu i pasaktë për faktin se nuk ka pasur asnjë kërkesë apo ankesë nga asnjë Operator Ekonomik (në vijim OE) apo subjekt tjetër të cilët janë njohur botërisht me kriteret e vendosura meqënëse theksojmë se publikimi i procedurës, pra shpallja e prokurimit ka qenë publik, i hapur dhe i aksesueshëm për të gjithë të interesuarit ose jo”.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Ju shprehemi se: *“kemi bërë të gjitha argumentimet me shkrim lidhur me kriteret/kërkesat e vendosura në DT, të cilat janë të arkivuara në institucionin e Bashkisë Memaliaj dhe që nuk janë përmendur nga Audituesit”*, por nuk paraqesni asnjë dokumentacion lidhur me këto argumentime mbi të cilat të mbështesni kundërshtinë tuaj. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 12. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 10): *“Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit ka bërë të gjitha argumentimet e saj me shkrim lidhur kriteret/kërkesat e vendosura në DT, të cilat janë të arkivuara në institucionin e Bashkisë Memaliaj dhe që nuk janë përmendur nga Audituesit. Sqarohet gjithashtu se mbetje" nuk mund të konsiderohen vetëm ato të ndoturat nga ujërat. Pavarësisht cilësimeve të Projektuesit, Njësia e Prokurimit ka vlerësuar në këtë pjesë rekomandimet e Oponencën Teknike të kryer nga Instituti i Ndërtimit ku citohet menaxhimi i mbetjeve përpara fillimit të punimeve” siç dhe ju e keni përmendur në këtë Akt Konstatimi nr. 8. Por edhe nëse nuk do ishte tek rekomandimet e Oponencës Teknike, Njësia e Prokurimit ka në përbërjen e saj profesionistin e fushës inxhinier ndërtimi në Zbatim, Projektim dhe Mbikëqyrje dhe të licencuar nga ministria përkatëse, me përvojë të gjatë në këto fusha, i cili ka vlerësuar se gjatë punimeve të rrjeteve të brendshme të ujësjellësve nëpër fshatra, domosdoshmërisht do*

kishte problematike në dëmtimin e rjeteve të ujërave të ndotura. Për të vazhduar më tej dhe në referencë të sqarimeve të mësipërme, se gjatë publikimit të procedurës nuk ka pasur asnjë ankese për të cilën do të ishte sqaruar çdo i interesuar në bazë të argumentimeve të dosjes, pra nuk ka ky kriter është i argumentuar dhe ka diskriminuar asnjë përderisa cilido që mund të ndihej i diskriminuar, ka pasur të gjitha të drejtat pa kufizim që i jep legjislacioni dhe nuk mund të pengohet nga asnjë situatë, për të bërë ankese apo kërkesë për sqarim tek Autoriteti Kontraktor.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 13. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 11): “Nga ana jonë sqarohet se: Ky kriter, nuk është vendosur për të provuar nëse OE ka eksperiencë të suksesshme për realizimin e punimeve, apo qëndrueshmëri financiare, pasi për të provuar këto kapacitete, janë kërkesa të tjera të përcaktuara në DT, respektivisht kontratat e punëve të ngjashme (përcaktuar në seksionin 1.a) ose 1.b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit) dhe bilancet e viteve 2017-2019 të certifikuar (përcaktuar në pikën 2.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit).

Kriteri i mësipërm, në lidhje me punonjësit i përcaktuar në pikën 5.5, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, për të pasur një staf teknik, me përcaktim për kontratat e punës dhe kartelat personale të sigurimit teknik, është vendosur nga Njësia e Prokurimit për të vërtetuar se OE ka kapacitetin të ketë punonjës të aftë, të kontraktuar rregullisht, që realizojnë punimet dhe nuk sjellin pengesa në kohë dhe cilësinë e zbatimit të objektit, për shkak të mangësive në aspektin e sigurimit teknik.

Ky është një kriter mëse i nevojshëm për një objekt me atë impakt tepër të madh, për sa i përket shtrirjes së madhe (8 fshatra) dhe për sa i përket rëndësisë së tij, pasi është uji i pijshëm, një e drejtë themelore bazike që këto zona nuk e kanë pasur asnjëherë.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 14. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 11): “Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit, në çdo kriter të përcaktuar, ka për qëllim të garantojë që OE i cili do shpallej fitues të kishte kapacitetin teknik, në këtë rast mnanovratorë dhe automakinistë të gatshëm për të filluar punë në çdo moment nëse OE do të shpallej fitues.

Pra NJP, nuk mund të rrezikojë mos zbatimin e grafikut të punimeve të realizimit të objektit, duke mos e përcaktuar këtë kriter, pasi nëse do të ishte ndryshe, do ndodheshim para situatës që eventualisht një OE i shpallur fitues, do të fillonte të kërkonte për staf teknik dhe të kontraktonte këta të fundit, pasi të lidhte kontratën, fakt ky që do ishte absolutisht në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik pasi do të kontraktonte për realizimin e kontratës, një OE që nuk ishte i aftë për të realizuar kontratën (pa përmendur këtu dhe kohën që do të humbte nga punimet, për shkak të mungesës së kësaj fuqie punëtore).

Për këtë arsye NJP nuk ka përcaktuar afat për prezencën e këtyre lloj punonjësish në listë pagesë, pasi është e parëndësishme për këtë kategori stafi dhe për natyrën e kontratës (pra OE mund edhe t'i kishte kontraktuar pikërisht në momentin që do të ofertonte për këtë objekt) pasi e rëndësishme ishte vetëm të garantohej kapaciteti i plotë teknik i OE që do shpallej fitues.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Grupi i auditimit i është referuar rastit kur makineritë disponohen me qira, Ju vazhdoni me konstatime e sqarime pa asnjë bazë

ligjore apo teknike. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 15. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr. 8, faqe 11 dhe 12): “Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit e bërë argumentimin e saj me shkrim lidhur me këtë kriter/kërkesë të vendosura siç e shpjeguar më lart, gjithsesi në mënyrë të përmbledhur sqarohet se: Standardi ISO 3834-2 kushtet e cilësisë për shkririen e metaleve (kualifikimi në produktet e salduara).

Saldimi është metodë që kryesisht përdoret në prodhimtarinë e mallrave industriale. Metoda e shkrirjes me saldim me presion përdoret në industri për prodhimin e një game të gjerë të produkteve. Burimet, kostoja e prodhimit dhe produkti final kanë rëndësi të madhe që ndikojnë në cilësi. Standardi EN ISO 3834-2 për prodhimin me certifikatën për saldim, është përgatitur me qëllim të përcaktimit të kërkesave të arsyeshme të cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim. Standardi EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura; Nevoja për rregullat themelore në ndërmarrje, si dhe kërkesat për cilësi të saldimit dhe dëshira për të prodhuar me cilësi të duhur varet nga aftësia e prodhuesit për të ofruar udhëzime në identifikimin e burimeve. Standardet janë përdorur si bazë për vlerësimin e standardeve të sistemit për cilësinë e saldimit të prodhuesve. Përfundimisht meqenëse Projekti parashikon tubacion çeliku dhe maksimumi i gjatësisë së tubacionit të çelikut është 14m, atëherë për të krijuar linjat (të dërgimit dhe shpërndarjes), tubat duhet të bashkohen me saldim me shkrirje për të prodhuar një tubacion të vazhduar. Pra ka të njëjtin efekt sikurse saldimi në kushte fabrikë meqenëse tubacioni me gjatësi deri në 14m është edhe ai i salduar në vetvete. Nga përvoja, është me rëndësi të lartë bashkimi i këtyre tubave të çelikut në mënyrë profesionale. Sipas pretendimit të Audituesve, çdo shoqëri që e zotëron këtë ISO duhet të ketë fabrike?! Pasi me këtë ISO i referohet vetëm kualifikimit të zbatuesit rrjedhimisht punonjësve të tij të fushës etj.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Ju ngatëroni “prodhimin” me “furnizim e vendosje” (apo saldimin e tubove). Certifikata e sipërcituar është për prodhues, jo për montim. Në rastin më të mirë për ju, mund të kërkohej saldator (me patent, apo për saldim me prani uji, etj), apo kontrollor i saldimit (saldim me filmim) gjë që nuk është kërkuar nga ju në DATË Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 16. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 12 dhe 13): “Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit e bërë argumentimin e saj me shkrim lidhur me këtë kriter/kërkesë të vendosura siç e shpjeguar më lart, gjithsesi në mënyrë të përmbledhur sqarohet se:

Kriteri i mjekut në shoqëri është kërkuar për shkak të legjislacionit por edhe të qëndrueshmërisë së subjektit zbatues meqenëse nga përvoja, subjekti që nuk ka pasur në momentin e prokurimit ose e ka pasur me kontratë të përkohshme, ka rezultuar se Mjeku nuk është paraqitur asnjëherë në objekt apo është prishur kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe tij, dhe zbatuesi nuk ka arritur të nënshkruajë kontratë me mjek tjetër dhe si pasojë nga dëmtimet që mund të parandaloheshin, ka pasur edhe viktime apo pasoja të tjera shëndetësore. Prandaj NJP gijkon se Mjeku duhet të jetë me kontratë të regullt. Ky kriter i është referuar edhe VKM nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, të ndryshuar.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH: Në Akt Konstatim, grupi i auditimit është shprehur qartë në lidhje me kërkesën për mjek, ju vazhdoni të konstatooni e gjykoni.

Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: 17. Pasaktësi (të Akt Konstatim nr.8, faqe 12 dhe 13): “Nga ana jonë sqarohet se: Njësia e Prokurimit për këtë objekt është me përbërje:

Z. D. B. , Përgjegjës i prokurimi, me profesion Jurist;

Z. Sh. D. , Anëtar i prokurimi, me profesion Ekonomist;

Z. L. H. , Anëtar i prokurimi, me profesion Inxhinier Ndërtimi/ Hidroteknik/ Rruga Ura.

OE “A. G.” Shpk, nuk ka asnjë lidhje me hartimin e kriterëve të dokumenteve të tenderit për objektin e mësipërm. Kjo shoqëri, vetëm ka dhuruar projektin për këtë objekt sipas kontratës nr. 43/1 dhe 659/1, datë 21.05.2020, por sigurisht nuk është përfshirë në asnjë moment në veprimtarinë e organit publik. Është i pakuptimtë dhe pa asnjë lidhje logjike, konkluzioni i Audituesve në Akt Konstatimin nr. 8, pasi ata vetë citojnë në fillim të këtij Akt Konstatimi se është administruar dosja pjesë e së cilës është Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, nr. 15 datë 19.01.2021 Për një ndryshim në urdhrin nr. 08 datë 15.01.2021 Për ngritjen e Njesisë së Prokurimit, për prokurimin me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe qytetin Memaliaj”, Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, nr. 24, datë 05.02.2021 “Për ndryshimin në urdhrin nr. 24, date 28.01.2021 “Për ngritjen e Njesisë së Prokurimit, për prokurimin me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe qytetin Memaliaj”, i cili emëronte Njësinë e Prokurimit (sipas të cilit, kjo shoqëri nuk është pjesë).

Ky konkluzion, tregon qartazi që grupi i auditimit ka konstatuar jo në bazë të rregullimeve ligjore, por në bazë të thashethemeve dhe aludimeve të pakuptimta që nuk kanë asnjë bazë logjike dhe sigurisht asnjë bazë juridike apo dokumentare.

Asnjë gjetje e Audituesve nuk qëndron. Për këtë arsye kërkojmë nga Drejtuesit e lartë të KLSH, reflektimin e argumenteve në Raportin Përfundimtar.

Jemi të gatshëm të sqarojmë me argumente ligjore e tekniko-ekonomike, në detaje edhe më të zgjeruara çdo paqartësi, përpara miratimit të Raportit Përfundimtar”.

Qëndrimet e Audituesit Shtetërorë të KLSH-së: Nëse si Njësi Prokurimi nuk kuptoni që: Projekti, specifikimet teknike; preventive, grafiku i zbatimit të punimeve, VNM e oponenca teknike janë pjesë e dokumentacionit teknik, me anën e të cilit bëhet i mundur ndërtimi i plotë dhe vënia në shfrytëzim e objektit, ky nuk është problem i grupit të auditimit. Ju jeni anëtar të Njesisë së Prokurimit (nuk jeni auditues i grupit të auditimit), jeni subjekt auditimi. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Me nr. 49/13 prot., datë 05.02.2021, është lidhur Kontrata e Punës Individuale me Kohë të Pjesshme, midis Bashkisë Memaliaj, përfaqësuar nga Titullari i AK z. Gj. G. në cilësinë e punëdhënësit dhe z. B. Y. –Inxhinier Ndërtimi (me pagë 35,000 lekë në përfundimin e procedurës).

Me urdhrin nr. 31, e nr. 49/14 prot., datë 08.02.2021, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. E. H. (Kryetare); z. F. H. e z. B. Y. Anëtar.

Me procesverbalin nr. 49/15 prot., datë 08.02.2021 është dorëzuar fjalëkalimi që përdoret në SPE (APP) të AK Bashkia Memaliaj nga z. P. H. tek z. D. B. (Jurist).

Titullari i AK me autorizimin nr. 49/16 prot., datë 08.02.2021 për administrimin e SPE, deri në përfundim të prokurimit (zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit) ka vendosur z. D. B. .

Procesverbali i NJP me nr. 49/17 prot., datë 08.02.2021, është shpallur fondi, limit, tipi i kontratës dhe lloji i procedurës së prokurimit.

NJP me nr. 49/18 prot., datë 08.02.2021, drejtuar Titullari të AK, z. Gj. G.i ka rekomanduar përmbajtjen e procesverbalit të sipërcituar.

Me urdhërin nr. 31/4 e nr. 49/19 prot., datë 08.02.2021, Titullari AK i është drejtuar Njesisë së Prokurimit për zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Në dosjen e procedurës së prokurimi gjenden “Formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interes”, formuluar/nënshkruar nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe dhe KVO.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit:

Nga procesverbali i KVO me nr. 49/22 prot., datë 31.02.2021 për hapjen e procedurës ka rezultuar që ka marrë pjesë 1 (një) BOE, përkatësisht **BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk**, (me NIPT respektive: L.....H dhe K.....I), me vlerë ekonomike të ofertës **410,174,927 (katërqind e dhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë) lekë pa Tvsh.**

Shkeljet e konstatuara gjatë vlerësimit të ofertave:

Raporti përmbledhës me nr. 49/23 prot., datë 07.04.2021, miratuar me nr. 49/24 prot., datë 49/24 prot., datë 08.04.2021 nga titullari i AK z. Gj. G..

Njoftimi i klasifikimit është bërë më datë 31.03.2021, Formulari i Njoftimit të fituesit me nr. 49/25 prot., datë 08.04.2021.

Në dosjen e prokurimit gjendet me nr. 49/26 prot., datë 15.04.2021, dokumentacioni për dorëzimin e dosje fizike të BOE të shpallur fitues.

Dokumentacioni i sipërcituar, marrë në dorëzim nga znj. E. H. (Kryetar i KVO), i është dorëzuar z. D. B. (Përgjegjës i NJP).

Lidhja e kontratës:

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 49/29 prot., datë 09.06.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Memaliaj, të përfaqësuar nga Kryetar z. Gj. G.dhe **BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk** me përfaqësues respektiv administratorët z. A. M. e z. A. I., me objekt të kontratës: “*Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe qytetin Memaliaj*”, Bashkia Memaliaj, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **487,378,589 (katërqindë e tetëdhjetë e shtatë milionë e treqindë e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqindë tetëdhjetë e nëntë) lekë me Tvsh.**

Titulli i gjetjes 28: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues, BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka pranuar nënkontratimin me OE që është konflikt interesi, si dhe nuk zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës që do të kryejë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Në dokumentacionin e paraqitur në SPE gjenden:

Akt Marrëveshja (Kontratë Bashkëpunimi) me nr. 844 rep., nr. 282 kol., datë 11.03.2021, e lidhur ndërmjet OE “K.” Shpk, përfaqësuar nga administrator z. A. M., dhe OE “E. K.” Shpk, përfaqësuar nga administrator z. A. I., palët kanë rënë dakord të lidhin kontratën e bashkëpunimit në procedurën me objekt: “*Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj*”, të publikuar në SPE me REF: 86357-01.09.2021 dhe date hapje të ofertave 12.03.2021. Punimet do të kryhen në raportin:

- 9.3% të punimeve do të kryhen nga OE “K.” Shpk, konkretisht sipas zërave dhe volumeve të ofertës ekonomike me pjesëmarrjen në punime.

- 90.7% të punimeve do të kryhen nga OE “E. K.” Shpk, konkretisht sipas zërave dhe volumeve të ofertës ekonomike me pjesëmarrjen në punime.

Me prokurën e posaçme nr. 845 rep., nr. 283 kol., datë 11.03.2021, OE “E. K.” Shpk, përfaqësuar nga administrator z. A. I., ka deklaruar se autorizon si përfaqësues të posaçëm z. A. M., për objektin e prokurimit.

Deklarata noteriale me nr. 847 rep., nr. 285 kol., datë 11.03.2021, me deklarues z. A.I., administrator i OE “E. K.” Shpk, deklaron se në rast se do të shpallet fitues në procedurën me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Iiras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, nënkontraktori do të jetë OE “A. G.” Shpk, në masën 40% të punimeve që na takon në kontratën e bashkëpunimit dhe bashkimit si dhe ofertën ekonomike me OE “K.” Shpk.

Deklarata e datës 11.03.2021, me deklarues z. A. M., administrator i OE “K.” Shpk, deklaron se në rast se do të shpallet fitues në procedurën me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Iiras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, në rast të shpalljes fitues në procedurën e prokurimit nën kontraktori do të jetë në OE “A. G.” Shpk, në masën 40% të punimeve që na takon në kontratën e bashkëpunimit dhe bashkimit si dhe ofertën ekonomike me OE “E. K.” Shpk.

I. BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk nuk plotëson pikën 2.3 e 2.31 të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

3. Vërtetim lëshuar nga bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Njësia e Vetqeverisjes Vendore për vitin 2019, 2020.

3.1 Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB.

OE “E.K.” Shpk

Gjatë Viti 2019, referuar transiasioneve të Thesarit ka ushtruar veprimtari në Bashkitë: Tiranë; Ura Vajgure; Kuçovë; Sarandë; Dropull; Patos dhe ka paraqitur:

Vërtetimin nr. 753 prot., datë 02.03.2020, nga Bashkia Ura Vajgurore, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore për vitin 2019.

Vërtetimin nr. 1228 prot., datë 23.05.2020, nga Bashkia Ura Vajgurore, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore për vitin 2019.

Vërtetimin nr. prot., datë 21.05.2019, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka paguar detyrimet vendore.

Vërtetimin datë 22.05.2019, nga Bashkia Patos, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore për vitin 2019.

Vërtetimin datë 27.02.2020, nga Bashkia Patos, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore për vitin 2019.

Vërtetimin datë 09.09.2019, nga Bashkia Patos, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore për vitin 2019.

Vërtetimin datë 26.02.2020, nga Bashkia Kuçovë, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore për vitin 2019.

Vërtetimin datë 11.10.2019, nga Bashkia Kuçovë, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore për vitin 2019.

Vërtetimin datë 06.11.2019, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka paguar detyrimet vendore.

Gjatë vitit 2020, referuar transiasioneve të Thesarit ka ushtruar veprimtari në Bashkitë Patos; Sarandë; Ura Vajgure; Kuçovë; Tiranë; Dropull dhe ka paraqitur:

Vërtetimin nr.13-9599/1 prot., datë 01.12.2020, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka paguar detyrimet vendore për vitin 2020.

Vërtetimin nr. E-6185/1 prot., datë 24.04.2019, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka paguar detyrimet vendore për vitin 2020.

Vërtetimin nr. 2612 prot., datë 17.09.2020, nga Bashkia Ura Vajguore, ku vërtetohet që nuk ka detyrime për taksat vendore.

Vërtetimin nr. prot., datë 10.07.2020, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka paguar detyrimet vendore.

Vërtetimin nr. prot., datë 10.02.2020, nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet që ka paguar detyrimet vendore.

II. BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, nuk plotëson Kapaciteti teknik në DT:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

b. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë deri në 50% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

c. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është të paktën sa gjysma e vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentet e mëposhtme:

- Kontratë.*
- Situacionin përfundimtar.*
- Aktin e kolaudimit.*
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit. Datë 26.10.2018 (ka paraqitur Formularin e Vlerësimit)*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë.*
- Situacionin përfundimtar.*
- Akt kolaudimi objekti.*
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit.*
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.*

III. OE “E. K.” Shpk, ka paraqitur kontratat për punë të ngjashme

Nënzëri 1.1 “Instalimet e ujësjellësit” me vlerë 482,860 lekë pa Tvsh.

2. Nënzëri 1.2 “Stacioni i pompave, depo uji”, me vlerë 2,319,557 lekë pa Tvsh.

Zëri “Kanalizim i ujërave të zeza”

3. Nënzëri 2.1 “Instalimet e kanalizimeve brenda nyjeve”,

4. Nënzëri 2.2 “Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza”, me vlerë 207,407 lekë pa Tvsh.

3. Kontrata e sipërmarrjes me nr. 23 prot., datë 13.09.2018 për objektin: “Rehabilitimin dhe vitalizimi i Korpusit dhe i terreneve sportive të shkollës “H. Tasimi”, Sarandë”, e lidhur me Titullarin e AK znj. F. K. Vlera e kontratës është 63,124,740.60 lekë me Tvsh.

Në situacioni përfundimtar, vlera e zërit D: “Punime kanalizimi” është me vlerë 510,714.20 lekë pa Tvsh.

4. Në objektin “Godinë banimi dhe shërbimi 7 dhe 9 kate, me 2 kate nëntokë”, në pronësi të znj. A. D., znj. E. S. dhe znj. S. K. Vlera e situacionit përfundimtar është 168,284,828 lekë me Tvsh.

Në situacioni përfundimtar, vlera e nënzërave:

10/a “Ujësjellës i brendshëm” është 2,014,664 lekë pa Tvsh.

10/b “Punime kanalizim i brendshëm”, është 789,115 lekë pa Tvsh.

10/d “Rezevuar uji _+ Stacion pompa” është 712,117 lekë pa Tvsh.

10/e “Kanalizim i jashtëm” është 25,074 lekë pa Tvsh.

5. Kontrata e sipërmarrjes me nr. 27634/9 prot., datë 22.09.2017 për objektin: “Ndërtimi i ri i shkollës 9–vjeçare “S. M.”, Tiranë”, e lidhur me Titullarin e AK z. E. V. Vlera e kontratës është 273,453,983.50 lekë me Tvsh.

Ku OE “E.K.” Shpk do të realizojë 26 % e OE “A.” Shpk do të realizojë 74 %

Në situacioni përfundimtar, vlera e nënzërave:

D-2 “Sistemi i ujit të ngrohtë sanitar”, është 2,680,045 lekë pa Tvsh.

D-3 “Sistemi i shkarkimeve të ujërave të zeza dhe të shiut”, është 2,721,377 lekë pa Tvsh

6. Kontrata e sipërmarrjes me nr. 1461/11 prot., datë 01.10.2018 për objektin:

“Rikonstruktion i rrugës “Koli Marku”, Patos”, e lidhur me Titullarin e AK znj. R.B. Vlera e kontratës është 69,790,772 lekë me Tvsh.

Në situacioni përfundimtar, vlera e nënzërave:

F “Punime ujësjellësi dhe kanalizimi”, është 6,999,475 lekë pa Tvsh.

7. Kontrata e sipërmarrjes me nr. 27634/9 prot., datë 22.09.2017 për objektin: “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor Unaza e Pogonit, Faza I”, Tiranë”, e lidhur me Titullarin e AK z. A.D. Vlera e kontratës është 137,897,895 lekë me Tvsh.

Zëri V “Punime të ndryshme” nënzëri 5 “Puse kontrolli 1.5x1.5x1.5m” me vlerë 194,100 lekë pa Tvsh.

OE “E. K.” Shpk do të realizojë 24 % (njëzet e katër përqind) të punimeve të cilat përfshijnë punimet në zërat: Kapitulli I “Punime gjurmimi e mbushje në rrugë”. Zërat: “Shkulje pemësh e rrënjëve të pemëve”; “Mbushje me material të gjermuar në trupun e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”; “Gjermim shkëmb i fortë, sek i lirë, me mina te vogla me ekskavator 1m3 + transport”; Kapitulli II “Punime në veprta arti”: Zërin “Struktura monolite betoni C 16/20 (mure e tomb+ura)”. Kapitulli III “Punime shtresash dhe asfaltimi”: Zëri “Shtresë çakëlli t=5cm, përhapur e ngjeshur me makineri”.

Kapitulli IV “Punime të sinjalistikës rrugore”: Zërin “FV tabela të ndryshme rrugore

D=60cm. Të gjitha zërat e punimeve në Kapitullin V “Punime të ndryshme si dhe të gjitha zërat e punimeve të dala nga fondi reserve”.

OE “4 A.” Shpk do të realizojë 76 %

8. Kontrata e sipërmarrjes me nr. 27634/9 prot., datë 22.09.2017 për objektin: “Restaurimi i rrugës hyrëse të kisha byzantine e lindjes së Marisë në Peshkëpinë e Poshtëme dhe fshatin Radat, Bashkia Dropull”, Dropull”, e lidhur me Titullarin e AK z. A. D. Vlera e kontratës është 28,968,242 lekë me Tvsh.

Zëri V “Punime për tumbino” me vlerë 905,300 lekë pa Tvsh.

9. Kontrata e sipërmarrjes me nr. 10636/5 prot., datë 13.02.2017 e lidhur me ARRSH, për objektin: “Plotësimi dhe përfundimi i objektit ndërtimi i unazës së re e Tiranës (segmenti “Komuna e Parisit” – “Shkolla Teknologjike”, pjesa e mbetur 0.000+0.640”. Vlera e kontratës është 1,049,558,422 lekë me Tvsh. OE “E. K.” Shpk do të realizojë 10 % dhe OE “4 A.” Shpk do të realizojë 90 %

OE “E. K.” Shpk, merr përsipër kryerjen e punimeve sipas përqindjes së mësipërme të bashkëpunimit për zërat e mëposhtëme të punimeve:

A-3/9 “Struktura monolite betoni C 20/25”

B-1/4 H/ “Izolim me emulsion, 2 duar bitum”

B-1/5 “Struktura monolite betoni C25/30”

B-1/6 “Struktura monolite betoni C20/25”

B-1/7 “Struktura monolite betoni C20/25”

B-178 “FV hekur betoni periodik, C-5,0 d> 12mm”

B-1/9 “FV. Tub PVC D75mm”

B-1/10 “Ndërtim drenazhi me gjeotekstil (0.5x1.2m)”

B-1/11 “Shpim me sonda d=0.8m, deri 15m (perde mbajtëse)”

B-1/12 “Bojë bikoponente (sprajt)”

B-2. “Punime në vepra arti të mëdha (HD. 10-30m) (Komplet kapitulli i punimeve)”

O-1. “Punime dheu (Komplet kapitulli i punimeve)”

O-2. “Punime betoni dhe beton-arme (Komplet kapitulli i punimeve)”

P-1. “Punime dheu (Komplet kapitulli i punimeve)”

P-2. “Punime betoni dhe beton-arme (Komplet kapitulli i punimeve)”

OE “E. K.” Shpk, do të kontribuojë edhe në asistencë teknike duke iu përmbajtur përqindjes, së saj.

OE “4 A.” Shpk, merr përsipër kryerjen e punimeve sipas përqindjes së mësipërme të bashkëpunimit për të gjithë zërat e punimeve që nuk do të realizohen nga OE “E. K.” Shpk

9/1. Shtesë kontrata e sipërmarrjes me nr. 4969/7 prot., datë 25.06.2018 për objektin: “Plotësimi dhe përfundimi i objektit ndërtimi i unazës së re e Tiranës (segmenti “Komuna e Parisit” – “Shkolla Teknologjike”, pjesa e mbetur 0.000+0.640” Vlera e kontratës është 169,176,925.60 lekë me Tvsh.

OE “E. K.” Shpk do të realizojë 10 %

OE “4 A.” Shpk do të realizojë 90 %

Nga auditimi konstatohet se asnjë prej kontratave (dhe të gjitha së bashku) nuk përmbush kërkesat minimale të cilat janë vendosur nga Autoriteti Kontraktor në DATË OE nuk ka asnjë eksperiencë të ngjashme në vlerë (50%) dhe të gjitha objektet e paraqitura nuk e plotësojnë dyfishin e punimeve të ngjashme në tre vitet e fundit.

IV. OE “K.” Shpk nuk plotëson Pikën 2 të Kapaciteti teknik në DT: *Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

Pasi nuk disponon kategoritë:

•NP-12 A - Punime të inxhinierisë së mjedisit.

•NS-18 A - Punime topogjeodezike

V. BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, nuk plotëson Pikën 5.8 të Kapaciteti teknik në DT:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

OE “E. K.” Shpk, ka paraqitur në SPE:

Leje Qarkullimi nr. TRD00159821; Mercedes Benz, me Targa AB211CJ; Kapaciteti mbajtës 3.2 ton (7490-4290), Certifikata me nr. 10, datë 05.02.2021 “Për transport mallrash për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Ura Vajgurore, në përputhje me kërkesat.

Leje Qarkullimi nr. TRDA1122918; Mercedes Benz, me Targa AA05TM; Kapaciteti mbajtës 1.32 ton (3,500-2,180), mungon Certifikata për transport mallrash.

Kamion min 15 ton

Kamion Mercedes Benz; Targa AA149PF; Leje Qarkullimi TRDA6054716 Kapaciteti mbajtës 19.20 ton (33,0000-13,800), Certifikata me nr. 44, datë 25.03.2020 “Për transport mallrash për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Ura Vajgurore (deri më datë 25.03.2021), në përputhje me kërkesat.

Kamion Mercedes Benz; Targa AA371PN; Leje Qarkullimi TRF03981020 Kapaciteti mbajtës 26.20 ton (40,0000-13,800), Certifikata me nr. 43, datë 25.03.2020 “Për transport mallrash për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Ura Vajgurore (deri më datë 25.03.2021), në përputhje me kërkesat.

Kamion Mercedes Benz; Targa AB126AL; Leje Qarkullimi TRDA238820 Kapaciteti mbajtës 23 ton (40,0000-17,000), Certifikata me nr. 116, datë 23.06.2020 “Për transport mallrash për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Ura Vajgurore (deri më datë 23.06.2021), në përputhje me kërkesat.

OE “K.” Shpk, ka paraqitur në SPE:

Kontratë qiraje me nr. 4270 rep., nr. 1058 Kol., datë 12.08.2020, e lidhur me OE “E.B. 2005” Shpk, për Kamionin Tip; Iveco; Targa TR5963K, i mungon Leja e Qarkullimit; Certifikata me nr. 939, datë 02.07.2010 “Për transport mallrash për llogari të vet”, lëshuar nga Komuna Kashar, (deri më datë 02.07.2015).

Kontratë qiraje me nr. 4268 rep., nr. 1056 Kol., datë 12.08.2020, e lidhur me z. K.B., për Kamionin (deri në 3.5 ton) Marka Kama; Targa TR9804S, Leja e Qarkullimit TRF4314219; Polica e sigurimit të mjetit ka përfunduar më datë 10.10.2020. Kapaciteti ngritës 1 ton (2,475-1480). Mjeti nuk ka Certifikata me për transport mallrash.

VI. OE “K.” Shpk, referuar listëpagesave të paraqitura dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar ka:

Janar 2020 18 punonjës, Shkurt 14; Mars 13, Prill 14; Maj 16; Qeshor 20 (M.P. – 5414.02 - Roje) Korrik 20; Gusht 21 (B.Q. – 2143.03-Ing. Mjedisi filluar në qeshor); Shtator 20; Tetor 22; Nëntor 22; Dhjetor 21. (221/12= **18.42**)

1. E. B.– Detyra/Funksioni 2151.01 – Ing. Elektrik
2. A. M.– Detyra/Funksioni 2142.07 – Ing. Ndërtesash
3. Gj.M. – 9312.06 – Punëtor krahu ndërtimi
4. B.Ç. – 2142.29 – Ing. Zbatim në ndërtim
5. A.A.– 2142.29 – Ing. Zbatim në ndërtim
6. A.G. – 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
7. K. V. – 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
8. M.S.– 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
9. Gj. Z. — 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
10. P.D.— 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
11. M. N. – 2142.29 - Ing. Zbatim në ndërtim
12. O.H. – 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
13. K.Sh. – 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
14. A. C.– 2142.29 - Ing. Zbatim në ndërtim
15. A. D.– 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
16. Q. S. – 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
- 17.S. F.– 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi
18. M.Gj. – 9312.06 - Punëtor krahu ndërtimi

Sa më sipër nuk dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij drejtues teknik dhe punonjës me profesionet e kërkuara në DATË

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DATË KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: znj. E. H. , në cilësinë e Kryetares së KVO, z. F. H. dhe z. B. Y. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. Gj. G..

Lidhur me nënkontraktorin OE “A. G. ” Shpk, referuar listëpagesave të paraqitura dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar

OE. “A. G.” Shpk; Janar 24 punonjës: Shkurt 22; Mars 27, Prill 44; Maj 44; Qeshor 28; Korrik 37; Gusht 29; Shtator 29; Tetor 35; Nëntor 19; Dhjetor 20; (**385/12=29.83**)

1. H. B. – 5230.07 – Arkëtare zyre
2. M. Sh. – 8332.06 - Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)
3. E. D. – 3333.04 - Specialist i shërbimeve të punësimit
4. K. H.– 2144.04 – Ing. Mekanik

5. J. Ç. – 2631.13 - Ekonomist
6. T. S.– 2142.12 - Inxhinier për ndërtesa dhe punime publike
7. S. Ç. – 2142.23 - Inxhinier për ndërtimin e urave
8. A. D.– 2161.01 - Arkitekt ndërtesash
9. A. Sh. – 1120.28 - Administrator
10. A. C. – 1321.06 - Kryeinxhinier
11. T. V.– 2114.12 - Inxhinier gjeolog
12. E. S.– 2114.01 - Gjeodet
13. D. L.– 2142.05 - Inxhinier mjedisi/drejtim energjetikë
14. O S.– 2152.07 - Inxhinier elektronik
15. Sh. M.– 9622.01 - Punëtor krahu
16. D. S. -7126.03 - Teknik i impiantit të ngrohjes së ujit në lokomotive
17. K. V.– 2142.21 - Inxhinier për ndërtimin e skeleteve të ndërtesave
18. A. B.– 1120.28 - Administrator
19. J. H.– 5414.02 - Roje
20. K. K. – 1221.03 - Drejtor i marketingut
21. D. B. – 2151.01 - Inxhinier elektrik
22. S. M. – 9622.01 - Punëtor krahu
23. M. T. – 4321.01 - Magazinier
24. H. H. – 2142.29 - Inxhinier zbatimi në ndërtim
25. M. Sh. – 5230.03 - Arkëtar magazine

Pranimi i nënkontraktimit të **OE. “A. G.” Shpk**, (me 40% të vlerës së kontratës) është në kundërshtim me:

a. Pikën 42.2 të Neni 42 “Nënkontraktimi” në DT që përcakton: *“Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë”*.

b. Nenin 37, pika 3/a e VKM-së 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “3. Autoriteti kontraktor, përveç kritereve të përcaktuara në LPP, për përjashtimin e kandidatëve ose të ofertuesve duhet të ketë parasysht edhe: a) konfliktin ndërmjet veprimtarive të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve ose shërbimeve. Në këtë rast, operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për mallra, punë ose shërbime për një projekt dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës që lidhen me këto mallra, punë ose shërbime. Nga ana tjetër, konsulenti i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen ose zbatimin e një projekti dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga furnizimi i mallrave, kryerja e punëve ose shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës) që rrjedhin ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për këtë përgatitje ose zbatim”.

c. Pikën 5 e 6 të nenit 75 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar: “5. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë. 6. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori të kritereve të kërkuara, autoriteti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues”.

d. Nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. “*Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.*

Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”.

Personat e angazhuar në procesin e prokurimit dhe ekzekutimin e kontratës nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Situata për konfliktin e interesit vlerësohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në kuptim të këtij ligji mbulon çdo situatë ku titullari ose punonjës të autoritetit ose entit kontraktor ose ofruesit të shërbimit të prokurimit, që vepron në emër të autoritetit ose entit kontraktor, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit, ose mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal, që mund të cwnojë paanësinë dhe pavarësinë e tyre në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, pranimit i nënkontraktimit të OE që është në konflikt interesi dhe nuk zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës që do realizojë, ngarkon me përgjegjësi: anëtarët e KVO dhe Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Ndikimi: Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT, e pranimit i nënkontraktimit të OE “A. G.” Shpk, që është në konflikt interesi dhe nuk plotëson kriteret e DT,, ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **410,174,927 lekë lekë pa Tvsh.**

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP, në kualifikimin/skualifikimi OE/BOE pjesëmarrës në prokurim, dhe pranimit/mospranimin e nënkontraktimit që plotëson/s’plotëson kriteret e DATË

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, pranimit i nënkontraktimit të OE “A. G.” Shpk, është në konflikt interesi dhe nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DATË KVO duhet të kishite propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: znj. E. H. , në cilësinë e Kryetares së KVO, z. F. H. dhe z. B. Y. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. Gj. G..

2- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Rikonstruksioni segmentit Rrugor “Bylysh –Vagalat – Marica j- Arrëz e Madhe - Lamaj-Qafa e Kicokut” faza e II”, Bashkia Memaliaj, viti 2021.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni segmentit Rrugor “Bylysh-Vagalat-Maricaj-Arrez e Madhe-Lamaj-Qafa e Kicokut” faza e II”, Bashkia Memaliaj, viti 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 19 datë 17.02.2021	2. Njësia e Prokurimit: 1. E. Sh. (Jurist) 2. V. K. (Ing, Ndërtimi) 3. Sh. D. (Ekonomist)	3. Komision i Vlerësimit të Ofertave-Urdhër nr. 21, datë 17.02.2021: 1. K. R. (Kryetar) 2. A. Xh. (Anëtare) 3. E. T. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”		
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 19,166,000 lekë	6. Oferta fituese: OE “C. R. 8” Shpk, vlera e ofertës 9,990,400 lekë pa Tvsh	7. Diferenca me fondin limit 9,175,600 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 23.03.2021	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. OE “C. R. 8” Shpk 2. OE “N. ” Shpk 3. OE “G. K. M” Shpk 4. OE “A. ” Shpk 5. OE “K. ” Shpk 6. OE “B. ” Shpk 7. OE “E. C. Co” Shpk 8. OE “B. B” Shpk 9. OE “L..C.” Shpk 10. OE “Z. ” Shpk
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata nr. 13/19 prot., datë 19.05.2021		
14. Lidhja e kontratës 19.05.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	11,988,480

Numri i referencës: **REF-87438-02-17-2021**

Fondi limit: **19,166,000** (nëntëmbëdhjetë milion e njëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa Tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës: **90 ditë** nga lidhja e kontratës.

Në zbatim të nenit 12, pika 5, kreu II të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndrvshuar dhe në nenin 57. pika 2. Kreu VII të VKM nr. 914, datë.29. 12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. VKB nr. 72, datë 02.12.2019 “Për miratimin e aktit të themelimit të Ndërmarrjes së shërbimeve të shkollave. rugëve rurale, gjelbërimit. ndriçimit dhe varrezave publike” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1713/1 Prot., datë 16.12.2019 dhe VKB nr. 61 datë 24.12.2020Për miratimin e buxhetit për vitin 2021" konfirmuar ligjshmëria nga prefekti i qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1259/1 prot., datë 08.01.2021, protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr 58 prot, datë 13.01.2021.

Me Urdhrin nr. 19 prot.,datë 17.02.2021, Titullari i AK z. F. H. ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit të përbërë nga z. E. Sh., znj. V. K. dhe z. Sh. D. për kryerjen e prokurimit.

Projekti është realizuar nga “” Shpk

Me Urdhrin nr. 20 prot.,datë 17.02.2021, “Për përllogaritjen e fondit limit”, Titullari i AK z. F. H. ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit, të formulojë procesverbalet përkatëse, në bazë të: Fondit limit, projektit, preventivit e specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK.

Me procesverbalin nr. 13/2 prot., datë 17.02.2021 NJP, mbështetur në dokumentacionin: (preventivi, relacioni Teknik, specifikime teknike) që janë pjesë e objektit të sipërcituar të punimeve që do të realizohen për këtë investim për vitin 2021, dorëzuar nga Drejtoria e Shërbimeve. Për këtë objekt është punuar sipas manualit të çmimeve të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimine manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

- Fondi limit është përllogaritur 19,160,000 (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh, referuar VKB nr. 60 datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021”, konfirmuar nga prefekti i qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1259/1 prot., datë 08.01.2021 protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr.58 prot, datë 13.01.2021

Në dosjen e prokurimit gjendet me nr. 13/3 prot., datë 17.02.2021 “Rekomandimi për përzgjedhjen e llojit të procedurës” (Kërkesë për propozim), që Titullari i AK i drejton NJP. Me Urdhrin nr. 04, e nr. 13/4 prot., datë 17.02.2021, Titullari i AK z. F. H. ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit të realizojë prokurimin ku lloji i procedurës së prokurimit të jetë “E Hapur”. Me Urdhrin nr. 21, e nr. 13/5 prot., datë 17.02.2021, për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje: z. K. R. (Kryetare), z. A. Xh. e z. E. T. . Njësia e Prokurimit ka formuluar/nënshkruar procesverbalin nr. 13/6 prot., datë 17.02.2021 “Për përcaktimin e kritereve të kualifikimit dhe ato të vlerësimit në DT”. Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar, është botuar në Buletinin nr. 26, datë 22 Shkurt 2021, në faqet 26-27/473.

Titulli i gjetjes 29: Titullari i AK, për realizimin e procedurës së prokurimit nuk ka bërë një ndarje të qartë të detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin prokurimit publik, Dokumentat e tenderit nuk janë nënshkruar në të gjitha faqe nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, mungonjë deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit nga KVO.

Situata: Titullari i AK, për realizimin e procedurës së prokurimit nuk ka bërë një ndarje të qartë të detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin prokurimit publik, veprim në kundërshtim me nenit 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në dosje e procedurës së prokurimit mungonjë deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit nga KVO, veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 64 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Dokumentat e tenderit nuk janë nënshkruar në të gjitha faqe nga anëtarët e Njesisë së prokurimit.

Neni 56 Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar

Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrin të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Neni 61 Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit

2. Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Dokumentet e tenderit nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

Neni 64 Hapja e ofertave

2. Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e legjislacionit në fuqi nga titullari i AK, në ndarjen e detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin prokurimit publik, NJ në nënshkrimin e DT dhe KVO në formulimin/nënshkrimin e deklaratave e mospasjes së konfliktit të interesit. deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit.

Ndikimi: Nuk është siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. DT nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit e nuk janë zbatuar *Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi* .

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Titullari AK, Ndërmarrja e Shërbimit, Bashkia Memaliaj, të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, Njësia e Prokurimit të nënshkruajë DT, dhe KVO të marrin masa që përpara fillimit të procedurës së vlerësimit të nënshkruajë deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit.

Ndryshimet në DT:

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 01.03.2021, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Rikonstruksioni segmentit Rrugor “Bylysh-Vagalat-Maricaj-Arrez e Madhe-Lamaj-Qafa e Kicokut” faza e II”, me fond limit **19.166,000 lekë pa Tvsh**, autoritetit kontraktor **Drejtoria e Shërbimit Memaliaj në lidhje me procedurën me REF-87438-02-17-2021**, në lidhje me disa konstatime në DATË.

Me nr. 13/7 prot., datë 04.03.2021 “Rekomandim për pezullim”, Titullar i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës me qëllim ndryshimin e DT, sipas rekomandimeve të APP.

Me Urdhërin nr. 27 e nr. 13/9 prot., datë 05.03.2021 Titullar i AK ka hequr pezullimin e procedurës e ngarkuar Njësinë e Prokurimit për zbatimin e vazhimit të procedurës.

Ishte:	Bëhet:
3. Licensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: <ul style="list-style-type: none">NP-4A, NP-12A sipas modelit të MPPT/MTI/MIE etj.	3. Licensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: <ul style="list-style-type: none">NP-4A sipas modelit të MPPT/MTI/MIE etj....
Në pikën 2.3.6. Një punësim mesatar i të paktën 50 (pesedhjetë) personave përfshirë në stafin inxhinjero – teknik, shoferët, manovratorët referuar grafikut të punimeve të dërguar nga firma projektuese për periudhën Qershor – Dhjetor 2020” të vërtetuar me: Listpagesat e punonjësve shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore për periudhën sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor – Dhjetor 2020.	Në pikën 2.3.6. Një punësim mesatar i të paktën 50 (pesedhjetë) personave për periudhën Qershor – Dhjetor 2020” të vërtetuar me: Listpagesat e punonjësve shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore për periudhën sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor – Dhjetor 2020.
2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar: 2.2 a. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre 3 viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018.2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.	2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar: 2.2 a. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre 3 viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018.2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave.
5.1 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të përfshirë në listpagesa për Qershor – Dhjetor 2020 <ul style="list-style-type: none">Inxhinier Ndërtimi (2) dy	5.1 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune të përfshirë në listpagesa për Qershor – Dhjetor 2020. <ul style="list-style-type: none">Inxhinier Ndërtimi (1) një Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë Inxhinier Ndërtimi (1) një të punësuar ose me kontratë pune.
Afati kohor për pranimin e ofertave dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	
Ishte 23.03.2021 Ora: 13:00	Bëhet 29.03.2021 ora 11.00.

-Zhvillimi i procedurës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresat nr. 13/10 prot., e nr. 13/11 prot., datë 07.04.2021 “Mbi ofertën anomalisht të ulët” i është **drejtuar respektivisht** OE “C. R. 8” Shpk e “N. ” Shpk, pasi është konstatuar që oferta është anomalisht e ulët. Në zbatim të Ligjit nr.

9643 datë 20.11.2006. neni 56. Oferta anomalisht të ulëta. VKM nr.914. date 29.12.2014. Kreu VII, Neni 66 pika 5 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave si dhe të dokumentave të tenderit. Oferta anomalisht të ulëta, është kërkuar të paraqisn me shkrim sqarime e detaje mbi oferten e paraqitur duke përfshirë elementet e çmimit dhe përlllogaritje të detjuar të tij.

OE “C. R. 8”

OE Shpk e “N. ” Shpk, me shkresën “Argumentim i ofertës”, datë 08.04.2021 (me nr. 13/13 prot., datë 12.04.2021, në Drejtorinë e Shërbimit), ka sqaruar ofertën e paraqitur në procedurë. Me nr. 13/14 prot., datë 19.04.2021, procesverbali për hapjes dhe vlerësimin e ofertve për procedurës së prokurimit, ku është konstatuar që në këtë procedurë kanë marrë pjesë 10 (dhjetë) OE me vlerë ekonomike të ofruara:

1. OE “C. R. 8” Shpk, (me Nipt K.....V) me vlerë ekonomike të ofertës **9,990,400** (*nëntë milion e nëntëqindë e nëntëdhjetë mijë e katërqind*) **lekë pa Tvsh.**

2. OE “N. ” Shpk, (me Nipt J.....U) me vlerë ekonomike të ofertës **11,239,200** (*njëmbëdhjetë milion e ndyqindë e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind*) **lekë pa Tvsh.**

3. OE “G. K. M” Shpk, (me Nipt L.....T) me vlerë ekonomike të ofertës **11,863,600** (*njëmbëdhjetë milion e tetëqindë e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind*) **lekë pa Tvsh.**

4. OE “A. ” Shpk, (me Nipt J.....O) me vlerë ekonomike të ofertës **12,363,120** (*dymbëdhjetë milion e treqindë e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzetë*) **lekë pa Tvsh.**

5. OE “K. ” Shpk, (me Nipt L.....E) me vlerë ekonomike të ofertës **13,362,160** (*trembëdhjetë milion e treqindë e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**

6. OE “B. ” Shpk, (me Nipt J.....V) me vlerë ekonomike të ofertës **14,361,200** (*katërmëdhjetë milion e treqindë e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind*) **lekë pa Tvsh.**

7. OE “E. C. Co” Shpk, (me Nipt K.....K) me vlerë ekonomike të ofertës **14,985,600** (*katërmëdhjetë milion e nëntëqindë e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind*) **lekë pa Tvsh.**

8. OE “B. B. ” Shpk, (me Nipt K.....H) me vlerë ekonomike të ofertës **17,483,200** (*shtatëmbëdhjetë milion e katërqindë e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind*) **lekë pa Tvsh.**

9. OE “L.T.E Co.” Shpk, (me Nipt K.....D) me vlerë ekonomike të ofertës **17,608,080** (*shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqindë e tetë mijë e tetëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**

10. OE “Z. ” Shpk, (me Nipt J.....K) me vlerë ekonomike të ofertës **141,907,200** (*njëqindë e dyzetë e një milion e nëntëqindë e shtatë mijë e dyqind*) **lekë pa Tvsh.**

Me shkresën nr. 13/15 prot., datë 30.04.2021, është formuluar/nënshkruar “Raporti Përmbledhës” nga KVO, miratuar me shkresën 13/16 prot., datë 30.04.2021 nga Titullari i AK.

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. OE “Z. ” Shpk, pasi ka paraqitur ofertë ekonomike me të lartë se fondi limit i prokuruar. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.04.2021, botuar në Buletinin e APP nr. 70 datë 10 Maj 2021, në faqet 62-63/313.

Raporti Përmbledhës me nr. 13/15 prot., datë 30.04.2021, formuluar/nënshkruar nga KVO dhe miratuar nga titullari i autoritetit Kontraktor z. F.H.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 13/19 prot., datë 19.05.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Memaliaj, të përfaqësuar nga z. F. H. (Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve) dhe OE “C. R. 8” Shpk me përfaqësues ligjor z. A. K. (me prokurë të posaçme z. G. Gj.), me objekt: “Rikonstruksioni segmentit Rrugor “Bylysh-Vagalat-Maricaj-Arrëz e Madhe-Lamaj-Qafa e Kicokut” faza e II”, në përputhje me projektzbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **11,988,480** (*njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqindë e tetëdhjetë*) **lekë me Tvsh.**

Kontrata për shërbime (mbikqyrje punimesh) me nr. 13/17 prot., datë 30.04.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Memaliaj, të përfaqësuar nga z. F. H. (Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve) dhe OE “S. P. P. S. M. A.” Shpk me përfaqësues ligjor

z. I. D.Vlera e kontratës është **196,071** (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë e shtatëdhjetë e një) lekë me Tvsh.

3. - Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje makine vetëshkarkuese, për nevojat e Drejtorisë së Shërbimit Memaliaj”, viti 2021.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje makine vetëshkarkuese, për nevojat e Drejtorisë së Shërbimit Memaliaj”, Viti 2021.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 22, datë 13.12.2021	3. Njësia e Prokurimit. Urdhër nr. 108 datë. 13.12.2021 Emër mbiemër (profesioni) 1. E. Sh. (jurist) 2. B. H. (inxhinieri) 3. E. L. (ekonomist)	4. KVO Urdhër nr.110 datë 13.12.2021 Emër mbiemër (profesioni) 1. A. Xh. (Ekonomist) 2. J. T.(Arkitekt) 3. L. K. (Inxhinier)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: e hapur e thjeshtuar		
5. Fondi Limit (pa tvsh): 3,500,000	6. Oferta fituese (pa tvsh): 3,462,000	7. Diferenca me fondin limit: 38,000
8. Data e hapjes së tenderit : 28.12.2021 ora 10:00	9. Burimi Financimit: Drejtoria e Shërbimit	10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës: 1
11. Ankimime AK : jo	12. Përgjigje Ankesës nga AK: jo	13. Përgjigje KPP : jo
b. Kontrata : nr. 102/12 datë 09.02.2022		
14. Lidhja e kontratës : 09.02.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	4,154,400

Numri i referencës: **REF-15320-12-15-2021**

Fondi limit: **3,500,000** (tre milion e pesëqindë mijë) lekë pa Tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës: **15 ditë** nga lidhja e kontratës.

Në zbatim të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 kreu IX neni 74 pika 1, VKB nr. 72, datë 02.12.2019 “Për miratimin e aktit të themelimit të “Ndërmarrjes së shërbimeve të shkollave, rrugëve rurale, gjelbërimit, ndriçimit dhe varrezave publike” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 677/1 prot., datë 12.12.2019 dhe vendimit nr. 61, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021” konfirmuar nga prefekti Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 677/1 prot., datë 02.08.2021, (Me Urdhrin nr. 108 e nr. 102 prot., datë 13.12.2021, Titullari i AK z. F. H. ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit të përbërë nga z. E. Sh., z. B. H. dhe z. E. L. për kryerjen e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 109 e 102/1 prot., datë 13.12.2021, “Për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike”, Titullari i AK z. F. H. ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit, të formulojë procesverbalet përkatëse, në bazë të: Fondit limit e specifikimet teknike të përcaktuara nga AK. Me procesverbalin nr. 102/2 prot., datë 13.12.2022 NJP, mbështetur në dokumentacionin: (preventivi, relacioni teknik) që janë pjesë e objektit të sipërcituar për “blerje makine” të parashikuar për investim në vitin 2021.

- Fondi limit është përlogaritur 3,500,000 (tre milion e pesëqindë mijë) lekë pa Tvsh, në zbatim të VKB nr. 61, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021” konfirmuar ligjshmëria nga prefekti Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 677/1, datë 02.08.2021, blerja është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të Drejtorisë së Shërbimit, për gjashëmujorin e II të viti 2021.

Njësia e Prokurimit ka formuluar/nënshkruar procesverbalin nr. 102/4 prot., datë 13.12.2021 “Për përcaktimin e kritereve të kualifikimit dhe ato të vlerësimit në DT”.

Titulli i gjetjes 30: Titullari i AK, për realizimin e procedurës së prokurimit nuk ka bërë një ndarje të qartë të detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin prokurimit publik, Dokumentat e tenderit nuk janë nënshkruar në të gjitha faqe nga anëtarët e Njësies së Prokurimit, mungonjë deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit nga NJP dhe KVO.

Situata: Titullari i AK, për realizimin e procedurës së prokurimit nuk ka bërë një ndarje të qartë të detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin prokurimit publik, veprim në

kundërshtim me nenit 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga Njësia e Prokurimit dhe KVO, nuk janë nënshkruar deklarata e mospasjes të konfliktit të interesit, veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 64 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Dokumentat e tenderit nuk janë nënshkruar në të gjitha faqet nga anëtarët e Njesisë së prokurimit.

Me Urdhër nr. 19, e nr. 64/7 prot., datë 21.04.2022, për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje: z. A. Xh. (Kryetare), z. J. T. e z. L. K..

Sa më sipër bien ndesh me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: *Neni 56 “Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrave të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.*

Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Neni 61 Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit.

2. Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specifikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Dokumentet e tenderit nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njesisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato.

Neni 64 Hapja e ofertave

2. Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës”.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e legjislacionit në fuqi nga titullari i AK, në ndarjen e detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin e prokurimit publik, NJ në nënshkrimin e DT dhe KVO në formulimin/nënshkrimin e deklaratave e mospasjes së konfliktit të interesit. deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit.

Ndikimi: Nuk është siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. DT nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e njesisë së prokurimit e nuk janë zbatuar nga NJP dhe KVO, kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Titullari AK, Ndërmarrja e Shërbimit, Bashkia Memaliaj, të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, Njësia e Prokurimit të nënshkruajë DT, dhe NJP e KVO të marrin masa që përpara zhvillimit të procedurave së vlerësimit nënshkruajë deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit.

Me urdhër nr. 110 e nr. 102/6 prot., datë 13.12.2021 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. A. Xh. , z. J. T. e z. L. K..

-Zhvillimi i procedurës.

Në procesverbalin me nr. 102/7 prot., datë 05.01.2022, për hapjes dhe vlerësimin e ofertve për procedurën e prokurimit, është konstatuar që në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 (një) OE përkatësisht,

1. OE “S. & C. Co.” Shpk, (me Nipt L.....F) me vlerë ekonomike të ofertës **3,462,000 (tre milion e katërqindë e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë pa Tvsh.**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 102/12 prot., datë 09.02.2022, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Memaliaj, të përfaqësuar nga z. F. H. (Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve) dhe Operatorit Ekonomik “S. & C. Co.” Shpk me përfaqësues ligjor z. V. Sh. (me prokurë të posaçme znj. E. Sh.), me objekt: “Rikonstruksioni segmentit Rrugor “Makinë vetëshkarkuese, për nevojat e Drejtorisë së Shërbimit Memaliaj, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **4,154,400 (katër milion e njëqindë e e pesëdhjetë e katër mijë e katërqindë) lekë me Tvsh.**

Në dosje gjendet me nr. 1005/5 prot., datë 11.02.2022 Akt Marrëveshja (Për punë individuale me kohë të pjesshme) Kontrata për shërbime (mbikqyrje punimesh) lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Memaliaj, të përfaqësuar nga z. F. H. (Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve) dhe z. I. M., antarë i grupit të marrjes në dorëzim të mjetit të prokuruar.

Me urdhërin nr. 04 e nr. 102/16 prot., datë 11.02.2022, është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të kamionit, i përbërë nga: z. B. H. (Kryetar), z. J. T., z. Xh. M., z. A. B. e z. I. M..

Komisioni i Marrjes në Dorëzim me nr. 102/17 prot., datë 15.02.2022, ka marrë në dorëzim automjetin Man, me targa AB715FJ në prani të magazinieres znj. E. H..

2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

1. Zbatimi i punimeve në objektin: *Ndërtimi i Ujësjiellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj*, Bashkia Memaliaj, viti 2021.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 49/29 prot., datë 09.06.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Memaliaj, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Gj. G. dhe BOE “**K.**” Shpk me përfaqësues z. A. M., me licencë profesionale NZ. 8051, datë 03.07.2020, dhe “**E. K.**” Shpk me përfaqësues z. A. I., me licencë profesionale NZ 4981/13, datë 26.10.2020. Vlera e kontratës është **487,378,589 (katërqindë e tetëdhjetë e shtatë milionë e treqindë e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqindë tetëdhjetë e nëntë) lekë me Tvsh.**

Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 24 Muaj ditë kalendarike nga dorëzimi isheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 29/16 prot, datë 02.04.2021, është lidhur kontrata me OE “**Xh & M.**” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1322/7, datë 25.01.2021, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 4,784,887.20 lekë me Tvsh.

Projektpreventivi

Projektpreventivi është hartuar nga OE “A. G.” Shpk me licencë profesionale në projektim NZ. 6954, datë 04.12.2019.

Referuar kontratës së dhurimit të Studim-projektimit nr. 43/1 dhe nr. 659/1, datë 21.05.2020 ndërmjet OE “A. G.” Shpk dhe Bashkisë Memaliaj, si dhe në vijim të: Shkresës nr. 790 prot., datë 27.05.2021 “Dërgim shkresë; shkresës nr. 516 prot., datë 01.04.2021 “Dërgim relacioni dhe plotësim të rekomandimeve të oponencës teknike; shkresës nr. 868/2 prot., datë

30.06.2021. Dërgim shkresë mbi problematikat e projektit të ujësjellësit”; Shkresës nr. 1012/8 prot., datë 04.10.2021 “Takim për informacion”, realizimit të takimit të datës 10.10.2021 në ambientet e Bashkisë Memaliaj me përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesuara, për objektin: “Ndërtimin e Ujësjellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës si dhe Qytetin Memaliaj”, po ju dërgojmë materialin e projektit të rishikuar të plotë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur në qeshor të 2021, dhe më datë 12.11.2021 janë pezulluar.

Nga Bashkia Memaliaj është dhënë Leja Infrastrukturës nr. 1, datë 26.04.2021, pas shqyrtimit të aplikimit për “Leje infrastrukture për objektin: “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, dorëzuar elektronikisht më datë 19.03.2021, numër aplikimi AN1903202 10 129, nr. 442 prot., datë 23.03.2021, Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Njësia Administrative Qesarat, Njësia Administrative Krahës dhe Bashkia Memaliaj, dhe dokumentacionit shoqërues.

Leja është dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullësor”, ligjit nr. 10253, datë 11.03.2010 “Për gjuetinë”, ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër” si dhe të ligjit nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, sa më sipër referuar neneve 27 e 29 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Memaliaj, z. Gj. G..

Në dosje gjendet me nr. 516 prot., datë 01.04.2021 “Dërgim relacioni dhe plotësim të rekomandimeve të oponencës teknike” që bashkia i ka dërguar OE “A. G.” Shpk.

Specialistët e sektorit të monitorimit të Administratës Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastër, kanë konstatuar në datën 12.11.2021 se subjekti “Bashkia Memaliaj” zhvillon aktivitetin ndërtim të ujësjellësit rajonal për fshatrat Vasjar, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe qytetin Memaliaj, me vendodhje, bashkia Memaliaj, qarku Gjirokastër.

Sipas planvendosjes dhe koordinatave të gjeoreferuara, rezulton se projekti prek në Monumentin e Natyrës “Mogilat e Vasjarit”, shpallur me VKM nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumentave të natyrës Shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura, si dhe në Parkun Natyror Lumi Vjosë”, shpallur me Vendim të KKT- së nr. 10, datë 28. 12 2020.

Me nr. 1012 prot., datë 01.07.2021 “Njoftim për fillim e punimesh”, nga BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk

Me nr. 1012/1 prot., datë 01.07.2021 “Akt dorëzimi sheshi i ndërtimit”

Me nr. 1012/2 prot., datë 01.07.2021, “Njoftim fillim punimesh mbikqyrësi”

Me nr. 1012/3 prot., datë 01.07.2021, “Procesverbal mbi akt piketmin në objekt”

Me nr. 1012/4 prot., datë 01.07.2021, “Procesverbal mbi fillimin punimesh”

Urdhër nr. 79 e nr. 1012/5 prot., datë 06.07.2021 “Për monitorimin e zbatimit të kontratës”.

Konstatohet që nuk është vepruar në zbatim të:

Pikat 4, 5, 6 e 14 të Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Pikat 3, 3.1, 3.3, 3.4, 7 (7.1, 7.2 e 7.3) 9.1, 11 (11.1 e 11.2) të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

Me nr. 1057 prot., datë 12.07.2021 “Kthim përgjigje për kërkesën për informacion mbi ecurinë e zbatimit të projekteve të parashikuara në buxhetin 2021 drejtuar AKUM-it”.

Me nr. 1012/6 prot., datë 17.09.2021, Kërkesë për miratimin e projektit të rishikuar nga Mbikqyrësi i Punimeve”.

Me nr. 1012/3 prot., datë 01.07.2021, “Dërgim dokumentacioni nga Bashkia drejtuar Mbikqyrësit të Punimeve”.

Me nr. 1012/13 prot., datë 15.10.2021, projektuesi ka dërguar projektin e rishikuar dhe sygjërimet për ndryshimet në projekt.

Në mënyrë të përmbledhur rishikimet dhe sugjerimet sa më poshtë vijon:

1- Mënyra e kapjes së ujit, nga kaptash në formë rrethore në kaptash në formë drejtkëndore gjatësore, për shkak të daljes së ujit kryesisht horizontalisht.

2- Zmadhimi i tubit të dërgimit nga seksion 300 mm në 1000 mm për shkak të prurjes të burimit rreth 3 herë më të madhe se parashikimi. Ky zgjerimi i tubi të dërgimit është që të kapë/marrë/dërgojë të gjithë ujin e burimit, në pusin e grumbullimit, pa ja bllokuar rrjedhjen (për shkak se në rast të bllokimit qoftë sadopak rezikon që uji të prishë regjimin 70 vjeçar dhe të krijoj në akuafer të ri dhe sasia e ujit të largohet plotësisht). E gjithë teprica e ujit të burimit të mund të shkarkohet në kuotën fundore rreth 400 ml larg burimit.

3- Rishikimi i pusit të grumbullimit zmadhohet 3 herë nga 25 mbi 75 l/s.

4- Për garantimin e veprës së marrjes nga vërshimet e furishmet të Vjosës (të cilat ndodhin pothuajse çdo vit) është rishikuar që kaptazhi dhe pusi i grumbullimit të mbrohen natyralisht, i pari në thellësinë e shtratit dhe i dyti në thellësinë e skarpatës, gjithashtu tubii dërgimit dhe i shkarkimit do të fiksohen/qepen me mikropilota në thellësi deri në 15m.

5- Furnizimi me ujë në projektin e miratuar është vetëm për pirje (5 l/s). Megenëse burimi rezulton pas gëmimeve me prurje më të madhe projekti i miratuar është rishikuar jo vetëm për pirje, por për h/sanitare, bagëtitë, lokalet, restorantet, etj.

6- Projekti i miratuar nga 5 l/s rishikohet në 25 l/s dhe si rrjedhojë tubacionet e çelikut rriten me 3 herë, rrjedhimisht dhe tonazhi rritet me rreth 3 herë.

7- Është rishikuar pozicionimi i depos kryesore shpërndarëse për të shmangur 5 stacione pompimi dhe për të menaxhuar me lehtë funksionimin optimal të këtij ujësjellësi.

8- Rritja e tubacionit të dërgimit për shkak të rritjes së sasisë së ujit duke plotësuar normat.

9- Janë rishikuar intersektimet të cilat do të bëhen sipas njërit prej varianteve të propozuar më pare (por të pa miratuar aktualisht), sipas sugjerimeve të ARRSH, me shpime horizontale me sondë.

10- Është rishikuar sistemi i klorifikimit i cili ishte parashikuar në projektin fillestar por për shkak të fondeve, nuk ishte i përfshirë në preventivin e punimeve të miratuar.

11- Rishikimi i projektit jep garanci meqenëse gjatë monitorimit të vitit 2021, si viti më i thatë i 70 viteve të fundit, rezulton që prurja minimale është rreth 200 l/s, nga 75 l/s (25 l/s për fshatrat dhe 50 l/s për qytetin) që nevojitet për të plotësuar normat e fshatrave dhe qytetit Memaliaj.

Gjithashtu linja Vasjar - Q. Memaliaj rishikohet për këto arsye:

a- Nuk është rentabël për shkak se ishte linjë rezervë.

b- Energjia që konsumohet për ngritjen mekanike nga Gallatica në Vasjar është 50% më e madhe sesa ngritja e STP Bambull në Depon Memaliaj.

c- STP Bambull, nga informacionet zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), mediat, etj., është përmirësuar me pompa të reja dhe është implementuar programi i investimit të sistemeve të efikasitetit të energjisë.

d- Në rast të shkatërrimit të STP Bambull për shkaqe natyrore (forcave madhore) dhe daljes totalisht jashtë funksionit në mënyrë të pariparueshme, projekti i rishikuar garanton marrjen e sasisë së ujit të nevojshëm për qytet Memaliaj nga pusi i grumbullimit të burimit të Gallaticës.

Me shkresën me nr. 1012/8 prot., datë 04.10.2021 me lëndë: “Takim për informacion”, titullari i AK i është drejtuar: OE “K.” Shpk, OE “A. G.” Shpk (projektues dhe nënkontraktir), OE “XH & M.” Shpk (mbikqyrësit të punimeve), grupit të monitorimit “Ujësjellës-Kanalizime” Sha, Memaliaj për të dëgjuar problematikën e objektit: “Ndërtimi i Ujësjellësit

Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe qyteti Memaliaj”.

Prezent në këtë takim janë: Kryetari i Bashkisë Memaliaj Z. Gj. G., drejtuesi ligjor i OE “K.” Shpk Z. A. M., drejtues ligjor i OE “XH.” Shpk Znj. Xh.D., inxhinierja hidrogjeologe Znj. R. M., kryeinxhinieri i OE “A. G.” Shpk, Z. A. C., inxhinieri hidrolog Z. A. K., juristja e zyrës juridike të Bashkisë Memaliaj Znj. Xh.K., përgjegjësja e zyrës së urbanistikës në Bashkinë Memaliaj Znj. V. K..

Në Bashkinë Memaliaj me nr. 212 prot., datën 15.11.2021 (nr .1695 prot., datë 17.11.2021 në bashki) nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastër ku në procesverbal me datë 12.11.2021 është kërkuar ndërprerjen e punimeve deri në pajisjen me leje nga Zonat e Mbrojtura.

Konstatohet që nuk ka asnjë korespondencë zyrtare ndërmjet mbikyrësit të punimeve dhe Autoritetit Kontraktor Bashkisë Memaliaj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Znj. Xh. D. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Titulli i Gjetjes 31: *Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” u konstatua se nuk janë marrë miratimet nga institucionet që përfshihen në dhënien e mendimit.*

Situata: Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat e mëposhtme:

-Leje ndërtimi me nr. 1, datë 18.10.2022 i jepet: zhvilluesit: K.projektuesi i këtij zhvilluesime të dhënat e mëposhtme: M.A.K S., Leja e ndërtimit për objektin: Ndërtimi i muritmbajtës prej guri h-3m, sistemime të ambientit, mbushje nivelime mbjellje me bar hapsirat e gjelbërta si dhe ndërtimi i një muri kufizues në pjesën fundore të karburantit “M. O.”, Memaliaj me nr. pasurie 1/136 s=996m², adresa e realizimit të punimeve, Bashkia Memaliaj.

-Leje ndërtimi me nr. 5, datë 08.07.2021 i jepet: A. R. zhvilluesit: A. R. aplikues i regjistruar si subjekt me të dhënat e më poshtme: P. D., Leja e ndërtimit për objektin: Banese një familjare 1kat mbi toke dhe 1kat nën toke, adresa e realizimit të punimeve, Bashkia Memaliaj.

Nuk është marrë mendim pozitiv nga AZHT.

Kriteri: Pika 1 nëshkronjën “ë” në nenin 15 të VKM-sënr. 408 datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ku citohet: *Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;*

Ndikimi: Miratimi i lejeve të ndërtimit pa marrë mendim pozitiv nga institucionet e përfshira mund të çojë në vendim jo të drejtë për këto leje.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Memaliaj.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa marrë në konsideratë mendimet pozitive nga institucionet e nevojshme.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi: z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj; znj. V. K., me pozicion përgjegjëse e sektorit Zhvillimit Urban dhe Kadastrës.

Titulli i Gjetjes 32: *Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” u konstatua se, nuk është bërë ndryshimi i statusit të pronës nga arë në truall.*

Situata: Nga kontrolli në sistemin e-Leje konstatohet se, leja e zhvillimit me nr. 8, datë 23.07.2021 është miratuar para lejes së ndërtimit me nr. 7, datë 06.10.2021 i jepet zhvilluesit M. D., i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: G. M., leja e ndërtimit për objekt:

Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore, adresa e realizimit të punimeve, Bashkia Memaliaj.

Kriteri: Shkronja “a” dhe shkronja “b” në pikën 1 të nenit 15 në VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ku citohet: *Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimisi dhe Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;*

Ndikimi: Miratimi i lejes së ndërtimit pa ndryshuar statusin e tokës ndikon në miratim të gabuar të lejes pasi në atë zonë me atë status nuk lejohet të jepet leje për ndërtim.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Memaliaj.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të kërkuar ndryshim të statusit të tokës duke e rregjistruar me status truall për të vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi: z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj; znj. V. K., me pozicion përgjegjëse e sektorit Zhvillimit Urban dhe Kadastrës.

Titulli i Gjetjes 33: *Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” u konstatua se nuk është respektuar distanca e objektit nga kufiri i pronës.*

Situata: Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” për lejen e ndërtimit me të dhënat:

Leja e ndërtimit me nr. 4, datë 24.06.2021, dhënë subjektit ndërtues zhvilluesit R. L.dhe H. L.. Aplikuesi i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: “G. M.”, Leja e ndërtimit për objektin: Banese, adresa e realizimit të punimeve: Batalioni Rinia 02170009; nd.31; h.1; në Njësinë Administrative Krahës Zhulaj, 6307, Bashkia Memaliaj.

Kriteri: Neni 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”i VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ku citohet: *Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus $1m$ ($d = nr. k + 1m$) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe $nr. k$ - numri i kateve”.*

Ndikimi: Mosrespektimi i distancave të lejuara nga kufiri i pronës ndikon në pronat kufitare dhe kequrbanizimin e zonave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Memaliaj.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi me objekte të cilat nuk respektojnë distancat e lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj; znj. V. K., me pozicion përgjegjëse e sektorit Zhvillimit Urban dhe Kadastrës.

2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit.

Titulli i Gjetjes 34: *Në Bashkinë Memaliaj nuk është krijuar struktura e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit. Mangësi në ushtrimin e detyrave për kontrollin e territorit.*

Situata: Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Sektori Ligjor, Burimeve Njerëzore Integrimi European TIK, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2021 -31.12.2022, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IVMT),

nuk është ngritur dhe nuk funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Për vitin 2022 sipas strukturës të miratuar me urdhrin nr. 55, datë 20.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Memaliaj, të Njësisë Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2022” është përcaktuar një pozicion pune si inspektor i inspektoriatit ndërtimor dhe mbrojtjes së tokës, pranë Sektorit Ligjor, Burimeve Njerëzore Integrimi European TIK. Sa më sipër, pranë kësaj bashkie nuk funksionin inspektorati ndërtimor.

-Sipas informacionit të administruar nga Inspektori i Inspektoriatit Ndërtimor dhe Mbrojtjes së Tokës, z. A. T. , ku përgjatë vitit 2021-2022 nuk janë konstatuar ndërtime pa leje.

-Sa më sipër, nga ky sektor, nuk disponohet asnjë procedurë, apo akt mbi të cilin të pasqyrohet objekti i aktivitetit për vitin 2021-2022, duke mos dhënë asnjë garanci për mbrojtjen dhe kontrollin e territorit nga ndërtimet pa leje, apo për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë së objekteve të pajisura me leje ndërtimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Gj. G., Kryetari në detyrë i Bashkisë Memaliaj, z. A. T. , Specialisti IVMT, znj. Xh. K., Përgjegjëse e Sektorit Ligjor, Burimeve Njerëzore Integrimi European TIK.

Kriteri: Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar 4, 5, 11, 12; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”, VKM-së nr. 894., datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore” neni 4, 5, 6, 7, 18.

Ndikimi: Mungon institucioni përgjegjës për kontrollin e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe për verifikimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

Shkaku: Shmangie e detyrimit ligjor në hartimin dhe miratimin e organikës nga titullari i institucionit.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

2.7 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Titulli i gjetjes 35: *Mos zbatimi i plotë i rekomansimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH.*

Situata: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit dërguar me shkresën nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 16 prot., datë 05.01.2022 rezulton se,

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **18** masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 16 masa nuk janë zbatuar.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar **6** masa në vlerën 57,310,005 lekë të pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht, 1 masë është në proces zbatimi dhe 4 masa nuk janë zbatuar.

Në Bashkinë Memaliaj problemet e konstatuara në auditimin e mëparshëm vijojnë të jenë përsëri, dhe si rezultat i kësaj rekomandimet organizative si dhe ato për uljen e borxhit tatimor janë ndërthurur me rekomandimet e reja të lëna nga grupi i auditimit.

Gjithashtu nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecuresë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “c”, neni 30, pika 2.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm ka sjellë që strukturat e Bashkisë Memaliaj në fusha dhe aspekte të caktuara vijojnë veprimtarinë në kundërshtim me kuadrin rregullator ligjor.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Memaliaj.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Memaliaj të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces.

Rekomandim: Nga Bashkia Memaliaj të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecuresë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësit edhe afatin e raportimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: znj. A. G.me detyrë Kryetar i Bashkisë Memaliaj.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë

1. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 15, germa “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Bashkia Memaliaj ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 16/1 prot., datë 28.01.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecuresë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Memaliaj ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1326/15, datë 13.12.2022, mbi informimin në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve 6 mujor, por jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.

3. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Memaliaj” administruar në KLSH me nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 16 prot., datë 05.01.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- **18** masa organizative.
- **6** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 57,310,005 lekë.

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Me shkresën nr. 16/1 prot., datë 28.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë z. A. G.është paraqitur plani i veprimit dhe statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve si më poshtë:

Lekë

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	18	18	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	6 (57,310,005)	6 (57,310,005)	0
Totali	24	24	0

5. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Memaliaj:

Lekë

Masat	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara	Vlera e arkëtuar
Masa organizative	18	1	1	0	16	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	6 (57,310,005)	0	1	1	4	0
Totali	24	1	2	1	20	0
Totali në %	100%	4.16%	8.3%	4.1%	83.3%	-

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Masat organizative

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Memaliaj nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk është përcaktuar koordinatori i riskut, nuk janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA për përfitim e “statusit të nëpunësit civil”, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore; nuk është përditësuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Memaliaj, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk janë marrë masa për plotësimin e vendeve vakante kyçe në bashki. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, urdhrin e Kryeministrit nr. 164 datë 05.10.2017.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen e stafit me ligjin për MFK dhe manualin përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, caktimin e koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, ngritjen e njësisë së sinjalizimit për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi mbi zbatueshmërinë dhe implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin problematika e paraqitur në rekomandim është konstatuar edhe për vitin 2022 konkretisht nuk është hartuar strategjia e riskut, regjistri i riskut dhe gjurmët e auditimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

1.2. Rekomandim: GMS të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë si dhe grafikun e takimeve që do realizojë, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 8, datë 27.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi veprimatrinë e GMS dhe EMP, zbatimi i këtij

rekomandimi ka mbetur në fazën e ngritjes së GMS dhe EMP.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

1.3. Rekomandim: Sektori Ligjor, i Burimeve Njerëzore, Integritimit Evropian e TIK të marri masa për përditësimin e rregullores së brendshme duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicion pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore, të plotësojë vendet vakante, për të arritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 1712/3 prot., datë 21.10.2022, dhe Vendimin nr. 49, datë 20.10.2022, të Këshillit Bashkiak është miratuar Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Memaliaj.

Rekomandimi është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021, Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 (auditues), pasi në strukturën e miratuar është përcaktuar vetëm 1 Përgjegjës i Sektorit të Auditit, ndërkohë që kuadri ligjor në fuqi kërkon 3 punonjës. Për periudhën 2021 realizimi i planit është në masën 100%, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projekt-drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontrolleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra “në zbatim të akteve ligjore”, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Në disa raste nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, neni 12, shkronja “d”, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 4 datë 10.01.2020, Kapitulli II 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë”, Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1, 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI pika 6.1.

2.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë të marrë masa që të plotësojë strukturën e Auditit të Brendshëm me 3 punonjës sipas kriterëve ligjore. Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve, duke marrë në konsideratë frekuencën deri në 1 vit në kryerjen e auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi zbatimin e strukturës organizative dhe veprimtarisë së NJAB kjo problematikë konstatohet edhe për vitin 2022, konkretisht struktura e NJAB përbëhet nga 2 pozicione pune ku vetëm pozicioni Përgjegjës i NJAB është i plotësuar ndërsa pozicioni tjetër specialist auditit është vakant. Gjithashtu nuk janë audituar fuasha me risk të lartë si, prokurimet, administrimi i aseteve etj.,

Rekomandimi nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 7 raste faturash me vlerë 6,738,036 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime investime të mbërritura në Bashkinë Memaliaj , të cilat janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh (mos realizim të ardhurash).Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”.

3.1. Rekomandim: Bashkia Memaliaj të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshirë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë përgjatë vitit 2022 janë konstatuar raste voneshash për likuidimin e furnitorëve.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit të PBA-ve 2021-2023 si dhe i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit vjetor 2021, u konstatua se:

a. Dokumenti i PBA është hartuar me mangësi, pasi nuk janë përcaktuar qëllimet e objektivat e politikave të programeve, duke mos e paraqitur të plotë instrumentin e planifikimit financiar.
- Nuk janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZHR apo Ministrinë e Linjës.

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”.

- Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e Bashkisë, Ndërmarrja e Shërbimeve.

b. Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, është bërë planifikim për një pjesë të detyrimeve në vlerën 3,000,000 lekë por nuk është bërë detajimi për çdo program i detyrimeve, të cilat paraqiten për vitin 2021 në vlerën 17,395,686 lekë, ku sipas rakordimit me Degën e Thesarit ato rakordojnë në total , por në zërat detyrime për investime dhe detyrime për vendime gjyqësore ka mos rakordim. Peshën më të madhe të detyrimeve të prapambetura e përbëjnë detyrimet ndaj OSHEE në vlerën 12,113,071 lekë për furnizimin me energji elektrike të krijuara në vitet 2010-2012 nga bashkia dhe ish-komunat dhe detyrimet ndaj SHZA Kalemi në vlerën 2,910,082 lekë për faturat e pastrimit të krijuara nga që nga vitet 2014.

c. Realizimi i buxhetit për vitin 2021 paraqitet nga 529,134 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 376,665 lekë ose në masën 72 %, pra me një realizim jo të kënaqshëm të fondeve që ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të fondeve në zërin 602 “Shpenzime operative” në masën 67% dhe në zërin 231 “Shpenzime për investime” në masën 45 %, ku fondet e alokuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në vlerën prej 98,485 mijë lekë me shkresën nr.prot.377 datë 12.02.2021 nuk janë përdorur (fakt 0 lekë) për financimin e projektit të investimit me objekt: Ndërtim dhe mbikqyrje e Ujësjesit rajonal për fshatrat Vasiar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe qyteti Memaliaj”.

e. Të ardhurat për vitin 2021 janë realizuar në masën 59.3%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore dhe debitorë të tjerë, paraqitet në nivele të larta, përkatësisht në shumën 31,410,740 lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor është bërë në masën më të madhe nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat e kushtëzuar dhe në vlera minimale nga të ardhurat e veta.

Këto veprime janë në mospërputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42, 43, 47, 50, 52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, 37, 38, 39, 40, 41, 48, Udhëzimin e MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, kreu VI pika 266, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar neni 12 pika 3.

4.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Memaliaj, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe në bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që PBA krahas treguesve financiarë të përcaktojnë qëllimet e politikave të programeve, objektivat, prioritetet. Gjithashtu programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesa me publikun dhe palët e interesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj me shkresën nr. 176 prot., datë 27.12.2022, dhe Urdhri nr. 8, datë 27.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur GMS e përbërë nga 6 punonjës dhe EMP e përbërë nga 17 punonjës. Gjithashtu për sa i përket hartimit të buxhetit për vitin 2022 ka mosrealizime të artikujve buxhetorë gjë e cila tregon që planifikimi nuk është kryer me baza reale.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

4.2. Rekomandim: Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale, ku të përllogariten në mënyrë të plotë dhe të saktë të kapaciteteve tatimore e burimeve të tjera të të ardhurave në bazë të verifikimit në terren e pritshmërisë reale të realizimit të tyre. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e artikujve buxhetorë për vitin 2022 është konstatuar se, planifikimi është në vlerën totale 474,930 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 419,701 lekë ose në masën 88% me një mos realizim në vlerën 55,229 mijë lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4.3. Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar se, ka një ritje të vlerës së deryrimeve sipas pasqyrave financiare konkretisht për llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” nga vlera 34,655,100 lekë gjendje më datën 31.12.2021, në vlerën 38,220,128 lekë gjendje më datën 31.12.2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45.

5.1.Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve, që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, ta cilat duhet të jenë të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Në fund të kryejë saktë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, duke u debituar për vlerën e faturave të palikujduara në 31.12.2021 në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llog. të lidhura me to”, në (pasiv të bilancit) veprim ky i gabuar, pasi për vlerën e furnitorëve (në aktiv të bilancit) debitohet llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) në aktiv të bilancit. Llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitore të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund vitin 2021 sipas analizës së partitarit të kësaj llogarie në kredi të llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu ,Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pikat 3.3 dhe 4.2 (Më hollësisht trajtuar në faqet 71-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 39,386,128 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2022, me artikujt kontabël në debi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to” në kredi të llog. 411 “Klientë të ndryshëm” si dhe në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në kredi të llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë kryer veprimet regulluese në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari paraqitet me gjendje referuar analizës së debitorëve të paraqitur në Aneks. Në fakt gjendja e kësaj llogarie paraqitet në gjendjen e llogarisë “411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”, e cila paraqitet në mbyllje të 2020 në vlerën 39,386,128 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to”, veprim i gabuar kontabël. Referuar analizës së debitorëve në këtë llogari nuk janë evidentuar në mënyrë të saktë debitorët për taksat dhe tarifave vendore, që paraqiten në vlerën 12,200,301 lekë, ndërsa sipas Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore debitorët paraqiten në vlerën 31,410,740 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga Auditimi i Prefekturës në vitet e para 2016 dhe KLSH në vite në vlerën 22,454,799 lekë, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkitimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Aneksi 1 (Më hollësisht trajtuar në faqet 71-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë kryer veprimet regulluese në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, llog. 431 “Tatime e taksa”, llog. 436” Sigurime shëndetësore” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje debitorë në aktiv të bilancit, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit, për paradhënie të pa derdhura nga personeli i Bashkisë apo tatime e kontribute të pa ndalura nga Bashkia punonjësve, por janë detyrime që

ka Bashkia ndaj punonjësve për pagat e dhjetorit të vitit ushtrimor si dhe detyrimet për tatimin e të ardhurave dhe kontributet e sigurimeve të ndalura të pa derdhura.

Shuma e këtyre llogarive në vlerën prej 7,993,823 lekë në mbyllje të vitit 2021 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,628.142 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson. Gjendja e llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të pasqyronte detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërparti në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 15/b,59/a, Kreu III. pika 32, Aneksi 1 pika 3.3 nënpika 8.

8.1. Rekomandim: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund vitit 2021 dhe në rakordim me gjendjen në llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 10,621,965 lekë, në Formatin e Performancës së PF. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë kryer veprimet rregulluese në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 3,489,773 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 21 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 16/b.d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1 pika 2 Klasa 2.

9.1. Rekomandim: Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë kryer veprimet regulluese në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119.998 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar e njëjta situatë edhe në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në mbyllje 2021 në vlerën 2,628,142 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari, që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin, që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët janë në mbyllje të vitit 2020 janë në vlerën 39,386,128 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 janë në vlerën 34,655,100 lekë. këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3.

11.1. Rekomandim: Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, të cilat nuk janë paraqitur në llogaritë e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është

konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë kryer veprimet regulluese në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 10,621,965 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 2,628,142 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2021 është 42,648,923 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3.

12.1. Rekomandim: Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”). Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022, të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë kryer veprimet regulluese në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH nga auditimi i mëparshëm financiar dhe i Përputhshmërisë me program auditimi nr. 872/1 datë 06.10.2021, i ndryshuar me shkresën nr. 872/2 prot., datë 06.10.2021, nr. 682/1 prot., datë 13.07.2022, dërguar në Bashkinë Memaliaj me shkresën nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021” të miratuar me Vendimin nr. 226, datë 30.12.2021, të Kryetarit të KLSH-së u konstatua se:

a. Masa Organizative janë lënë 20 rekomandime, të cilat janë pranuar nga subjekti, ku janë zbatuar 2 masa, 1 masë pjesërisht, 15 masa në proces zbatimi dhe 2 masa nuk janë zbatuar;

b. Masa shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim me vlerë 101,400 lekë, e cila është pranuar, por nuk rezulton që Bashkia Memaliaj të ketë njoftuar OE për detyrimin dhe si rrjedhojë nuk është arkëtuar;

c. Masa për të ardhura të munguara janë lënë 5 rekomandime në vlerën 35,137,071 lekë, që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat 3 masa janë në proces zbatimi dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

d. Janë lënë rekomandime për masa disiplinore për 9 punonjës, ku për 7 punonjës me status të shërbimit civil për masë “Vërejtje” dhe masë “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” dhe 2 punonjësve me kontratë masë “Vërejtje me paralajmërim”, masa këto të cilat janë pranuar dhe zbatuar.

13.1. Rekomandim: Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të pa zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara dhe inkurajojmë zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi. Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë situatën e mos

zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Deri me datë 31.12.2022

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në lidhje me situatën e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm konstatohet se, nga Bashkia Memaliaj ka dalë Urdhri nr. 76, datë 12.08.2022, me objekt “Marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve të bëra nga KLSH”, por kjo situatë ka mbetur në fazën e nxjerrjes së urdhrin nga titullari i institucionit.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021 në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Memaliaj operojnë dhe ushtrojnë aktivitetet 36 subjekte të biznesit të pa regjistruar në QKB, për të cilët nuk janë ndjekur procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim dhe pagesën e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore, e për pasojë nuk kanë qenë objekt i taksave dhe tarifave vendore, duke sjellë një evazion fiskal dhe të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Këto subjekte janë njoftuar zyrtarisht me njoftime me anë të postës në vitin 2020, por në vitin 2021 këto njoftime kanë munguar. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime.

14.1. Rekomandim: Sektori i Tatimeve, Bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitetet, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet pa leje, të paregjistruar në QKB, dhe të ndjekë procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim. Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me QKB dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, për përcaktimin e statusit të këtyre bizneseve dhe për ato biznese që kanë aktivitet të hapur të merret informacion zyrtar, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar nivelin e të ardhurave nga subjektet fizik/ juridik dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara në fund të periudhave ushtrimore të bëhet aplikimi i taksave e tarifave vendore në zbatim të Vendimeve të KB.

Deri me datë 31.12.2022

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1. Gjetje nga auditimi: Nga përpunimi i të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës e Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj, konstatohet se nuk ka rregjistër të plotë për bizneset dhe familjarët me të gjitha të dhënat dhe detyrimet e për rrjedhojë nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta për debitorët lidhur me vlerën, llojin e detyrimit dhe kohën e krijimit të tij. Gjithashtu debitorët nuk janë mbajtur në mënyrë progresive, por të shkëputur nga viti në vit, duke sjellë një evidentim të pasaktë të debitorëve nga viti 2018 deri në fund të vitit 2021, ku sipas të dhënave vlera e akumuluar e debitorëve për periudhën 2018-2021 është 31,410,740 lekë, dhe vetëm për vitin 2021 vlera debitorë është **8,350,065 lekë**. Ndërsa në pasqyrat financiare të vitit 2021 gjendja e debitorëve nga taksat e tarifave vendore si pjesë e gjendjes së llogarisë 468 “debitorë të ndryshëm është në vlerën 12,200,301 lekë. Për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimit të subjekteve debitorë nuk janë ndërmarrë të gjitha masat, që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” me ndryshime, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

1.1. Rekomandim: Sektori i Financës dhe i Tatimeve, Bashkia Memaliaj të marrë masa për hartimin e një regjistri të plotë e të saktë për të gjithë Bashkinë në mënyrë që të evidentohen të gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitet, metë gjitha të dhënat për bazën e tatueshme, dhe të aplikojnë për secilin në mënyrë të saktë taksat dhe tarifatat vendore që kanë detyrim ligjor, sipas paketës fiskale të miratuar. Të kryhet faturimi dhe njoftim vlerësimi i të gjithë bizneseve që kanë detyrime si dhe të kryhet evidentimi dhe kontabilizimi i pagesave të kryera dhe nxjerrja e saktë e debitorëve në fund të çdo viti ushtrimor. Për debitorët, të ndërmarrë të gjitha masat shtrënguese në rast mos pagesash, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore të akumuluar për 4 vitet 2018-2021 në vlerën 31,410,740 lekë.

Deri me datë 31.12.2022

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj, Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave nuk janë marrë masat e duhura për hartimin e një regjistri të plotë me të gjithë elementët përbërës sipas dispozitave ligjore përkatëse. Si dhe nuk janë masat e duhura për arkëtimin e vlerës debitorë 31,410,740 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me taksën e ndërtesës dhe tarifës së ndriçim -pastrim-gjelbërimit për familjarët, u konstatua se Bashkia Memaliaj nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat për çdo familje, për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe se kujt viteve i përket banesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave. Në paketën fiskale nuk është përcaktuar taksa e ndërtesës për familjarët, për të cilët nuk ka të dhëna. Gjithashtu nuk plotësohet njoftim detyrimi për familje, për taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërimit-ndriçimit. Për vitin **2021** nga Bashkia Memaliaj nuk është arkëtuar asnjë taksë apo tarifë nga familjarët pasi Ujësjellës Kanalizime sha Tepelenë nuk e ka kryer rolin e Agjentit tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës dhe tarifatat e pastrim-gjelbërimit-ndriçimit për familjarët, e për pasojë nuk është arkëtuar asnjë lekë nga këto taksa dhe tarifa. Për këtë arsye me VKB nr.6 datë 23.01.2020 është bërë miratimi i ndarjes së Bashkisë Memaliaj nga “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a, Tepelenë, dhe është vendosur krijimi në vitin 2022 i “UK Memaliaj” Sha. Referuar të dhënave nga gjendja civile Memaliaj rezulton se në vitin 2021 janë 2495 familje, pa marrë parasysh abonentët në fshat dhe sipas përlllogaritjeve detyrimi i pa arkëtuar është në vlerën 5,239,500 lekë (vlera debitorë). Këto veprim janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 12 pika 1 ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, me paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 59, datë 24.12.2020, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Memaliaj”.

2.1. Rekomandim: Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me NJA të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifatat vendore, dhe të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 5,239,500 lekë. Gjithashtu Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me “UK Memaliaj” Sha, duke lidhur Akt-marrëveshje për agjent tatimor për mbledhjen e

taksës së ndërtesë dhe pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga tatimpaguesit familjarë dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve të aplikohet masë administrative ndaj agjentit tatimor.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj, Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave nuk janë marrë masat e duhura për arkëtimin e vlerës debitore 5,239,500 lekë. Me shkresën nr. 1358/2 prot., datë 12.08.2022, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj ka dalë urdhri për ngritjen e një grupi pune në njësitë administrative për arkëtimin e detyrimeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

3. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të Sektorit të Financës dhe Tatimeve të nxjerra mbi bazën e regjistrave të tokës për secilën NJA, rezulton se **për vitin 2021** janë 2645 familje fermere në vlerë debitore prej 2,574,914 lekë, ndërsa për vitet 2018-2019-2020 vlera debitore në total është 10,711,803 lekë, dhe gjendja progresive në fund të vitit 2021 është 13,286,717 lekë, e cila përbën të ardhur te munguar për buxhetin e Bashkisë Memaliaj. Siç shihet vlera debitore është konsiderueshme, e cila tregon për një punë të pamjaftueshme nga stafi i bashkisë për arkëtimin e kësaj takse. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me pikën 2 nënpika (b) “Taksa mbi tokën bujqësore” të VKB nr. 59, datë 24.12.2020, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

3.1. Rekomandim: Strukturat Drejtuese, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marrë nga institucionet përgjegjëse (NJA/sectorët e bujqësisë, ZVRPP dhe Qarku Gjyrokastër), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet fermere të lëna jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore. Për debitorët, të nxirren njoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk është ngritur një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga korrespondenca zyrtare me ASHK në vitin 2021 rezulton se janë 11 individë që kanë përfituar nga legalizimi i ndërtimeve informale dhe nuk kanë paguar taksën e infrastrukturës në vlerën 230,562 lekë. Po kështu në periudhën 2018-2019-2020 kanë përfituar nga legalizimi 36 subjekte, të cilët kanë mbetur pa paguar vlerën e detyrimit për taksën e infrastrukturës prej 778,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerë totale prej 1,008,562 lekë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.01.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 27, me VKB nr. 59, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, pika 4.

4.1. Rekomandim: Bashkia Memaliaj nëpërmjet bashkëpunimit institucional ti kërkojë ALUIZNI-t, Drejtoria Tepelenë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat pranë Bashkisë Memaliaj të taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Sektori i Financës dhe Tatimeve të ndjekë procedurat e

njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor në tabelat e paraqitura në anekse.

Deri me datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë masat e duhura për arkëtimin mbi detyrimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,008.562 lekë. Por nga Bashkia Memaliaj shkresën me nr. 366 prot., datë 15.08.2022, me objekt: “Marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna na KLSH” është drejtuar Drejtorisë Shtetërore të Kadastrës Tepelenë konkretisht në të citohet se, “Të mos lëshohet dhe pajisen me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat pranë Bashkisë Memaliaj së taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit në objektet, që përfitojnë nga legalizimi”.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

5. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Financës dhe Tatimeve u konstatua se 2 subjekte private “R.” Shpk me vendndodhje në NJA Qesarat dhe “L.” Shpk, me vendndodhje në NJA Krahës, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, nuk janë pajisur me autorizim për licencimin e veprimtarisë, e për rrjedhojë nuk kanë paguar tarifën ligjore prej 1,000,000 lekë për licencim, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj në vlerën 2,000,000 lekë. Në këto pika karburanti nga inspektorët e tatimeve janë ushtruar kontrole, ku janë identifikuar se këto subjekte ushtrojnë aktivitetet në mungesë të autorizimit për lejim aktiviteti, por për këto kontrole nuk është bërë informacion pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për të kërkuar bashkëpunim për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë të subjekteve që ushtrojnë pa licencë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9”.

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për disiplinimin në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, të veprimtarisë së subjekteve “R.” Shpk dhe “L.” Shpk, që zhvillojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Nëse subjektet plotësojnë kriteret e duhura ligjore për zhvillimin e këtij aktiviteti, atëherë të pajisen me licencën përkatëse, kundrejt pagesës së tarifës. Nëse subjektet nuk plotësojnë kriteret, të merren masat e duhura në bashkëpunim me institucionet e tjera sipas përcaktimeve ligjore, për mos lejimin e kryerjes së këtij aktiviteti në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi nga dy subjektet e mësipërme.

Deri me datë 31.12.2022

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë masat e duhura për arkëtimin mbi detyrimet për subjektet që ushtrojnë aktivitetet në fushën e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në vlerën 2,000,000 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Memaliaj rezulton se ka efektive 240 kontrata me individë me sipërfaqe 278.8 ha për dhënien me qira nga fondi i tokës bujqësore dhe fondi pyjor-kullosor të lidhura nga ish-Komunat, nga të cilat 107 fermerë qiramarrës janë debitorë

në vlerën 4,364,486 lekë, e cila përbën efekt negativ në të ardhurat e Bashkisë. Për debitorët nuk është ndjekur procedurë e plotë administrative si dhe asnjë procedurë ligjore për arkëtimin e detyrimeve sipas kontratës së qirasë. Nga NJA përkatëse për debitorët janë bërë njoftime me shkresë zyrtare për detyrimet, që kanë për tarifën e pa paguara të qirasë, por nga Bashkia Memaliaj nuk janë ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për detyrimin e shlyerjes së detyrimeve kontraktore të qiramarrësve të tokës bujqësore, duke mos kaluar asnjë rast në gjykatë për mos plotësim të kushteve kontraktuale. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Pjesa V “Kontratat” Titulli I, Kreu I neni 662, Kreu III, neni 690 neni 693, neni 698-704 dhe kontratat e lidhura të qirasë nenet 5,6,7”.

6.1.Rekomandim: Strukturat Drejtuese të Bashkisë Memaliaj nëpërmjet Sektorit të Bujqësisë, Sektorit Juridik dhe Integritimit në BE, Sektorit Urbanistik dhe Menaxhimit të Aseteve, Sektorit të Financës dhe Tatim-Taksave të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha kontraktore nga procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve qiradhënësit në vlerën 4,364,486 lekë dhe në rastet e mos pagesave të parashtrajës në KB, ku të marrë miratimin e tij për zgjidhjen e kontratave, që nuk janë efektive dhe kthimin e parcelave Bashkisë Memaliaj me inventar.

Deri më datë 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë masat e duhura për arkëtimin mbi detyrimet nga dhënia me qira e tokave bujqësore në vlerën 4,364,486 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

Masa disiplinore

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për punonjësit me status të Nëpunësit Civil dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës, trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në bazë të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11 dhe nenit 37 e 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 12 “Masat disiplinore” të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga puna”.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion është konstatuar se, nga Bashkia Memaliaj konstatohet se:

Me Urdhrin nr. 9, datë 28.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës për vlerësimin mbi problematikat e konstatuara nga KLSH, për punonjësit e Bashkisë Memaliaj.

- Me Vendimin nr. 26, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta për ngritje në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për z. P. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

- Me Vendimin nr. 29, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta për ngritje në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për znj. V. K. me detyrë me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban dhe Kadastrës.

- Me Vendimin nr. 28, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore

“Pezullim nga e drejta për ngritje në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për znj. E. H. me detyrë me detyrë Nën/Kryetar i Bashkisë Memaliaj.

- Me Vendimin nr. 27, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për znj. M. C. me detyrë punonjës tatimesh NJA Buz.
- Me Vendimin nr. 32 datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. F. H. i Ndërmarrjes së Shërbimeve.
- Me Vendimin nr. 35, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. Sh. L. me detyrë punonjës tatimesh NJA Memaliaj Fshat.
- Me Vendimin nr. 34, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për znj. K. V. me detyrë punonjës tatimesh NJA Qesarat.
- Me Vendimin nr. 35, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. E. L. me detyrë specialist tatimesh.
- Me Vendimin nr. 30, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për z. P. M. me detyrë punonjës tatimesh NJA Luftinjë.
- Me Vendimin nr. 36, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për znj. E. S. me detyrë specialist buxheti.
- Me Vendimin nr. 33, datë 07.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. A. G. me detyrë specialist tatimesh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. A. G. me detyrë Kryetar i Bashkisë Memaliaj.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se Bashkia Memaliaj:

- Nuk ka ngritur një sistem efektiv për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.
- Nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.
- Nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim.
- Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.
- Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.
- Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.
- Ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB, nuk kanë Organigramën korrensponduese të strukturës si dhe këto ndryshime nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme.
- Nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës
- GMS nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së

- Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe ankesave, për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pika 2, Ligji nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 90/2012, datë 27.09.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21, pikat 1-2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2 dhe pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandim: Nga Bashkia Memaliaj, Sektori i Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.

Deri në Dhjetor 2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se NJAB në Bashkinë Memaliaj për periudhën objekt auditimi është organizuar dhe funksionon me 1 (një) auditues i cili është njëkohësisht edhe përgjegjës i NJAB –së. Në strukturën e miratuar janë përcaktuar 1(një) Përgjegjës i Sektorit të Auditit dhe 1 (një) Specialist, ndërkohë që Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit të NJAB rezulton se emërimi i Përgjegjësit të NJAB - së nuk është në përputhje me kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Për periudhën 2022 realizimi i planit është në masën 100%. NJAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, por nuk ka marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes së auditimeve, auditimin e fushave me risk të lartë, kombinimin e llojit të auditimeve dhe në asnjë program auditimi nuk ka përfshirë si drejtim vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Grupi auditimit evidenton se në këtë NJAB monitorimi vazhdueshëm dhe Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë nuk kryhet në përputhje me kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Audituesi i Brendshëm ka adresuar rekomandime për përmirësim me karakter të përgjithshëm dhe jo të mirë përcaktuara, por monitorimi i zbatimit të tyre nuk ka ndikuar në realizimin në kohë të tyre. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 3, germa “a”, neni 11, “Punësimi i audituesit të brendshëm”, pika 2, germa “ç” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1, germa “b”, Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VII, pika 3.1.3, Kapitullin VII, pika 7.1.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për sistemimin e organizimit dhe funksionimit të NJAB – së konform kuadrit rregullator ligjor në fuqi, duke bërë shpallje të pozicioneve vakante në mënyrë që të plotësojnë strukturën e Auditit të Brendshëm me 3 (tre) punonjës sipas kritereve ligjore.

NJAB të kryej planifikimin e auditimeve, duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes së auditimeve, auditimin e fushave me risk të lartë, kombinimin e llojit të auditimeve, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

NJAB të përditësojë Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së veprimtarisë audituese dhe të përcaktojë qartë kush do ta realizojë (në kushtet e mosplotësimit të kësaj NJAB), mjetet që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm dhe vetëvlerësim periodik, të cilat duhet të mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim analizimin e nivelit të zbatimit të indikatorëve të performancës dhe sigurimin e cilësisë së auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

-Për PBA 2022-2024 dhe Buxhetin vjetor 2022 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si vijon: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”.

-Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Memaliaj, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, (nuk) administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Memaliaj, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analizë e detajuar);

- Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

- Nuk administrohen tavanet përgatitore, Tavanet përfundimtare janë miratuar me VKB nr. 49, datë 16.12.2021 “Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2022-2024 për Bashkinë Memaliaj”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1852/1 Prot., datë 17.12.2021.

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

- Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 13, pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 6 në Kreun I, pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”.

Udhëzimi nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Memaliaj.

- Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;
- Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;
- Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;
- Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Memaliaj.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2022 paraqitet masën 88%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Memaliaj në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 19 fatura për vlerën totale **11,498,494 lekë**. Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr. 410 datë 27.02.2023, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Memaliaj ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën **10,675,831 lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale.

Sa më sipër vlera e raportuar nga Bashkia Memaliaj me vlerën e evidentuar nga grupi i auditimit, që duhej të raportohet sipas pasqyrave financiare në MFE është në vlerën **11,498,497 lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale të cilat kanë një diferencë të lehtë prej 822,666 lekë, pa ndryshuar në thelb situatën normale të gjendjes financiare në të cilën ndodhet Bashkia Memaliaj. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas raportit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (SIFQ) vlera e raportuar duhej të ishte **13,410,265 lekë**, pra konstatohet se për Bashkinë Memaliaj vlera e detyrimit të

mbetur të raportuar për vitin 2022 dhe vlera e raportuar për shpenzimet e planifikuara, nuk përputhet me informacionin e gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ).

- Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likuidohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky detyrim.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; Kreun XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin e MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”; Pikat 8, 106 dhe 107 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e tyre.

Përgjatë vitit buxhetor 2023 dhe në vijim

5.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori i Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 486.

Për çdo vit buxhetor

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Memaliaj për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 965,800 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Memaliaj. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësitë vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen (argumentimin dhe propozimin nga njësitë e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2023 dhe në vijimësi

6.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

Brenda vitit 2023 dhe në vijim

7. Gjetje nga auditimi: Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nën pikat 43,44,45. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, ta cilat duhet të jenë të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Në fund të kryejë saktë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” paraqitet në mbyllje të 2020 në vlerën 39,386,128 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, duke u debituar për vlerën e faturave të palikuiduara në 31.12.2021 në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llog. të lidhura me to”, në (pasiv të bilancit) veprim ky i gabuar, pasi për vlerën e furnitorëve (në aktiv të bilancit) debitohet llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) në aktiv të bilancit. Llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitore të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund vitin 2021 sipas analizës së partitarit të kësaj llogarie në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pikat 3.3 dhe 4.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 38,220,128 lekë në aktivin e Bilancit të fundvitit 2022, me artikujt kontabël në debi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to” në kredi të llog. 411 “Klientë të ndryshëm” si dhe në debi të llog.468 “Debitorë të ndryshëm” në kredi të llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 0 lekë, po ashtu në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 0 lekë, ndërkohë që kjo llogari paraqitet me gjendje referuar analizës së debitorëve të paraqitur në CD. Në fakt gjendja e kësaj llogarie paraqitet në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”, e cila paraqitet në mbyllje të 2021 në vlerën 34,655,100 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,220,128 lekë, duke u debituar për këtë vlerë në kredi të llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhur me to”, veprim i gabuar kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

10. Gjetje nga auditimi: Në aktiv të Bilancit në klasën 3 të llogarive të arkëtueshme janë paraqitur me gjendje debitore: Në mbyllje të vitit 2022 në aktiv llog. 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba” në vlerën 6,355,499 lekë në kundërparti të llog.42 “Detyrime ndaj personelit” në pasiv, llog.431 “Tatime e taksa” në vlerën 405,459 lekë në aktiv në kundërparti të llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa” në pasiv dhe llog.436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 2,173,028 lekë në aktiv në kundërparti të llog. 435 “Detyrime për sig. shoqërore” në pasiv. Llogaritë në aktiv të bilancit llog. 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, llog.431 “Tatime e taksa”, llog.436 “Sigurime shëndetësore” nuk duhet të paraqiteshin me gjendje, pasi vlerat e pasqyruara nuk janë të drejta të konstatuara, që ka shteti ndaj personelit, për paradhënie të pa derdhura nga personeli i Bashkisë apo tatime e kontribute të pa ndalura nga Bashkia punonjësve, por janë detyrime që ka Bashkia ndaj punonjësve për pagat e dhjetorit të vitit ushtrimor si dhe detyrimet për tatimin e të ardhurave dhe kontributet e sigurimeve të ndalura të pa derdhura. Shuma e llogarive në vlerën prej 8,933,986 lekë në mbyllje të vitit 2022 duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,286,263 lekë, vlerë për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” duhet të pasqyronte detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërparti në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15/b,59 /a, Kreu III. pika 32, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Sektori i Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht

në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në fund vitit 2022 dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 0 lekë, në Formatin e Performancës së PF. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

11. Gjetje nga auditimi: Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 21 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 16/b. d, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 2 Klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i PF konstatohet se dy llogari të aktiveve afatgjata materiale paraqiten me gjendje të pandryshuar në vite të shprehur me kosto historike përkatësisht: llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119.998 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 277,000 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuar me emërtesa se çfarë përfaqësojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zberthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet

e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,628,142 lekë, vlerë e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson. Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Gjendja në këtë llogari është e pasaktë pasi detyrimet ndaj shtetit nga debitorët janë në mbyllje të vitit 2020 janë në vlerën 39,386,128 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 janë në vlerën 34,655,100 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3¹⁰. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e të drejtave të konstatuara në lidhje me detyrimet që kanë të tretët ndaj shtetit si debitorët, të cilat nuk janë paraqitur në llogaritë e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, duke i përfshirë dhe saktësuar në gjendjen e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2024

14. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 0 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 1,286,263 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit, vlerë kjo, e cila nuk është e saktë dhe reale, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 47,154,114 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 61-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Sektori i Financës dhe Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2024

15. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

¹⁰Llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme.

-Leje ndërtimi me nr. 1, datë 18.10.2022 i jepet zhvilluesit: K. me të dhënat e mëposhtme: M.A.K S., Leja e ndërtimit për objektin: Ndërtimi i murit mbajtës prej guri h-3m, sisteme të ambientit, mbushje nivelime mbjellje me bar hapësirat e gjelbërta si dhe ndërtimi i një muri kufizues në pjesën fundore të karburantit “M. O.”, Memaliaj me nr. pasurie 1/136 s=996m2, adresa e realizimit të punimeve Bashkia Memaliaj.

-Leje ndërtimi me nr. 5, datë 08.07.2021 i jepet: A. R., zhvilluesi A. R. aplikues i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: P. D., Leja e ndërtimit për objektin: Banese një familjare me 1 kat mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, adresa e realizimit të punimeve Bashkia Memaliaj. Nuk është marrë mendim pozitiv nga AZHT. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408 datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1 në shkronjën “ë” në nenin 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 122-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandim: Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa marrë në konsideratë mendimet pozitive nga institucionet përgjegjëse që lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në sistemin “e-leje” u konstatua se, për lejen e zhvillimit me nr. 8, datë 23.07.2021 miratuar para lejes së ndërtimit nr. 7, datë 06.10.2021 i jepet zhvilluesit M. D., i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: G.M. leja e ndërtimit për objektin: Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore, adresa e realizimit të punimeve Bashkia Memaliaj. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, shkronja “a” dhe shkronja “b” në pikën 1 të nenit 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 122-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandim: Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për kërkuar ndryshim të statusit të tokës duke e regjistruar me status truall për të vazhduar me miratim të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” u konstatua se, leje ndërtimi nr. 4, datë 24.06.2021 i jepet zhvilluesit: R. L. dhe H. L., aplikues i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: G. M. Leja e ndërtimit për objektin: Banesë adresa e realizimit të punimeve: B, R.; Krahës Zhulaj 6307 Bashkia Memaliaj. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 35 “Distanca e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 122-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandim: Nga DPKZHT Memaliaj të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi me objekte të cilat nuk respektojnë distancat e lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, u konstatua se:

-Në Bashkinë Memaliaj, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IVMT), nuk është ngritur dhe nuk funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Për vitin 2022 sipas strukturës të miratuar me urdhrin nr. 55, datë 20.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Memaliaj, të Njësisë Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2022” është përcaktuar një pozicion pune si inspektor i inspektoratit

ndërtimor dhe mbrojtjes së tokës, në varësi të Sektorit Ligjor, Burimeve Njerëzore Integrimi European TIK. Sa më sipër, pranë kësaj bashkie nuk funksionin inspektorati ndërtimor.

-Sipas informacionit të administruar nga Inspektori i inspektoratit ndërtimor dhe mbrojtjes së tokës, z. A. T., ku përgjatë vitit 2021-2022 nuk janë konstatuar ndërtime pa leje.

-Sa më sipër, nga ky sektor, nuk disponohet asnjë procedurë, apo akt mbi të cilin të pasqyrohet objekti i aktivitetit për vitin 2021-2022, duke mos dhënë asnjë garanci për mbrojtjen dhe kontrollin e territorit nga ndërtimet pa leje, apo për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë së objekteve të pajisura me leje ndërtimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar 4, 5, 11, 12; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”, VKM-së nr. 894., datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore” neni 4, 5, 6, 7, 18. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 124-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati (Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit) jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

-Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit dërguar me shkresën nr. 872/8 prot., datë 30.12.2021, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 16 prot., datë 05.01.2022 rezultoi se:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **18** masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe **16 masa nuk janë zbatuar.**

b. Për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), janë rekomanduar 6 masa në vlerën 57,310,005 lekë të pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht, 1 masë është në proces zbatimi dhe **4 masa nuk janë zbatuar.** Në Bashkinë Memaliaj problemet e konstatuara në auditimin e mëparshëm vijnë të jenë përsëri, dhe si rezultat i kësaj rekomandimet organizative si dhe ato për uljen e borxhit tatimor janë ndërthurur me rekomandimet e reja të lëna nga grupi i auditimit.

Gjithashtu, nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “c”, neni 30, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 125-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Memaliaj të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.2 Rekomandim: Nga Bashkia Memaliaj të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësisht edhe afatin e raportimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt:

- “Rikonstruksioni i segmentit rrugor “Bylysh –Vagalat – Marica j- Arrëz e Madhe - Lamaj-Qafa e Kicokut” faza e II”, Bashkia Memaliaj, viti 2021, me fond limit **19,166 mijë lekë**, me fitues OE “C. R. .8” Shpk, me vlerë të ofertës **9,990 mijë lekë**;

- “Blerje makine vetëshkarkuese, për nevojat e Drejtorisë së Shërbimit Memaliaj”, Bashkia Memaliaj, viti 2021, me fond limit **3,500 mijë lekë**, me fitues OE “C. R. .8” Shpk, me vlerë të ofertës **3,462 mijë lekë**,

rezulton se Titullari i AK, për realizimin e procedurave të prokurimit nuk ka bërë një ndarje të qartë të detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin prokurimit publik. Dokumentet e Tenderit nuk janë nënshkruar në të gjitha faqet nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit. Mungojnë deklaratat e mospasjes së konfliktit të interesit nga KVO. Këto veprime nuk janë në përputhje me përcaktimet e nenit 56, nenit 54, dhe pikës 2 të nenit 64 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 85-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa për të bërë një ndarje të qartë të detyrave të zyrtarëve që marrin pjesë në realizimin e procedurave të prokurimit publik. Gjithashtu, të sigurohet që anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe KVO-së të plotësojnë dhe nënshkruajnë të gjitha dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022, u konstatua se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 108 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 4,450,252 lekë dhe 6 “Institucione” në vlerën 528,000 lekë. Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 234 subjekte të kategorisë “Biznes” dhe “Institucione” në vlerën 7,522,649 lekë dhe 6 institucione në vlerën 660,000 lekë, pra gjithsej **8,182,649 lekë** për **240** subjekte, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

- Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Konkretisht në fillim të vitit 2022 janë debitor 114 subjekte për vlerën 4,978,252 lekë, ndërkohë në fund të vitit 2022, janë 240 subjekte në vlerën 8,182,649 lekë. **Konkretisht gjatë vitit 2022 janë krijuar 122 subjekte debitor për vlerën 3,169,384 lekë.**

- Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga Sektori i Financës dhe Tatimeve Bashkia Memaliaj, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), për të debitorëve nuk janë marrë masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

- Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Neni 64 në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

- Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët.

Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerë **8,182,649 lekë**.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Memaliaj me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimeve ligjore për përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë (për vitin 2022), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2022, janë krijuar 64 subjekte debitorë për vlerën 614,709 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2022 janë 169 subjekte për vlerën 5,064,964 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj. Gjithashtu u konstatua se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatëvonesës për mos pagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t’i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2023. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbartimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Lidhja 2, tabela 2 në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar; Paketa fiskale e vitit 2022, pika 17, shkronja “b”; Neni 3 dhe neni 4 në Ligjin nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë 5,064,995 lekë, nga qiratë e tokës Bujqësore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2.2 Rekomandim: Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për antenat, që Bashkia Memaliaj/ish Komunat ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur 3 kontrata qiraje për antenat në fondin pyjor/kullososr në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 1,100,000 lekë të cilat janë likuiduar për vitin 2022 vlera 300,000 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 800,000 lekë, të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

Referuar kushteve të kontratës nenit 4, pika 4.2, pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës për llogari të institucionit.

Gjithashtu, nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të nenit 10, pika 10.1, nga Bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nga Sektori i Bujqësisë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Memaliaj, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj).

-Gjithashtu është konstatuar se kontrata e qirasë me nr. 12/3 prot., datë 14.01.2015 e lidhur midis ish Komunës Buz përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës Buz, z. B. S. dhe subjektit Vo. Al. me Administrator D. Z. M. rezulton se, afati i kontratës së sipërcituar ka mbaruar më datë 11.11.2021, pra kontrata nuk është rinovuar si dhe nuk është likuiduar detyrimi vjetor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Sektori Ligjor në bashkëpunim me sektorin e Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masat e nevojshme dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 800,000 lekë, nga kontratat e qirave për antenat. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Memaliaj të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj gjithashtu dhe për kontratat që u ka mbaruar afati, Sektori Ligjor, të marrë të gjitha masat e nevojshme për rinovimin e kontratave të qirasë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi të pa licencuara rezulton se përgjatë vitit 2022 në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Memaliaj operojnë dhe ushtrojnë aktivitet 37 subjekte të biznesit të pa regjistruar në QKB, për të cilët nuk janë ndjekur procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim dhe pagesën e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore, e për pasojë nuk kanë qenë objekt i taksave dhe tarifave vendore, duke sjellë një evazion fiskal dhe të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë), për subjektet e pataksuara, do të kishim 26,200 lekë * 37 subjekte mesatarisht = 969,400 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 16, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitet, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje, të peregjistruar në QKB, dhe të ndjekë procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim.

- Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me QKB dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, për përcaktimin e statusit të këtyre bizneseve dhe për ato biznese që kanë aktivitet të hapur të merret informacion zyrtar, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar nivelin e të ardhurave nga subjektet fizik/juridik dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara në fund të periudhave ushtrimore të bëhet aplikimi i taksave e tarifave vendore.

- Nëse do të bënim përlllogaritjen vetëm të tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit për subjektet e pataksuara do të kishim 969,400 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është 536,448 lekë për 30 subjekte,

nga të cilat 19 subjekte për vlerën 305,88 lekë janë krijuar në vitin 2022. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Memaliaj, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Memaliaj, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mos pagesës së TNI, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9482, datë 03.04.20106, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 27 "Taksa e ndikimit në infrastrukturë", Paketa Fiskale 2022, Pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 536,448 lekë, sipas listës që disponon Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezultojnë se përgjatë vitit 2022 në territorin e Bashkisë Memaliaj dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 4 stacione shitje. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2022, gjithsej rezultojnë 2 subjekte debitor për vlerën 2,400,000 lekë, si rrjedhojë e mos riliçencimit/mos likuidimit të tarifës së licencimit të tregtimit të karburantit. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezultojnë se Sektori i Taksave Vendore, pranë Bashkisë Memaliaj, përgjatë vitit 2022 nuk i është drejtuar me shkresë subjekteve për pajisjen me licencën për ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu përgjatë vitit 2022 nuk ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet Sektorit Taksave Vendore dhe Policisë Bashkiake, për penalizimin e subjekteve që nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në tregtimin e karburanteve.

-Për subjektet e mësipërme nuk administrohen masa shtrënguese (bllokim të llogarive bankare).

-Pra sa më sipër konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

- Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mos marrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2022) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 2 subjekte për 2 stacione shitje të karburantit nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Memaliaj në vlerën 400,000 lekë dhe në fund të periudhës 31.12.2022 vlera debitore është 2,400,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja "b" në pikën 1 në nenin 131 "...nuk i paguan ato në buxhet"

të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar. Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Sektori e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Ligjor dhe me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2 Rekomandim: Sektori e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Ligjor Bashkia Memaliaj, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 2,400,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Memaliaj (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Memaliaj) u konstatua se nga Sektori i Taksave Vendore, Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik si dhe Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e ndotjes, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se për vitin 2022 në 5 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, ndotjes në vlerën 180,000 lekë gjithsej, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Memaliaj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Tarifat Vendore, germa “dh” në Paketën Fiskale të Bashkisë Memaliaj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Sektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt sekondar dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pamaturuar në vlerën 180,000 lekë ndaj 5 subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Taksave Vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Memaliaj dhe NJA për vitin 2022 janë taksuar 3902 familje. Me qëllim vlerësimin nëse nga Sektori i Tatimeve Bashkia Memaliaj është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “Familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga Sektori i Financës dhe Tatimeve Bashkia Memaliaj me informacionin e administruar nga Gjendja Civile.

-Sipas gjendjes civile në Bashkinë Memaliaj dhe NJA janë 6946 familje, pra ndërkohë në vitin 2022 janë taksuar 3902 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Memaliaj nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit për qytetin Memaliaj, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 3,400 lekë * 1421 familje taksuar më pak = **4,831,400 lekë** planifikuar më pak si dhe për Njësitë Administrative për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 800 lekë * 1623 familje taksuar më pak = **1,298,400 lekë**.

- Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Financës dhe Taksave Vendore Bashkia Memaliaj nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018¹¹, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Memaliaj duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Memaliaj dhe NJA. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenin 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Kreun II në Paketën Fiskale të Bashkisë Memaliaj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësiteve Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, rezultojnë 6,129,800 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Memaliaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022, u konstatua se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 2505 familje debitorë për vlerën 6,680,975 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 janë krijuar 2477 familje debitorë për vlerën 3,919,371 lekë. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifave për kategorinë “Familje”, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

- Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultojnë se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Memaliaj, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me “Ujësjellës-Kanalizime Memaliaj” Sha, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Memaliaj. Përjashtuar familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Sa i përket familjeve debitorë, rezultojnë se nga Sektori i Taksave Vendore dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitorë.

- Gjithashtu ndaj Bashkisë Memaliaj rezultojnë të jetë debitor edhe “UK Memaliaj” Sha, për vitin 2022 në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”. Detyrimi që ka “UK Memaliaj” Sha, në fund të vitit 2022 (në rolin e

¹¹ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

agjentit tatimor) ndaj Bashkisë Memaliaj është në vlerën prej **1,125,309** lekë. *Nga sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Memaliaj për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor “UK Memaliaj” Sha., i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA-ve, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor “UK Memaliaj” Sha, për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 6,680,975 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.3 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga agjenti tatimor “UK Memaliaj” Sha, prej 1,125,309 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Taksave Vendore për planifikimin e taksës për tokën bujqësore, rezultoi se planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme të sipërfaqes së tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere, informacioni i cili i dërgohet nga NJA Sektorit të Taksave Vendore në fazën e përgatitjes së buxhetit. Këto të dhëna nuk janë të sakta, edhe për faktin se ka mos rakordim të dhënash në mes të dhënave të NJA dhe të dhënave që disponon Sektori i Taksave Vendore. Për marrjen e të dhënave të sakta mbi sipërfaqen e tokës së shpërndarë në disponim të fermerëve dhe të asaj në pronësi të Bashkisë u kërkua korrespondenca zyrtare e Bashkisë Memaliaj me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, cila nuk ekzistonte. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës rezultoi se: Nga NJA disponohen regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere. Duhet theksuar se nuk kishte një përditësim të këtyre regjistrave në 10 vitet e fundit, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme.

- Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Sektori Taksave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Bujqësisë, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së sektorit të Taksave Vendore Bashkia Memaliaj për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore në fund të vitit 2021 për taksën e tokës bujqësore është 2,761,604 lekë, dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 3520 familje debitorë për vlerën 6,731,799 lekë, nga të cilat në vitin 2022 është krijuar 3,970,195 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitore për taksën e tokës bujqësore, çka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Memaliaj në arkëtimin e kësaj takse.

- Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pika A.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Memaliaj për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 6,731,799 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit me vlerë të fondit limit **432,842 mijë lekë**, është konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP procedura e prokurimit publik me objekt: “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për Fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, Bashkia Memaliaj, viti 2021, me fond limit **410,176 mijë lekë**, me fitues **BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk**, me vlerë të ofertës **410,174 mijë lekë**. Në këtë procedurë prokurimi oferta ekonomike e bashkimit të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotëson kriteret e kërkesave kualifikuese të DT. Janë vendosur kriteret jo të drejta për kualifikim duke sjellë mungesë konkurrence, me pasojë lidhje të kontratës me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. Përkatësisht:

- Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, në mungesë të oponencës teknike si dhe në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Përkatësisht, Raporti i Vlerësimit në Mjedis është hartuar nga OE “A. G.” Shpk në mungesë të certifikatës së ekspertit dhe licencës për kryerjen e veprimtarive me ndikim në mjedis lëshuar nga QKB. Gjithashtu, OE “ ” Shpk është edhe hartues i projektit të ndërtimit të ujësjellësit.

- Kriteret e vendosura në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas të cilit, kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

- Pranimi i nën kontraktimit të OE “A. G.” Shpk, (me 40% të vlerës së kontratës) është në kundërshtim me: Nenin 37, pika 3/a, nenin 42 pika 2, nenin 56, nenin 75 pikën 5 dhe 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

- Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu, nga titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d,” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, gërma “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, gërma “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 85-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qesarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj”, me vlerë të kontratës **410,174,927 lekë pa Tvsh**, realizuar nga BOE “K.” Shpk & “E. K.” Shpk, rezultuan që punimet janë pezulluar, pasi Leja e Ndërtimit është dhënë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, ligjit nr. 10253, datë 11.03.2010 “Për gjuetinë”, ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër” si dhe të ligjit nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”. Gjithashtu, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e neneve 27 e 29 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Nga Mbikëqyrësi i Punimeve OE “Xh. M.” Shpk, është vepruar në kundërshtim me: Pikat 4, 5, 6 e 14 të Udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Pikat 3, 3.1, 3.3, 3.4, 7 (7.1, 7.2 e 7.3) 9.1, 11 (11.1 e 11.2) të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 119-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, nëpërmjet Sektorit të Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të marrë masa që në të ardhmen, të aplikojë dhe të miratojë lejet e ndërtimit, në zbatim të përcaktimeve ligjore për kryerjen e punimeve të ndërtimit.

Të kërkohet nga mbikëqyrësit e punimeve të ndërtimit, kontrolli i mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësohen treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficiente, për t’i shërbyer komunitetit në kohë.

D. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 gwrmat “b”, “c” dhe “ç”, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika

1 dhe pika 4 gwrma “b”, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Memaliaj** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.